



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve Skenike
me profilet, "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi",
"Skenografi", "TV Produksion"

i

Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Evropian i
Tiranës"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Miltiadh Kutali

2. Dr. Ermir Hoxha

Shtator 2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Arteve Skenike me profilet, "Mjeshtëri Regjie",
"Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Evropian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arteve te Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve Skenike me profilet, "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 629 datë 05.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli 2
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	3 PAE/1 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2019-2020, 1 student
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve Skenike ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale në Universitetin Evropian të Tiranës. Programi është miratuar për hapje me Aktin nr. 629 datë 05.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me emërtim diplome Master i Arteve në “Artet Skenike në sistemin 2-vjeçar me shkëputje nga puna. Ai ofrohet në profilet; "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion". Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme që i formojnë ata si profesionistë në këto profile.

Kurrikula e programit është e ristrukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 120 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në dy vite akademike. Ai realizohet në gjuhën shqipe.

UET ka ndërtuar programin duke respektuar kërkesat e tregut të punës pas studimeve dhe përditësimeve periodike/frekuente që i bën këtij tregu. Programi studimor, ndjek principet e kartës së Bolonjës, dhe kuadrin rregullator të ndërtuar nga Ministria e Arsimit.

Në rregulloren e këtij programi studimi përcaktohen objektivat e programit të studimit:

1. Programi i studimit Master i Arteve synon ta pajisë studentin me:
 - a) Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;
 - b) Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar;
 - c) Formim tematik dhe jo panoramik apo historik;
 - d) Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor;
 - e) Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit;
 - f) Stazhi, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj;
 - g) Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës;
 - h) Diplomë me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit.

Në objektivat strategjikë të hapjes synohet edhe “përputhje optimale e dijeve akademike në fushën e arteve Skenike me aftësitë e kërkuara në tregun e punës dhe mundësinë e një punësimi në nivel të lartë”.

Në vitin aktual të studimit 2020-2021 departamenti i Arteve të Aplikuara ka në staf 17 pedagogë. Mbi 40% e stafit të PAE dhe PAK kanë titull shkencor Dr dhe më lart. (PAE - 7 janë me titull Dr., Prof. Assc. Dr. dhe Prof. Dr. dhe PAK 3 me titull. Ndërsa njësia kryesore, pra Fakulteti për stafin akademik PAE+PAK, në vitin akademik 2020-2021 kishte 7 Prof. Dr.; 8 Prof. Assc. Dr.; 17 Dr. dhe 34 me Msc ose Dr. në proces.

UET dhe më specifikisht Departamenti i Arteve të Aplikuara ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione si për zhvillimin e praktikave mësimore, si edhe për realizimin e aktiviteteve ekstrakurikulare. Praktikrat profesionale organizohen edhe në institucione të tjera me të cilat nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, por koordinohet praktika dhe aktivitete të tjera.

Programi i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm



Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) e nisi punën që në maj 2021, me takimin e përbashkët dhe përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave. Datat e vizitave në Universitetin Evropian të Tiranës si edhe axhenda e takimeve u dakordësuan edhe me UET. Vizitat u realizuan fizikisht në institucion, për shkak të lehtësimit të situatës nga pandemia COVID – 19. Vizitat u bënë në datat 2 dhe 3 qershor 2021.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në www.ascal.al

Gjatë dy ditëve të takimeve, u zhvilluan takime me Dekanen e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, me Përgjegjësën e Departamentit të Arteve të Aplikuara, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin e programit në proces akreditimi, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Karrierës, të marrëdhënieve me studentët dhe marrëdhënieve me jashtë, etj. Gjatë ditës së dytë u vizituan edhe ambjentet e UET, sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët kompjuterikë dhe laboratorët specialë të Teknologjisë së Informacionit dhe VTech, studiot e dedikuara studenteve të Arteve Skenike, etj.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi plotësimin me disa materiale të nevojshme për vlerësimin përfundimtar të programit të studimit. Materialet e kërkuara u plotësuan dhe u vendosën në platformën e ASCAL. Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe mirëkuptues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të UET.


Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Arjana Alija.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve Skenike me profilet, "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion"

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I ARTEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Evropian i Tiranës, UET, ofron programin e studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet; "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion", programe të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare.
Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sikurse është e specifikuar edhe në deklaratën e vizionit të UET "... UET do të punojë e përpjet vazhdimisht për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare ..."
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Ndërsa në Planin Strategjik 2021 theksohet se "... UET synon të bëhet një qendër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare dhe rajonale në kooperimin akademik, universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare, të arsimit të lartë.</p> <p>Këto citime të shkëputura nga dokumentet themelore të UET përcaktojnë më së miri se UET është një faktor ndikues në krijimin e profesionistëve në industrinë e ndryshme, duke përfshirë këtu edhe atë mediat ikë dhe disiplinat e artit. Programi është hartuar në përputhje qëllimet dhe misionin e UET. Rregullorja e programi të studimit specifikon që programi përgatit specialist të arteve Skenike, duke iu përshtatur kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, nevojat sociale të vendit dhe ruajtjen e vlerave kulturore.</p> <p><u>Referenca</u> Dokumenti 2. Statuti i UET. Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020 Dokumenti 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 Dokumenti 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET</p>





<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit dhe nevoja për hapjen e këtij programi janë të studiuara edhe nga analiza që universiteti i ka bërë tregut të punës. Gjatë studimit janë evidentuar me të dhëna sasiore nevojat e tregut të punës, si edhe tendencat e zhvillimit të këtij tregu në rang vendi. Studimet e bëra me Bordin e Tregut të punës si edhe në kuadër të programeve 250+ dhe më pas 500+ kanë treguar se ka mundësi të konsiderueshme punësimi apo edhe vetëpunësimi në fushën e arteve Skenike.</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet, "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion", është një mundësi e mirë për të ndjekur studime të mëtejshme më të thelluar në fushat respektive të arteve Skenike. Kjo është e shprehur edhe në Rregulloren e programit të studimit “MA Arte Skenike”, tek Objektivat e programit ky specifikohet se “... programi i studimit “Master i Arteve” synon ta pajisë studentin me thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; dhe ta parapërgatitë për licencën e profesionistit të rregulluar.</p> <p><u>Referenca për Standardin I.1:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET. Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020 Dokumenti 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 Dokumenti 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit MA Arte Skenike Dokumenti 16.1 Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes_Prespektiva punësimi Dokumenti 17. Studim Periodik Tregu i Punës - MA Arte Skenike Dokumenti 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike Dokumenti shtese. 1.1 Formatit për Raportin e fokus grupeve</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Në “Planin Strategjik 2021” të UET janë të përcaktuara cili është vizioni dhe objektivat strategjike që ky institucion i arsimit të lartë ka në drejtim të programeve studimore që organizon. Në vizion përshkruhet edhe që “... UET synon të ofrojë edukim dhe kërkim të standardeve të krahasueshme me tregun evropian të edukimit. E gjithë</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>veprimtaria e UET do të zhvillohet në mënyrë që të përfitojë e gjithë shoqëria në shkallë lokale, kombëtare dhe më gjerë.”</p> <p>Gjithashtu, në planet zhvillimore të UET-së janë të përcaktuar drejtimet e zhvillimit duke iu përshtatur kërkesave që vijnë nga tregu i punës dhe mundësive e profileve që ai ofron.</p> <p>Në Planin Strategjik 2015-2020 përcaktohet se “... UET synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, TI, komunikimit, etj., por mbetet i hapur ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike e shkencore dhe në drejtime të tjera që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës dhe UET ka mundësitë njerëzore e financiare për ti aplikuar ato.”</p> <p>Edhe gjatë vizitës në UET dhe takimet me Rektorin dhe Dekanen u theksuan drejtimet e reja për hapjen e programeve të reja studimore, bazuar në kërkesat që tregu i punës dhe strategjia e universitetit në dekadën e dytë të zhvillimit të tij.</p> <p>Drejtimet prioritare akademike dhe të zhvillimit shkencor të UET-së janë në përputhje edhe me objektivat formuese të programit të studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara.</p> <p><u>Referenca për standardin I. 2 / 1-2 :</u> Dokumenti 2. Statuti i UET. Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020 Dokumenti 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 Dokumenti 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Në zbatimit të ligjit për arsimin e lartë në vend, UET ka hartuar rregulloren e tij themelore, statutin, organigramën dhe më pas edhe rregulloret zbatuese për programet e studimeve.</p> <p>Edhe programi i studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara është hartuar dhe realizohet në zbatim të këtyre akteve rregullatore të UET. Ky program studimi është i përfshirë në Njësinë Kryesore Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve liberale dhe në njësinë bazë Departamenti i Arteve të aplikuara.</p> <p>Përmbajtja e programit është e organizuar sipas drejtimit akademik, strategjive zhvillimore të institucionit, si edhe kuadrit rregullator të përcaktuar nga Ministria e Arsimit. Të gjitha kompetencat profesionale që fitohen nga programi dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit,</p>	<p>Në hartimin e programit të studimit janë marrë në konsideratë strategjitë zhvillimore jo vetëm të institucionit, por edhe strategjitë kombëtare dhe tendencat rajonale të zhvillimit. UET ka ndërtuar programin duke respektuar kërkesat e tregut të punës pas studimeve</p>




<p>interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>dhe përditësimeve periodike që i bën këtij tregu. Programi studimor, ndjek principet e kartës së Bolonjës, dhe kuadrin rregullator të ndërtuar nga Ministria e Arsimit.</p> <p><u>Referenca për Standardin I.2:</u> Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020 Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 16.1 Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes_Prespektiva punësimi Dokumenti 17. Studim Periodik Tregu i Punës - MA Arte Skenike</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në dokumentin “Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike” UET ka përcaktuar edhe objektivat strategjike të programit. Këto objektiva ndër të tjera nënvizojnë “...formimin akademik, shkencor dhe bashkëkohor të studenteve ... duke ofruar dijet, teknikat dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies, lidhur me lëndët specifike të fushës së arteve Skenike”.</p> <p>Po kështu pika 3 e këtyre objektivave jep synimin për “përputhje optimale e dijeve akademike në fushën e arteve Skenike me aftësitë e kërkuara në tregun e punës dhe mundësinë e një punësimi në nivel të lartë”.</p> <p>Në po të njëjtin dokument përshkruhet se “Departamenti i Arteve të Aplikuara synon ndërtimin e të gjitha kurikulave të tij në përputhje me eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të “Kartës së Bolonjës”, përshtatjen e tyre me ndryshimet social-kulturore dhe zhvillimet e tregut, mundësinë e përvetësimit sa më të mirë të tyre, etj.”</p> <p><u>Referenca për standardin I. 3 / 1:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET. Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020 Dokumenti 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron</p>	<p>Në prag të hapjes së programit të studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara, UET ka kryer një vëzhgim mbi tregun</p>




përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

e punës në artet Skenike i cili ka shërbyer edhe si pikë në përcaktimin e kurikulës së programit të studimit. Vëzhgimi është i ndarë në disa nënseksione të cilat japin info si për çështje të ndryshme. Në seksionin “Seksionin e tretë: Vlerësimi në bazë të kërkesës që ofron tregu në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar” jepen edhe të dhëna sasiore mbi atë çfarë ofron tregu i arteve Skenike në vend, dhe kryesisht në Tiranë si edhe mundësitë e rritjes.

Studimi i tregut të punës, sikurse përshkruhet në këtë dokument është bërë mbi bazën e fokus grupeve me Bordin e Tregut të Punës dhe kontaktet me aktorët e tregut të punës, në kuadër të projektit 250+, e më pas 500+ (<https://uet.edu.al/new/programi-500uet-biznesi-dhe-universitetet-nevoje-per-njeri-tjetrin/>).

Bordet e Punës të Departamentit kanë pasur një numër të konsoliduar prej 10-11 individësh të spikatur në fushën e artit dhe TV. Nga dokumentacioni i dhënë nga UET ka pasur gjithëpërfshirje të personaliteteve nga fusha të ndryshme të artit në Bordet e Punës. Më shumë kjo shikohet edhe në Bordin e 2019-2020.

Gjatë vizitës në UET nga diskutimi me Dekanen e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, GVJ u informua edhe për fokus grupet e zhvilluar si përpara hapjes së programeve të studimit e master ashtu edhe për të marrë informacion të mëtejshëm në drejtim të përmirësimit të programit të studimit.

Sipas edhe aneksit të rregullores së programit të studimit, lista e mundësive për punësim pas përfundimit të programit të studimit është:

- Artist në krijimtari të lirë apo i angazhuar në institucione publike apo private si atelie, galeri artesh;
- Regjizor, Aktor, Producent, Skenograf, apo Koreograf në realizimin e shfaqjeve të shumëllojshme, filmave të ndryshëm kinematografik, televiziv, atyre serialë apo ato dokumentar;
- Drejtues i projekteve apo sipërmarrjeve të ndryshme si në drejtimin apo administrimin e studiove të ndryshme të filmit, koregrafisë dhe imazhit në tërësi;
- Kritik arti në fushën e arteve Skenike.

Zyra e karrierës dhe e marrëdhënieve me studentët mban një dokumentacion mbi mundësinë e punësimit të studentëve pas mbarimit të programit të studimit dhe drejtimet që merr kariera e tyre profesionale.

Referenca për standardin I.3.2:

Dokumenti 12.1 Bordi i Tregut të Punës - DAA

Dokumenti 16.1 Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes_Prespektiva punësimi

Dokumenti 17. Studim Periodik Tregu i Punes - MA Arte Skenike

Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të nxënimit

Në objektivat strategjike të hapjes së programit të studimit jepen objektivat dhe ndër të tjera theksohet se synohet “*përputhje optimale*”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

9

<p>garantojnë përfundimin e dijeve, aftësi, shkathtësi e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p><i>e dijeve akademike në fushën e arteve Skenike me aftësitë e kërkuesve në tregun e punës dhe mundësinë e një punësimi në nivel të lartë”.</i></p> <p>Gjithashtu në rregulloren e këtij programi studimi përcaktohen objektivat e programit të studimit se:</p> <p>2. <i>Programi i studimit Master i Arteve synon ta pajisë studentin me:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>i) Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;</i> <i>j) Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar;</i> <i>k) Formim tematik dhe jo panoramik apo historik;</i> <i>l) Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor;</i> <i>m) Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit;</i> <i>n) Stazhi, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj;</i> <i>o) Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës;</i> <i>p) Diplomë me originalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit.</i> <p><u>Referencë për standardin L3 / 3:</u> Dokumenti 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> <p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavejtare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Ndërtimi i programit të studimit është bazuar në “Kartën e Bolonjës”, rregulloret dhe legjislacionin në fuqi të Ministrisë së Arsimit, si edhe është mbështetur në projektet kërkimore ndëruniversitare që janë zhvilluar në kuadër të qendrave kërkimore dhe shkencore që ka UET. Përmes programeve të shkëmbimit midis universiteteve janë ofruar informacioni është synuar sjellja e praktikave dhe modeleve më të mira në zhvillimin e programeve studimore.</p> <p>Gjatë vizitës në UET nga diskutimi me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale si edhe përgjegjësin e departamentit të Arteve të Aplikuara, GVJ u informua rreth konsultimeve paraprake të bëra nga hartuesit e programit edhe me programin e fakultetit të arteve të Universitetit të Sibiu, Rumani.</p> <p><u>Referencë për standardin L. 3 / 4-5:</u> Dokumenti 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara ka të përfshirë edhe praktikën profesionale e grupuar në Lëndët plotësuese, kategoria D dhe e cila përfshin 12 kredite ose 10% të totalit të krediteve që ka i gjithë programi mësimor. Kjo tregon për rëndësinë që i kushtohet lidhjes së njohurive të marra në auditor dhe koncepteve teorike të fituara me njohjen e përvojës praktike, përbaljes me tregun e punës dhe veçoritë e tij të përditësisë së punës.</p>

	<p><u>Referencë për standardin I.3 / 6:</u> Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit _MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara zhvillohet në gjuhën shqipe, sipas edhe vendimit të licencimit nga Ministria e Arsimit.</p> <p>UET ka të ndërtuara qendra të kërkimit shkencor dhe projekteve me anë të të cilave përfshin student dhe pedagogë nga programe të ndryshme në format të shkëmbimit.</p> <p>Nga dokumenti “Mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve” rezulton se 3 studente nga programet Bachelor janë përfshirë në programet e shkëmbimit. Nuk ka pasur studentë nga Master i Arteve "Arte Skenike" të përfshirë në këto shkëmbime.</p> <p>UET përdor modulet mësimore për të realizuar shkëmbimin midis universiteteve dhe programeve. Kështu, në tetor 2019, Prof. Eno Koço, Pedagog në Universitetin e Leedsit në Britaninë e Madhe realizoi një Master klas me praninë e studentëve, pedagogëve dhe drejtues të UET.</p> <p>Në “Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore për Departamentin e Arteve të aplikuar për periudhën 2018-2021 jepet një pasqyrë e plotë e aktiviteteve të organizuara nga ky departament dhe të ftuarit kryesorë që kanë qenë pjesëmarrës në to.</p> <p>Aktualisht i gjithë programi i studimit bëhen vetëm në gjuhën shqipe. Megjithatë, syllabuset e lëndëve janë të përmbledhura edhe në gjuhën angleze, dhe shërbejnë për orientim për studentët që do të dëshirojnë të kontaktojnë departamentin për informacione plotësuese.</p> <p><u>Referencë për standardin I. 3 / 7:</u> Dokumenti 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve Dokumenti 43. Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021.</p>
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara i ka tërësinë e dokumenteve të hartuara në gjuhën shqipe. Gjatë vizitës në UET edhe në zyrën e Sekretarisë dhe të Sekretarit të Përgjithshëm GVJ u informua rreth gjithë dokumentacionit për studentët që ruhet nga kjo zyrë, pa afat kohor.</p> <p>Një format i shkurtuar i tyre gjendet edhe në gjuhën angleze, materialet janë përcjellë edhe në ACSAL, si edhe janë të aksesueshëm në intranet. Kjo mund t'u shërbejë studentëve të huaj nëse aplikojnë.</p>

	<p><u>Referenca për Standardin I.3:</u> Dokumenti 4. Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit - MA Arte Skenike Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 12.1 Bordi i Tregut të Punës - DAA Dokumenti 16.1 Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes_Prespektiva punësimi Dokumenti 17. Studim Periodik Tregu i Punes - MA Arte Skenike Dokumenti 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve Dokumenti 43. Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021. Dokumentet shitesë të kërkuara gjatë vizitës: Syllabuset e lëndëve: Menaxhim Eventes, menaxhim i mediave të reja, metoda kerkimore, Mjeshtri regjie teori dhe praktikat e regjisë, etj.)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, është një ndër fakultetet themeluese të Universitetit Evropian të Tiranës. Në themelimin e tij në vitin 2006 UET kishte si njësi kryesore “Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit”. Ndërsa me vendimin e Ministrisë së Arsimit në 2008, fakulteti u riorganizua me emërtimin që mban edhe sot. Fakulteti mbledhë rreth vetes një staff me përvojë akademike disa vjeçare, me tituj dhe grada shkencore dhe drejtues të disa veprimtarive të mirëfillta kërkimore dhe shkencore.</p> <p>Në vitin aktual të studimit 2020-2021 stafi i departamentit të Arteve të aplikuara ka 17 staff dhe mbi 40% e stafit të PAE dhe PAK kanë titull shkencor Dr dhe më lart. (PAE - 7 janë me titull Dr., Prof. Assc. Dr. dhe Prof. Dr. dhe PAK 3 me titull. Ndërsa njësi kryesore, pra Fakulteti për stafin akademik PAE+PAK, në vitin akademik 2020-2021 kishte 7 Prof. Dr.; 8 Prof. Assc. Dr.; 17 Dr. dhe 34 me Msc ose Dr. në proces.</p> <p>Nga shikimi i CV të personelit akademik, si me kohë të plotë ashtu edhe stafi i ftuar të japë lëndë specifike, tregohet se janë burimet njerëzore të duhura për realizimin e një mësimdhënie cilësore në këtë program studimi. Stafi akademik ka eksperiencë akademike dhe përvoja profesionale që më së miri japin know-how e duhur për realizimin e këtij programi studimit.</p> <p><u>Referencë për standardin I. 2 / 1:</u></p>

	Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 19. Syllabuset lëndëve Dokumenti 20. CV e personelit akademik.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësisë bazë, Departamentit të Arteve të Aplikuara. Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel e parë dhe të dytë. Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, Emërtimi i programit të studimit, orientimi, gjuha e studimeve, forma e studimeve, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut përpara hapjes së programit dhe vlerësimi dhe përndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Referenca për Standardin I.4: Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 19. Syllabuset lëndëve Dokumenti 20. CV e personelit akademik. Dokumenti 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1 dhe 2) Dokumenti 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik te fakultetit dhe departamentit_DAA (Aneks_Tabela 1 dhe 2) Dokumenti 26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse (Aneks_Tabela 3) Dokumenti 54.2 URDHER Nr.528, date 04.09.2018, Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive	Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Arteve të Aplikuara në UET bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionit si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programit të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit

<p>dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>duke përcaktuar përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative.</p> <p>UET ka një bazë rregullatore të detajuar dhe akte që përcaktojnë rolin dhe detyrat funksionale si të departamenteve, dekanatit, etj. Rregullore e UET si edhe Dokumenti “Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit” janë një themel i qartë në ndarjen e detyrave funksionale dhe mundësitë e bashkëpunimit midis njësive të ndryshme në UET.</p> <p>Departamenti në mënyrë periodike bën analizimin e ecurisë së procesit mësimdhënës dhe realizmin e bashkëpunimit në funksion të procesit mësimor. Gjatë vizitës në UET nga diskutimi me Dekanan e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale si edhe përgjegjësën e departamentit të Arteve të Aplikuara, GVJ u informua rreth mbledhjeve mujore që bën Departamenti si për ecurinë e programit apo edhe për progresin e studentëve. Në disa nga këto mbledhje marrin pjesë edhe studentët e programeve të studimit në mbikëqyrjen e sektorit përkatës.</p> <p><u>Referenca për standardin I.5/ 1:</u> Dokumenti 5. Rregullore e UET Dokumenti 6 F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi vendas ose të huaj. Në dokumentin “Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikatat profesionale_DAA” jepen të listuara disa nga bashkëpunimet themelore të Departamentit të Arteve të Aplikuara në kuadër të realizimit të programit të studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet e listuara. Kështu UET ka 95 marrëveshje të nënshkruara (memorandum bashkëpunimi) me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë. Nga ana tjetër UET gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare, publike dhe jo publike.</p> <p><u>Referenca për standardin I. 5 / 2:</u> Dokumenti 5. Rregullore e UET Dokumenti 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikatat profesionale_DAA Dokumenti 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Dokumenti 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës</p>	<p>UET dhe më specifikisht Departamenti i Arteve të Aplikuara ka nënshkruar marrëveshje me disa institucione si për zhvillimin e praktikave mësimore ashtu edhe për realizimin e aktiviteteve të tjera në shërbim të programit mësimor.</p>

<p>përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara ka nënshkruar marrëveshje me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qendra Kulturore Bashkia Tiranë 2. Creature Studio Sh.p.k. 3. Onoff Production 4. Universiteti i Arteve 5. Greiss Petriviq PF (GRACE MODELS)
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Por praktikat profesionale organizohen edhe në institucione të tjera me të cilat nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi por koordinohet praktika dhe aktivitete të tjera, të tilla si: RTSH, Studio OnOff Productions, Studio Frekuence, Studio Mode Anila Zajmi, Createur Studio sh.p.k., Gazeta Liberale, On /Off production, etj.</p> <p>Edhe panairi i punës është një mundësi e mirë kontaktesh të studenteve me punëdhënësit për tu përshtatur më mirë me tregun e punës. Në panairin e punës të kontaktuar nga Departamenti ishin të prezantuar kompanitë si: Kompania Filmike AA, Agna Group, Onoff Production, Botimet Muzgu, Studio Grafike dhe botimet Migeeralb, Ombra GVG, Studio dhe Atelie Pikturë “ Nini ”.</p> <p><u>Referenca për standardin I. 5 / 3-4 :</u> Dokumenti 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale_DAA Dokumenti 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit Dokumenti 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>UET ka ngritur Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve me anën e së cilës realizon bashkëpunimin me institucionet homologe universitare dhe kërkimore. Këto bashkëpunime janë edhe në kuadër të projekteve të mëdha ndërkombëtare si Erasmus Plus, etj.</p> <p>Aktualisht Departamenti i Arteve të Aplikuara është i përfshirë në projektet që vijojnë:</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Polyphonia Project – i lidhur me vlerat dhe traditën polifonike në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit. Projekti është në kuadër të programeve IPA midis Shqipërisë dhe Greqisë. Partner i projektit është edhe bashkia e Dropullit dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës në Vlorë. Roli i universitetin është mjaft i lidhur me hartimin e studimeve të qenësishme për polifoninë. Gjithashtu në këtë projekt do të përfshin edhe studentët e këtij programi studimi në “5 karvanet e polifonisë” që do të realizohen në vijim të realizimit të projektit. Deri tani janë realizuar tre studime nga profesorët e UET: Ylljet Aliçka, Kristi Bello dhe Ermir Nika.

	<p>▪ Crosswarp Project - mbi vlerat dhe traditën endjes, thurjes dhe tezgjahut në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit. Ky projekt është në kuadër të programeve të Erasmus.</p> <p>UET e ka të theksuar komponentin e pjesëmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare.</p> <p>Informacioni i hartuar për përfitimet nga projektet e bashkëpunimit ishte për periudhën 2018-2021 dhe jepte të detajuar shkëmbimet e studentëve, të cilët në Departamentin e Arteve të Aplikuara ishin vetëm në ciklin e parë në Bachelor. Vazhdimësia e projekteve dhe e shkëmbimeve u kufizua edhe nga shfaqja në vitin 2020 të pandemisë globale COVID - 19 e cila mbylli mundësinë e shkëmbimeve për studentët dhe pedagogët.</p> <p><u>Referenca për Standardin I.5:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 5. Rregullore e UET Dokumenti 6 F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale_DAA Dokumenti 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit Dokumenti 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve Dokumenti 54.2 URDHER Nr.528,date 04.09.2018,Riorganizimin e F. i Shkencave Sociale dhe Edukimit ne F. i Sh. Humane,Edukimit dhe Arteve Liberale Dokumentet shtesë të kërkuara gjatë vizitës: Dok.13. Procesverbale të mbledhjeve të hapura me studentët Dok. 15. Përshkrim i dy projekteve CROSSËARP – Polyphonia Dok. 16.1 Ekstrakt nga web_Portofoli i projekteve UET Dok. 16.2 Aktivitetet në kuadër të projektit Polyphonia Dok. 16.2 Aktivitetet në kuadër të projektit Polyphonia</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore

UET ka ndërtuar një Strategji të kërkimit shkencor dhe e përditëson atë edhe me kalimin e viteve, Strategjia ka të përcaktuar vizioni, objektivat strategjike, kontekstin dhe kriteret, dhe mënyrën për të vendosur baza të




shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	<p>qëndrueshme në kërkimin shkencor. Pjesë e strukturës së UET është edhe “UET Press” me disa publikime të rëndësishme. UET organizon edhe konferenca apo takime në kuadër të kërkimit shkencor. (Polis Journal, Economicus Journal, Medicus Journal, Justicia Journal, Nodus Journal, Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare-DSSH, Proceedings, Anuarët e Humaniteteve, Takimet Liberale të Dardhës, Shkolla Dimërore e Inovacionit, Forumi i Shëndetit Publik, Shkolla Pranverore e Lidershipit).</p> <p>UET ka të ngritur që prej fillimit të tij (2006) një revistë të titulluar “POLIS” dhe kjo u ofron mundësi pedagogëve të publikojnë kërkimet e tyre. Në fillim të krijimit revista ishte publikim i departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Me kalimin e viteve, ka përthithur edhe publikime të tjera të UET duke u forcuar në brendi dhe shtuar tematikat e saj. Ajo publikohet dy herë në vit dhe prej pak vitesh publikimi i saj bëhet vetëm në gjuhën angleze. Revista ka edhe një Bord Këshillimor të përbërë nga personalitete ndërkombëtare të fushës së edukimit në Ballkanin Perëndimor.</p> <p>Nga pikëpamja institucionale, kërkimi shkencor është përcaktuar që në Statutin e UET, në nenin 36 ku vendosen synimet e kërkimit shkencor dhe nënvizohet ideja e lidhjes dhe integritit të veprimtarisë kërkimore shkencore në procesin e mësimdhënies.</p> <p>Një nga Zv. Rektorët e UET ka detyrë ndjekjen e vazhdueshme të kërkimit shkencor në institucion dhe lidhjen e tij me procesin mësimor.</p> <p><u>Referenca për standardin I. 6 / 1-2:</u> Dokumenti 2. Statuti I UET Dokumenti 3.2. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Web revista Polis</p>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	<p>UET e ka si komponentë të fortë promovimin e rezultateve të tyre të kërkimeve dhe bërjen publike të tyre. Kërkimet shkencore shkrimet dhe publikimet të cilat janë në kuadër të projekteve, realizohen nëpërmjet aktiviteteve të dedikuara atyre. Kërkimet promovohen edhe në mediat kombëtare (TV, gazeta “Liberale” dhe rrjetet sociale).</p> <p>Siç përshkruhet edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor, UET ka Revistat Polis, Economicus, Medicus, Justicia dhe Nodus si instrumenti komunikues me botën akademike. Revistat Polis, Economicus, Medicus, Justicia dhe Nodus shërbejnë edhe për kërkues shkencor që të publikojnë kërkim shkencor original si edhe për universitetin që të konsolidojë identitetin e tij shkencor.</p> <p>Revistat botohen dy herë në vit, në gjuhën angleze duke aplikuar procesin <i>blind peer review</i> me synim përbushjen e standarde strukturore. Revistat kanë edhe website profesional të dedikuar ku</p>




	<p>paraqiten të gjitha të dhënat e nevojshme për kërkuesit si dhe të gjithë artikujt e botuar nga revistat.</p> <p>Referenca për standardin I. 6/ 3: Dokumenti 2. Statuti I UET Web search revista Polis https://www.uet.edu.al/polis/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Siç përshkruhet edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor, UET 2021-2025 - Revistat që publikon UET janë në proces indeksimi në sa më shumë 'indexing/abstracting services' për të rritur besueshmërinë dhe për t'i bërë sa më të aksesueshme. Gjithashtu UET ka edhe Kodin e Etikës ku në pikën A.II.7.1. përshkruhen standardet e kërkimit shkencor. " Çdo anëtar i personelit akademik inkurajohet të kryejë veprimtarinë e tij kërkimore shkencore duke garantuar rruajtjen e objektivitetit dhe rigorozitetit shkencor në nxjerrjen e konkluzioneve të kërkimit dhe shmangien e çdo qëndrimi të njëanshëm të kërkimit, duke mos u ndikuar nga interes e sponsorizuesit/financuesit të projektit.</p> <p>Pika A.II.7.2. detajon detyrimet për shmangien e plagjiaturës: <i>"Të gjithë anëtarët e komunitetit universitar duhet të japin të dhëna të sakta për autorët, idetë dhe teoritë që nuk janë të tyre. Plagjiatura ose format e tjera të vjedhjes së pronësisë intelektuale janë të ndëshkueshme. UET, dekurajon çdo eksperiencë dhe praktikë që referohet si më poshtë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Publikimi në revista pa reputacion, akoma më keq me reputacion të dyshimtë, që pretendojnë që ofrojnë faktor impakti, jo real. b. Publikimi i artikujve me të dhëna të fabrikuar, fiktive, ose të shtrembëruara. c. Publikimi i artikujve të kopjuar nga autorë të tjerë, ose ku citimet nuk janë të plota dhe të sakta. d. Publikimi i artikujve duke shtuar pa meritë autorë të tjerë, ose pjesëtarë të familjes së ngushtë (bashkëshortit/es, fëmijëve, etj.), të cilët nuk kanë kontribut real. e. Publikimi i të njëjtit artikull në më shumë se një revistë. f. Publikimi i të njëjtit artikull, me modifikime të vogla ose pa asnjë modifikim, por me titull të ndryshuar. g. Pjeëmarrja në të njëjtën konferencë me disa punime. h. Dërgimi i punimeve në konferenca, ku pasi sigurohet pranimi i tyre, nuk bëhet prezantimi për mungesë të autorit në ditën e konferencës. i. Përdorimi i punës së studentëve, në detyra kursi apo punime diplomash apo të çfarëdo projekti të tyre individual apo në grup. Në rast përdorimi të kufizuar të tyre, ai/ajo duhet cituar si burim reference dhe kontribues i botimit. j. Fabrikimi i të dhënave/data base ose falsifikimi i tyre. <p>Referenca: Dokumenti 2. Statuti I UET Dokumenti 55. Kodi I Etikës I UET</p>


<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Studentët përfshihen në kërkime nëpërmjet bashkëpunimit me pedagogët e tyre dhe përfshirjes në projekte sidomos ato në kuadër të bashkëpunimit edhe me Universitete të tjera. Përfshirja lidhet si me sistemin e realizimit të anketimeve ashtu edhe me detyra të tjera, punime dhe prezantime në konferenca studimore etj. Dokumentat e përcjella nga institucioni tregojnë për aktivitetet në kuadër të dy projekteve dhe përfshirjen në to të pedagogëve dhe studnetëve.</p> <p><u>Referenca për Standardin I.6:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 3.2. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 55. Kodi i Etikës i UET Dokumentet shtesë të kërkuara gjatë vizitës: Dok. 15. Përshkrim i dy projekteve CROSSWARP – Polyphonia Dok. 16. 1 Ekstract nga ëeb_Portofoli i projekteve UET Dok. 16. 2 Aktivitetet në kuadër të projektit Polyphonia Dok. 16. 2 Aktivitetet në kuadër të projektit Polyphonia</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Sipas Legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit programet janë organizuar në lëndë dhe module. Ky organizim respekton systemin Europian të transferimit dhe grumbullimit të Krediteve. Lëndët kanë nga 6 kredite (ECTS) ndërsa praktikat e intershipit janë vlersuar me nga 12 kredite (ECTS).</p> <p>Sipas Rregullores së studimit Struktura e Programit të Studimit është ndërtuar në këto kategori:</p> <p>Struktura e programit të studimit</p> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja.</p> <ul style="list-style-type: none"> i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (12 ECTS) ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (60 ECTS) iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (18 ECTS) iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (12 ECTS) v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (18 ECTS). <p>Ndërsa lëndët janë paraqitur në tabelën si mëposhtë:</p>

MNB - MASTER ARTET SKENIKE - 120 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i Lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 5% - 10% 12 ECTS

1	I	1	Metoda kërkimi të avancuara	6
2	I	2	Metoda kërkimi saslore	6

B - LËNDË KARAKTERIZUES/ 50% - 60% 60 ECTS

1	I	1	Analizë e arteve skenike (teatër dhe kinematografi)	6
2	I	1	Arti konceptual dhe performancë	6
3	I	1	Produksion i integruar: radio, kinema dhe tv	6
4	I	1	Tëori dhe teknikat e aktrimit	6
5	I	2	Menaxhim eventesh	6
6	I	2	Praktikum i Marrëdhënieve Publike	6
7	I	2	Tëoria dhe teknikat e skenografisë	6
8	II	1	Menaxhim dhe dizajni i medieve të reja	6
9	II	1	Tëori dhe teknikat e koreografisë	6
10	II	1	Tëori dhe teknikat e regjisë	6

**C - LËNDË
NDËRDISCIPLINORE/INTEGRUES/ 11% - 10% 18 ECTS**

Profili:		<i>Aktor</i>		
1	I	2	Mjeshteri Aktrim I	6
2	II	1	Mjeshteri Aktrim II	6
3	II	2	Mjeshteri Aktrim III	6
Profili:		<i>Koreografi</i>		
1	I	2	Mjeshteri Koreografi I	6
2	II	1	Mjeshteri Koreografi II	6
3	II	2	Mjeshteri Koreografi III	6
Profili:		<i>Regji</i>		
1	I	2	Mjeshteri Regji I	6
2	II	1	Mjeshteri Regji II	6
3	II	2	Mjeshteri Regji III	6
Profili:		<i>TV Production</i>		
1	I	2	Mjeshteri TV Production I	6
2	II	1	Mjeshteri TV Production II	6
3	II	2	Mjeshteri TV Production III	6
Profili:		<i>Skenografi</i>		
1	I	2	Skenografia I: Struktura dramatike dhe objektet skenike	6
2	II	1	Skenografia II: Modelimi i hapësirës dhe veprimi skenik	6
3	II	2	Skenografia III: Thuna, materialet dhe teknologjitë skenike	6

D - LËNDË PLOTËSUES/ 10% 12 ECTS

1	II	2	Praktikë / intership	12
---	----	---	----------------------	----

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 10% - 20% 12 ECTS

1	II	1-2	Punimi i Diplomës	18
---	----	-----	-------------------	----

Punimi i diplomës ka 12 kredite (ECTS). Sipas Planit mësimor të paraqitur viti i parë ka 11 lëndë me nga 6 kredite secili. Dy prej këtyre lëndëve janë me zgjedhje, duke bërë në total 60 kredite. Viti i dytë përbëhen 8 lëndë nga 6 kredite, ndërsa praktikë intership 12 kredite dhe punim diplome 12 kredite.

	<p>Sipas kurrikulës së Programit diploma ka 18 kredite. Në të dy tabelat totali i krediteve rezulton të jetë 120 kredite (ECTS).</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.1 / 1:</u> Dok. 53. Ligji 80_2015_Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH. Dok. 14. Kurrikula e programit MA Arte Skenike Dok. 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi Master i Arteve në “Arte Skenike” synon të ndihmojë studentët të kuptojnë krijimin dhe teorizimin e arteve Skenike në kontekstin e një ambienti të larmishëm intelektual universitar dhe në korrespondencë me komunitetet vendore dhe ndërkombëtare të artit.</p> <p>Programi i studimit Master thëllon konceptet dhe aftësitë e zhvilluara në programin Bachelor në 'Arte Skenike' ose në programe të ngjashme studimi. Programi fton studentët të thellojnë praktikën e tyre krijuese si artistë ose profesionistë në sektorin e industrive krijuese. Ai ofrohet në 5 profile, "Mjeshtëri Regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV Produksion", të cilat diferencohen në 3 lëndë, për të rritur mundësitë e specializimit dhe shprehur maksimalisht shprehitë përkatëse sipas fushës.</p> <p>LËNDË BAZË, (Metoda kërkimi të avancuara, Metoda kërkimi sasiore);</p> <p>LËNDË KARAKTERIZUESE; (Analizë e arteve skenike (teatër dhe kinematografi), Art konceptual dhe performance, Produksion i integruar: teatër, kinema dhe TV, Teori dhe teknikat e aktrimit, Menaxhim eventesh, Praktikum i Marredhenieve Publike, Teoria dhe teknikat e skenografisë, Menaxhim dhe dizajn i mediave të reja, Teori dhe teknikat e koreografisë, Teori dhe teknikat e regjisë.);</p> <p>LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE; (Mjeshteri Aktrim I, II, III, - Mjeshteri Koreografi I, II, III, - Mjeshteri Regjie I, II, III, Mjeshteri TV Produksioni I, II, III, - Skenografia I: Struktura dramatike dhe objekti skenik, Skenografia II: Modelimi i hapësirës dhe veprimi skenik, Skenografia III: Thura, materialet dhe teknologjitë skenike.)</p> <p>Përveç kësaj janë dhe Lëndët plotësuese (praktikë profesionale / intership)</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.1/ 2:</u> Dok. 14. 2 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi Master profesional përfshin lëndë teorike dhe praktike, të cilat formojnë koncepte profesionale dhe teorike:</p> <p>P.sh. në lëndën “Analizë e Arteve Skenike” qëllimi është i trefishtë: “Së pari të ndihmojë studentët të ndërtojë aftësitë që historianët e artit përdorin kur trajtojnë vepra arti dhe shkruajnë të kaluarën; Së dyti, të fuqizojë studentët të kuptojnë që bota jonë nuk u krijua nga hiçi, dhe se e kaluara ndikon shumë në të tashmen; dhe Së treti synon të rrisë të</p>

	<p>kuptuarit dhe vlerësimin e studnetëve për trashëgiminë botërore artistike rreth nesh.”</p> <p>Ndërsa në rastin e një lënde tjetër p.sh. “Produksion i integruar: teatër, kinema dhe TV”, vërejmë që qëllimi i lëndës është të ndihmojë studentët për të kuptuar më mirë proceset e punës dhe teknikat e realizimit dhe paraqitjes në mënyrë sa më bashkëkohore të veprave të shumta artistike qofshin ato skenike apo filmike, implementimi i tyre në skenat e ndryshme, multimediat si dhe në platformat e ndryshme televizive.</p> <p>Ndërkohë sipas “Rregullores së Programit të Studimit MA Arte Skenike” programi synon të pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; 2. Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar; 3. Formim tematik dhe jopanoramik apo historik; 4. Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor; 5. Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit; 6. Stazhe, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj; 7. Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës; 8. Diplomë me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit. <p><u>Referenca për Standardin 2.1/3:</u> Shih dok. 19. Syllabus_teoria_e_arteve_Skenike_MA.pdf Shih. dok. 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.pdf Shih dok. 19. Syllabus_teoria_e_arteve_Skenike_MA.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në fushën e arteve Skenike dhe pasi të marrin njohuri të thelluara të jenë të përgatitur për tregun e punës. I ndërtuar në 5 profile, ai zhvillon aftësitë e studentëve nëpërmjet trajtimit analitik të temave dhe problematikave të realitetit të sotëm.</p> <p>Gjatë vizitës dhe diskutimit me studentët në UET, GVJ u njoh edhe me mundësitë që lëndët si japin si njohuri paraktike ashtu edhe teorike.</p> <p>Psh. lëndët; <i>Art konceptual dhe performance apo, Skenografia I: Struktura dramatike dhe objekti skenik, Skenografia II: Modelimi i hapësirës dhe veprimi skenik, Skenografia III: Thura, materialet dhe teknologjitë skenike</i> ofrojnë zgjerimin e njohurive të studentëve rreth animacionit dhe aftësimin për të mbetur konkures në industri duke zhvilluar teknikat e animacionit të karaktereve 2D dhe 3D. Praktikisht studentët mësojnë të zhvillojnë konceptet, organizimin dhe ndërtimin skenografik, në përputhje me personalitetin e personazheve në aktet e ndryshme që përkohjnë me subjektin, veprimin, sinkronizimin e zërit dhe shprehjet e fytyrës ose edhe me kostumografinë.</p>

<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është ndërtuar në respekt të akteve ligjore e nënligjore të arsimit të lartë. Ai përbëhet nga 120 kredite, për një kohëzgjatje totale prej 2 vitesh. Ai përmbyllet nga punimi i diplomës dhe studenti pas kësaj pajiset me Diplomën “Master i Arteve” në “Artet Skenike”, në një nga 5 profilet.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.1/ 5:</u> shih dok 53. Ligji 80_2015_Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar sipas këtyre kategorive:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (12 ECTS) 2. Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (60 ECTS) 3. Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (18 ECTS) 4. Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (12 ECTS) 5. Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (18 ECTS). <p>Ngarkesa normale është 60 kredite për vit, 30 kredite për semester dhe për një total prej 120 kreditesh.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Punimi i Diplomës ka 18 kredite (ECTS), dhe ndodhet në kategorinë E, që ka të bëjë me detyrimet përmbyllëse. Procedura e zhvillimit të lëndës gjendet në dokumentin: “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”.</p> <p>Ai kalon nëpër këto faza: 1. Zgjedhja dhe miratimi i temës, i cili zhvillohet në fillim të muajit tetor, kur çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. 2. Zgjedhja dhe miratimi i temës së disertacionit, i cili zhvillohet nga Departamenti në fillim të muajit qershor dhe më pas në 3. Zgjedhjen për Udhëheqjen e punimit të diplomës/disertacionit sipas kritereve. 4 Seancat metodologjike dhe 5 Punimi i Diplomës.</p> <p>Nga takimi me studentët u vu re respektimi i hapave për realizimin e punimit të diplomës, nga Përzgjedhja e temës dhe problematikat e mundshme, Metodologjia e punimit, Burimet dhe puna në terren tek problematika e tjera që lidhen me punën konkrete si psh: kërkimi i materialeve, çështjet e citimeve dhe Referencave, etj.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.1 / 7:</u> Dok. 10 Mbi punimin e diplomës/disertacionit B. II.</p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësia kryesore bazë përgjegjëse për programin ka përmbushur detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ajo është realizuar nga Grupi i ekspertëve i ngritur me urdhër të Rektorit të UET nr. 2, dt. 15.02.2021 në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, neni 104, në mbështetje të statutit të UET, pika 2.3.4.</p> <p>Puna për ndërtimin e këtij programi studimi ka nisur prej disa vitesh dhe UET ka krijuar nje grup pune me specialistë të fushave respektive. Ai vlerësohet për herë të parë.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>I përbërë nga 3 departamente, Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale ka në përbërjen e tij departamente si: Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara.</p> <p>Ngarkesa e çdo program të studimit është strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Për të përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike Departamenti i Arteve të Aplikuara ka angazhuar në mësimdhënie në të gjithë ciklet e studimeve, personel të kualifikuar në fushën pedagogjike por edhe të jetës kulturore dhe artistike të vendit, me titujt të ndryshëm dhe gradat shkencore përkatëse, si edhe profesorë</p>

	<p>me përvojë të gjatë, duke aplikuar gjithashtu modulet me lektorë të ftuar, kryesisht ekspertë të fushave të arteve Skenike, muzikore dhe skenike.</p> <p>Ato synojnë përmbushje të kërkesës aktuale por edhe së ardhshme të tregut për profesionistë të arteve, të cilët do të mbështesin industrinë gjithnjë në rritje të imazhit dhe ndërgjegjësimit shoqëror në rrashin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Në këtë kontekst, vlen të përmendet fakti se Anëtarët e Bordit të Tregut të Punës, në vijimësi kanë mbështetur konsolidimin e këtyre programeve për shkak të kërkesave të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Programi Master i Arteve në 'Arte Skenike' është pjesë e Fakultetit të shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, thmeluar në vitin 2006, në Departamentin e Arteve të Aplikuara. Personeli Akademik arrin numrin dhe kualifikimin e nevojshëm. Për vitin akademik 2020-2021, në nivel Fakultetit i ndarë në dy grupe, me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar, ai përbëhet nga:</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE):</p> <p>4 Prof. Dr. 8 Prof. Asc. Dr. 9 lektorë me gradën Dr./ PhD dhe 23 Asistentë lektorë.</p> <p>Personeli Akademik me kontratë:</p> <p>3 Prof. Dr. 1 Prof. Asc. Dr. 8 lektorë Dr./ PhD, 1 në Proces, dhe 10 Asistentë lektor.</p> <p>Në nivel departamenti ai përbëhet nga:</p> <p>Personeli Akademik Efektiv:</p> <p>3 Prof. Dr., 2 Prof. Asc. Dr, 2 lektorë me gradën Dr./ PhD dhe 10 Asistentë lektorë.</p> <p>Personeli Akademik me kontratë:</p> <p>2 Prof. Dr. 1 lektorë Dr./ PhD, 1 në Proces, dhe 7 Asistentë lektor.</p> <p>Stafi akademik i përmbush standardet akademike.</p>




Titulli	Stafi akademik për programin e studimit Master i Arteve Arte Skenike		
	(Viti akademik 2020-2021)		
	PAE	PAK	Raportë PAE/PAK
Lektorë me titullin Prof. Dr	1	0	1/0
Lektorë me titullin Prof. 'ë Assoc.	0	0	0/0
Lektorë me gradën Dr/Phd	1	0	1/0
Asistentë me Msc (ne proces Dr)	0	1	0/1
Asistentë me Msc	1	0	1/0
Totali	3	1	3/1

Referenca për Standardin 2.2 / 3:

(Dok. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1 dhe 2) Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë, gradat shkencore/titujt akademikë, Viti akademik 2020 – 2021)

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, përmbush standardet e strukturës akademike dhe detyrimet ligjore. Ai përbëhet nga 3 Departamente: Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara.

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.

Praktika mësimore realizohet në Departament nga strukturat përkatëse të cilat harton syllabusin e zhvillimit të praktikës në auditor, dhe kalendarin e zhvillimit të seanceve; Përzgjedh ekspertët e fushës dhe institucionet dhe mbikqyr procesin, sipas rregullores së institucionit.

Referenca për Standardin 2.2 / 5:

Shih 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.

Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Kordinatori i Programit është Prof. Dr. B.K bazuar në vendimin nr. 35, datë 14.04.2021.

Prof. Dr. B.K është një nga emrat më të njohur të Skenës së Artit dhe Pedagogjisë në vend, me një eksperiencë të gjërë shtrirë në mbi 4 dekada. Ai është skenarist, regjizor, aktor dhe pedagog drejtues për shumë vite. Fitues i mbi 20 çmimeve kombëtare e ndërkombëtare, përveç edukimit në vend ai është i specializuar në SHBA, Itali dhe Francë.

Ai bashkë me stafin synojnë përmbushje të kërkesës aktuale por edhe së ardhshme të tregut për profesionistë të arteve, të cilët do të mbështesin industrinë gjithnjë në rritje të imazhit dhe ndërgjegjësimit shoqëror në rrashin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Referenca për Standardin 2.2 / 6:


Dok 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programeve të studimit FSHHEAL DAA Detyrat e koordinorit të programit

<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Kordinatori raporton në mënyrë periodike mbi zhvillimin e programit të mësimit, orëve, syllabuset, tezat, dhe formularët e verifikimit tek Drejtuesi i Departamentit ose në mbledhje në departament.</p> <p>Referenca për Standardin 2.2 / 7: Dok. 23 – Tabelat. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë, gradat shkencore/titujt akademikë, Viti akademik 2020 – 2021) në Dok. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit (Aneks_Tabela 1 dhe 2) Dok. 6 F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Përmbajtja e programit, si dhe informacione lidhur me strukturën dhe organizimin e tij, gjenden të publikuara në dokumentet e paraqitura nga UET. Të gjithë të interesuarit, brenda departamentit dhe jashtë tij gjejnë statutin, rregulloren, kurrukulat e programeve të studimit, planet mësimore, silabuset etj. Për promovimin dhe aksesin e tyre është zgjedhur platforma TEAMS LMS., si dhe janë pasqyruar në faqen web të UET.</p> <p>Referenca për Standardin 2.3 /1: Dok 46. Manuali i përdoruesit për sistemin UMS)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi organizohet në lëndë, module, praktikë e praktikë sipas përcaktimeve ligjore. Ato pasqyrohen në kurrikul dhe rregulloren e studimit.</p> <p>Si të tilla:</p> <p>LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) kanë 12 kredite (10%)</p> <p>LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën që karakterizon programin, lëndët praktike (B) kanë 60 kredite (50%)</p> <p>LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) kanë 18 kredite (15%)</p> <p>LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) kanë 12 kredite (10%)</p>

	<p>DETYRIME PËRMBYLLËSE (E) kanë 18 kredite (15%)</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.3 / 2:</u> Shih 14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - MA Arte Skenike (Aneks_Tabela 9)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi organizohet në lëndët dhe modulet që vlerësohen në kredite (ECTS), ndarë në 2 semestra për dy vite. Secili prej tyre ka 30 ECTS, për një total prej 120 ECTS). Këto janë pasqyruar në planin mësimor.</p> <p>Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit; ▪ Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit; ▪ Projekt/detyra/ushtrime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit; ▪ Praktikën Profesionale 255 orë në auditor dhe 45 orë punë e pavarur e studentit; ▪ Punim diplome 36 orë në auditor dhe 414 orë punë e pavarur e studentit. <p><u>Referenca për Standardin 2.3 /3:</u> Shih 14.1. Plani mësimor - MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor pasqyron informacionin e plotë në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor, brenda dhe jashtë tij, pasqyruar në dok. 14.1</p> <p>Në rregulloren e Programit përcaktohet niveli i frekuentimit me 80 % si dhe forma e vlersimit, provimet etj.</p> <p>Kështu në rregulloren e studimit pika 5.2 mbi mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijes theksohet se:</p> <p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> Provimit të ndërmjetëm (30%) Nivelit të diskutimit (10%) Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%) Provimit përfundimtar (40%). <p>Ndërkohë për ndarjen sipas tipologjisë së lëndëve më shumë mund të shihet dhe tabela:</p>

Format e kontrollit të njohurive (*)	Programi i Studimit MA në Arte Pamore	
	Tipologjia I Pjesa (në %) ndaj totalit	Tipologjia II Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	-	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	2x30 % = 60%	20%
Testimet gjatë vitit	-	30%
Provimi përfundimtar	40%	40%
NË total	100%	100%

Kjo pasqyrohet edhe në Sillabuset përkatës: psh. në lëndën Pikturë në sillabus në pikën Forma e Kontrollit të dijeve theksohet se në Programet Master

1. Prezenca në veprimtarinë mësimore në auditor është e detyrueshme në masën 80%
2. Kontrolli i Vazhdueshëm: për lëndët e tipologjisë I
Detyra Praktike: 1 x 30 % - 30 %
3. Provimi përfundimtar 70 %.

Referenca për Standardin 2.3/ 4:

Dok. 14.1 Plani mesimor MA Arte Skenike.pdf

Dok 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MA Arte Skenike.pdf

Dok 19. Syllabus_pikturë_MA.pdf

Dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.pdf

Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Rregullorja e programi studimor parashikon kushtet e pranimit për çdo kandidat, transferimet dhe ekuivalentimet e krediteve.

Psh. në pikën 2.1 të rregullores theksohet se: “Për t’u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Arteve, studenti duhet të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit e të vlerësuar ekuivalente me të.”

Më tej mbi transferimet në pikën 9. 1 theksohet se: “UET-i, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procedura e transferimit, nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi, rregullohet me udhëzim të veçantë.”

Në vazhdim janë dhe pikat që trajtojnë ekuivalentimet e krediteve. Ato janë në pikat 9.3-9.7.

	<p>Psh. 9.3 Në këtë program studimi mund të transferohen studentë nga programe të tjera të studimit të ciklit të parë, në fushë të njëjtë ose të përafërt, vetëm në fillim të vitit akademik.</p> <p>9.4 Studentët që kanë përfunduar studimet në një program tjetër studimi, kanë të drejtë të kërkojnë njohjen e krediteve të lëndëve të njëjta ose të ngjashme.</p> <p>Në dokumentin DII shtjellohet më qartë tema: Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve^[1] Transferimi dhe njohja e krediteve.</p> <p>Aty sqarohet që: D.II.4.1.- 3</p> <p>Kandidati që dëshiron të transferohet nga një shkollë tjetër e lartë, në UET, duhet t'i paraqesë Zyrës së Pranimeve, një kërkesë [formati D.II.3] ku të përcaktojë lëndët që dëshiron të transferojë, shoqëruar me një listë notash të lëshuar nga institucioni nga do të transferohet. Dokumentacioni i kalon për shqyrtim paraprak Drejtuesit të Departamentit, i cili garanton që ekuivalentimi paraprak të përfundojë brenda ditës. Kandidati njoftohet për ekuivalentimin paraprak nga Zyra e Pranimeve.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.3 / 5:</u> Dok. 14.1 Plani mesimor MA Arte Skenike Dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike. Dok. 28. Dokumenti D. II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf.)</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset për secilën lëndë janë strukturuar mirë. Ato pasqyrojnë të dhënat bazike, ngarkesa, viti, lloji i lëndës, shoqëruar me qëllimin, konceptet themelore, temat e kursit dhe literaturën e nevojshme, të detyruar dhe të rekomanduar. Gjithashtu në lëndët përkatëse pasqyrohen praktikat, seminarët apo orët e laboratorit kur janë pjesë e syllabusit. Ato janë firmosur nga pedagogu, Përgjegjësi i Grup/Lëndëve dhe Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p>Vihet re në masë të gjërë literatura e huaj, e cila pavarësisht se e kuptueshme, duhet të përkthehet në vite nga stafi pedagogjik në gjuhën vendase, për një përvetësim sa më të plotë të lëndës nga ana e studentit.</p> <p>Sygjerohet rishikimi i syllabusit: Syllabus_produksion_i_integruar_kinema_teater_TV_MA, pasi paraqet gabime drejtshkrimore dhe strukturore të dukshme.</p>




	<p>Costello, V. Youngblood, S. Youngblood, N.E. (2012) "Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design", Focal Press</p> <p>4. Mario-Noelle Heinrich, "Krijimi muzikor dhe teknologjitë e reja"</p> <p>5. IRCAM, Manuali i teknologjive të reja muzikore</p> <p><u>Literatura e rekomanduar</u></p> <p>Tema V – Arshiva</p> <p>1. Verifikimi me të shkuaren</p> <p>2. Praktike</p> <p><u>Metodat Pedagogjike që do të përdoret në seminarin e radhës</u> Tradicionale dhe interaktive</p> <p><u>Literatura e detyrueshme</u></p> <p>1. Native Instruments - Maschine 2.8 (2019)</p> <p>2. Sternberg – Cubase 10.5 (2019)</p> <p>3. E. Barrio, MAD-Muzika e asistuar me kompiuter, 2001</p> <p>Costello, V. Youngblood, S. Youngblood, N.E. (2012) "Multimedia Foundations: Core Concepts for Digital Design", Focal Press</p> <p>4. Mario-Noelle Heinrich, "Krijimi muzikor dhe teknologjitë e reja"</p> <p>5. IRCAM, Manuali i teknologjive të reja muzikore</p> <p><u>Literatura e rekomanduar</u></p> <p>Tema VI – Analize filmi për 5 lemat e mësipërme</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.3 / 6:</u> Dok. 19. Syllabus_produksion_i_integruar_kinema_teater_TV_MA.pdf</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Sipas rregullores, përmbajtja e programit të studimit, është subjekt përmirësimi, dhe përditësimi të vazhdueshëm, periodikisht çdo fillim-viti.</p> <p>Në pikën 10 të Rregullores nuk parashikohet arkivimi i dosjes së plotë në shqip dhe anglisht.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.3 / 7:</u> Dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike. Pika 10.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1243 746 1317">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="746 1243 967 1317">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="967 1243 1182 1317">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1182 1243 1406 1317">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1317 746 1393"></td> <td data-bbox="746 1317 967 1393"></td> <td data-bbox="967 1317 1182 1393"></td> <td data-bbox="1182 1317 1406 1393" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në "Arte Skenike" është një program i ciklit të dytë të studimeve, dhe ofrohet me kohëzgjatje normale dy vite akademike, me gjithsej 120 ECTS.</p> <p>Ky program mbështetet në strategjinë institucionale të UET, në ligjin</p>

<p>parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e arteve muzikore, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe atyre të vet Departamentit të Arteve të Aplikuara.</p> <p>Kurrikula e këtyre programeve i përgjigjet përvojës më të mirë të universiteteve perëndimorë, duke e bërë dijen të transferueshme dhe duke iu përgjigjur kërkesave të "Kartës së Bolonjës", në përshtatje edhe me ndryshimet social - ekonomike dhe zhvillimet e tregut të dijes.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.4 / 1:</u> (Shih. 53. Ligji 80_2015_Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH. Si dhe 14.1 Plani mesimor MA Arte Skenike.)</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi është në përputhje me disiplinën që mbulon, ndërsa disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese janë të ndara në 5 kategori A- deri në E.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Viti akademik ndahet në 2 semestra, në 14 javë mësim, sipas kalendarit akademik.</p> <p>Ngarkesa vjetore është 60 kredite, ndarë në dy semestral, ndërsa shpërndarja e ngarkesës, seminarët dhe praktikat arrijnë objektivat për nxënjen dhe aftësimin profesional.</p> <p>Në Dok. 39 pikën mbi A.III.: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës theksohet se:</p> <p>Programi i lëndës hartohet përpara fillimit të semestrit kur lënda do të zhvillohet dhe konsiderohet kontratë akademike dhe administrative mes titullarit të lëndës nga njëra anë dhe strukturave drejtuese të UET-it dhe studentëve nga ana tjetër.</p> <p>Programi i lëndës duhet të shpjegojë hollësisht përmbajtjen e kursit, si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.4/ 3:</u> dok 10.3 Kalendarit akademik 2020-2021 dok 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi ka ndjekur parimet dhe direktivat e Kartës së Bolonjës, për një përshtatjen e studentëve brenda dhe jashtë institucionit, si dhe vazhdimin e tyre në cikle më të larta.</p> <p>Raporti teori praktikë është i duhuri, dhe lëndët pajisin me njohuri konkrete, ndërsa literature ngre vështirësi për studentin vendas, pasi në pjesën shumice është në gjuhë të huaj. Kjo mund të paraqitet si avantazh në vazhdimin e tij më tej, por për studimet aktuale mund të paraqesë vështirësi në nxënjen e plotë të literaturës.</p>

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit
- Projekt/detyra/ushtrime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 255 orë në auditor dhe 45 orë punë e pavarur e studentit
- Punim diplome 36 orë në auditor dhe 414 orë punë e pavarur e studentit

Ngarkesa totale në auditor është 1191 orë mësimore. Plani mësimor pasqyron ngarkesat e orëve të cilat respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore.

Format e mësimdhënies	Programi i Studimit MA Arte Pamore
	Orët totale në auditor

Leksione	420
Seminare	210
Ushtrime/Projekt/detyra	270
Laboratorë	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	255
Punimi i Diplomës	36
Në total	1191

Referenca për Standardin 2.4 / 4:

dok 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndes. Pika 12. 2)
dok 14.1 Plani mesimor MA Arte Skenike.)

Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Për të arritur objektivin e formimit të studentit ky program studimi ofron një kombinim adekuat ndërthurur midis teorikës dhe praktikës, si dhe mundëson transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Programet ofronjnë lëndë me theks të qartë praktik. Në përgjithësi, për organizimin e programeve të studimit dhe të planeve mësimorë, UET konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të organizuara në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel Departamenti, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.

Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u

Sipas rregulloreve të studimit parashikohet që syllabuset të përditësohen çdo fillim semestri, pasi konsultohen me përgjegjësin e grupit mësimor dhe miratohen nga përgjegjësi i Departamentit. Parashikohet përditësimi i literaturës sipas rregulloreve Dok. 7. Rregullore e programit të

<p>bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>studimit_MA Arte Skenike. Sipas Parimit të ndërtimit të lëndës “Pedagogu i lëndës duhet të përzgjedhë tekstin që i përshtatet më mirë disiplinës përkatëse midis manualeve të huaja, <i>text-book</i> ose <i>handbook</i>, të afirmuar për vlerat e tyre doktrinare, akademike e profesionale, kryesisht publikime të shtëpive botuese Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, si edhe botime me njohuri bazë ose të avancuara, të të njëjtave kritere, të shtëpive botuese Sage, Routledge, Pearson dhe Elsevier.”Ato duhet të jenë jo më pak se 5 vjet të vjetra.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.4 / 6:</u> dok 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit te programit te lendes A.III.12.2. Parimi bazë)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit, kurikulës dhe syllabusit përmbajtja e programit të studimit nxit mendimin krijues të studentëve. Kjo arrihet nëpërmjet Procesi mësimori cili zhvillohet me leksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, praktika mësimore, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe me punim diplome.</p> <p>Për ndërtimin e programeve ata bazohen tek: Parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës (Parimi i rrathëve) ku theksohet se:</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij parimi është të lehtësojë përshtatjen e studentëve që vijnë nga programe të ndryshme studimi, brenda ose jashtë UET-it, në një program studimi të një cikli më të lartë; plotësimi i njohurive për studentët që i përfundojnë studimet në njërin nga ciklet dhe nuk vazhdojnë më tej studimet e tyre. Parimi i rrathëve shtrihet në të gjithë strukturën pedagogjike dhe shkencore të lëndës ku përfshihet: përmbajtja e njohurive, metoda pedagogjike, bibliografia dhe kontrolli i njohurive.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.4 / 7:</u> dok 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit te programit te lendes A.III.4. Parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës (Parimi i rrathëve).</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit, kurikulës dhe syllabusit përmbajtja e programit të studimit nxit mendimin krijues të studentëve. Ai plotëson standardet për një program master i cili mund të pasohet me një program punësimi, apo studimor i ciklit të tretë.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e</p>	<p>Anëtarët e Bordit të Tregut Punës mblidhen një here në vit në Departament me qëllim përmirësimin e programit në raport me tregun e punës. Me qëllim përmirësimin e ofertës akademike, vendosjen e marrëdhënieve me institucionet që punësojnë studentët, si edhe ofrimin e mundësive konkrete për punësimin e tyre, Panairi i Punës, për vitin</p>

bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

akademik 2018 - 2019 u zhvillua në nivel Fakulteti, ndërsa është zhvilluar rregullisht çdo vit, në nivel Universiteti. Në mbledhjet e rregullta që zhvillohen me Bordin e Tregut të Punës, anëtarët e pranishëm janë shprehur se kërkesat për artistë krijues dhe interpretë janë në rritje, duke shtjelluar edhe arsyet përkatëse.

DEPARTAMENTI I ARTEVE TE APLIKUARA BORDI I TREGUT TE PUNES 2019-2020			
Nr.	Emri	Mbiemri	Pozicioni
1	Herida	Duro	Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor në Ministrinë e Kulturës
2	Abaz	Hado	Zv./Kryetar i Bashkisë - Tiranë
3	Abigjella	Voshtina	Drejtoreshë artistike - Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit
4	Kiço	Londo	Drejtor i Teatrit Eksperimental
5	Arijan	Tapelena	Drejtor programacioni - TV Scan
6	Redi	Nezir	Kryeinxhinier - TOP Channel
7	Sonila	Kapidani	Drejtoreshë e Sektorit të edukimit - Teatri Metropol
8	Besim	Petrela	Drejtor i Kulturës - Bashkia Tiranë
9	Arben	Skënderi	Instrumentist/Pedagog- Administrator i Studios së Produksionit muzikor ON/OFF
10	Alda	Bida	Skenariste & Producente - Administratore e Deliant Association

Takimi i fundit me Bordin e Tregut të Punës është zhvilluar më 25.06.2020

Referenca për Standardin 2.4/ 9:

dok 12.1 Bordi i Tregut të Punës - DAA.

dok 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi iTregut te Punes.pdf

Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve

Ky program studimor i plotëson të gjithë standardet që një student të vazhdojë studimet e nivelit të tretë, pasi ai promovon kërkimin individual të tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit

Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Për vitin akademik 2020-2021 personeli akademik efektiv PAE mbulon 82.5 % të ngarkesës mësimore, ndërsa 17.5 % mbulohet nga personel akademik me kontratë (PAK).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

36

	<p><u>Referenca për Standardin 2.5 / 1:</u> dok. 23. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë, gradat shkencore/titujt akademikë, Viti akademik 2020 – 2021 Tabela 1)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i arteve”, në UET e ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, si dhe drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Personeli përbëhet nga Prof. dhe Prof. Asc si titullarë lëndësh, apo modulesh dhe udhëheqës të veprimtarive kërkimore -shkencore.</p> <p>Konkretisht PAE ka:</p> <p>3 Prof. Dr. 2 Prof. Asc. Dr. 2 Dr. 10 MSC.</p> <p>Stafi është i kualifikuar dhe përshtatshëm për këtë program. Mes tyre spikasin personalitete të fushave si Bujar Kapexhiu, Ermir Nika, Abaz Hado, Shqipe Zani, Përparim Fuga, Nikolin Gurakuqi, Suzana Varvarica, Shaqir Veseli, Hivzi Muharremi, Ylljet Aliçka, Konstantinos Giakoumis, Pluton Vasi, Anila Zajmi, etj. Karriera dhe përvoja e tyre në vite e shtrirë për shumë dekada është një garanci me shumë për cilësinë e mësimdhënies për këtë Program studimor.</p> <p>GVJ gjatë takimit me këto personalitete konfirmoi besimin dhe përkushtimin e tyre për të përmbushur misionin që institucioni i ka ngarkuar vetes. Si i tillë, për të gjithë të rinjtë kreativë dhe me aftësi të spikatura interpretative, të vetëdijshëm për kohën në të cilën jetojnë, këto programe studimi mund të përbëjnë profesione të aspiruara, pasi në shoqërinë moderne të komunikimit të mbizotëruar nga imazhi, tingulli dhe paraqitja në publik, të cilat në nivel akademik teorik dhe praktik ofrohen në këto programe studimi në Master. Vërehet se në thelb ato kanë dhënë ekspertizën e nevojshme për t’u shndërruar në një faktor të rëndësishëm në jetën artistike në vend.</p> <p>Gjithashtu GVJ gjatë takimit me studentët diskutoi për bashkëpunimin e afërt që ata kishin me stafin akademik tyre në vitet e kaluara dhe më specifikisht në kushtet e pandemisë. Moment tejet i rëndësishëm për ta kishte qenë punimi në studiot e përbashkëta si dhe ato në punë të diferencuar. Gjithashtu ato shprehën me kënaqësi dedikimin dhe përkushtimin profesional të përçar nga stafi sidomos në periudhë e realizimit të diplomës.</p>




	<p>Përsa i takon ngarkesës mësimore (në orë) të ndarë midis stafit PAE dhe stafit PAK këto raporte për vitin akademik 2020-2021 janë bazuar në tabelën nr. 4 (25. Ngarkesa mesimore ne auditor e stafit akademik te programit MA_Arte Skenike (Aneks_Tabela 4)</p> <p>Pedagogët që japin mësim në Master “Arte Skenike” disa kanë ngarkesë edhe në programin Bachelor në cikël të parë. Nga një total prej 736 orë mësimore ngarkesë (si në programet e ciklit të parë, ashtu edhe në programet e ciklit të dytë, Master) pjesa më e madhe e tyre, 93.37 mbulohet nga personeli akademik me efektiv PAE. Sipas tabelës nr. 4, vetëm një pedagoge që jep mësim në Master është me statusin e PAK. Ngarkesa e saj në total është vetëm 48.75 orë mësimore që në totalin e orëve është 6.63%.</p> <p>Treguesi i raportit të orëve mësimore të personelit, i përlogaritur vetëm për programin Master në “Arte Skenike”, nga totali prej 505 orë ngarkesë mësimore të pedagogëve, vetëm 48.75 orë mësimore realizohen nga PAK dhe pjesa tjetër realizohet nga Personeli Akademik Efektiv. E shprehur në përqindje orë mësimore PAE/PAK është 90.34% ndaj 9.66%.</p> <p>Siç shikohet edhe nga raportet e mësipërme, orët mësimore të zhvilluar nga PAE ndaj orëve mësimore në total kanë qenë gjithnjë ato që kanë mbajtur ngarkesën kryesore, duke kryer mbi 90% të ngarkesës mësimore. Ngarkesa e pedagogëve PAE për programin e studimit Master në “Arte Skenike” luhet nga 62.5 orë mësimore, 78.75 orë mësimore dhe 315 orë mësimore.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.5/ 2:</u> Dok. 23. Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë, gradat shkencore/titujt akademikë, Viti akademik 2020 – 2021 Dok 20. CV të stafit</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Ata janë zgjidhur në harmoni dhe bazuar në specifikat e programit si dhe nga përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe karriera profesionale jashtë auditorit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.5/ 3:</u> Dok 11 Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerezore</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,</p>	<p>Institucioni për një organizim sa më të mirë të programit mësimor të përshatshëm me tregun e punës, mban marrëdhënie të ngushta me Bordet e Tregut të Punës, dhe kujdeset për mbarëvajtjen e praktikave profesionale. Me qëllim përmirësimin e ofertës akademike, vendosjen e marrëdhënieve me institucionet që punësojnë studentët, si edhe ofrimin e mundësive konkrete për punësimin e tyre, Panairi i Punës, për vitin</p>

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

akademik 2018 - 2019 u zhvillua në nivel Fakulteti, ndërsa është zhvilluar rregullisht çdo vit, në nivel Universiteti.

Për të rritur cilësinë e kësaj kërkese Zyra e Karrirës ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh private, mbarvajtja e të cilave mbikqyret nga një pedagog i caktuar nga departamenti. Përveç kësaj ka dhe marrëveshje me Universitetin e Arteve për shkëmbim pedagogësh dhe projektesh.

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Departamenti për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5)

Institucionet:	
1	Qendra Kulturore Bashkia Tirane Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 89 Prot. Date, 09. 04 2019.
2	Creature Studio Sh.p.k. Memorandum Bashkëpunimi Nr. 189 . Prot. Date 15. 07. 2019.
3	Onoff Production Memorandum Bashkëpunimi Nr. 196. Prot. Date, 16. 07. 2019.
4	Universiteti i Arteve Marrëveshje Bashkëpunimi Nr. 185 Prot. Date, 12. 07. 2018.

5 Greiss Petriviq PF (GRACE MODELS) Nr. 178 Prot. Date, 01. 10. 2020.

Nr.	Institucioni	Personi i kontaktit
1	Kompania Filmike AA	Aida Kasemi
2	Agna Group	Greta Hysi
3	Onoff Production	Julinda Hasa
4	Botimet Muzgu	Mark Simoni
5	Studio Grafike dhe botimet Migeeralb	Erald Jaku
6	Ombra GVG	Vasilika Tafa
7	Studio dhe Atelie Pikturë " Nini "	Alfred Nini

Pjesa më e madhe e personelit të brendshëm janë të angazhuar në veprimtari artistike dhe kulturore si edhe në kërkim shkencor dhe njëkohësisht janë drejtues grupesh kërkimore, ndërsa një sugjerim për përmirësim do të ishte përfshirja në këto procese të punës kërkimore në nivel grupi edhe të studenteve, kryesisht në këto programe pra, në Master i Shkencave.

Referenca për Standardin 2.5/ 4:

Dok 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MA Arte Skenike.pdf

Dok 34 mbi marrëveshjet,

Dok. 32 mbi praktikën mësimore,

Dok. 12 mbi Zyrën e Këshillimit dhe karrierës,

Dok. 34. 9 marrëveshja me UA.

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve

Si njësi ndihmëse institucioni konsideron sallat skenike, laboratorët, atelierët, bibliotekat. Personeli ndihmës sigurohet për realizimin me sukses të proceseve mësimore në këto hapsira.

laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	GVJ gjatë vizitës në institucion pati kënaqësinë të takohet me shumëprej tyre në ambjete të punës. Aty ata shpjeguan me imtësi procesin e ndihmës që ato ofronin për mbarvajtjen me sukses të mësimin.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Një analizë periodike e zhvilluar në bazë fakulteti e departamenti zhvillohet në bashkëpunim me përfaqësues të tregut të punës dhe studentëve, për një sinkronizim sa më të mirë të programit me tregun. <u>Referenca për Standardin 2.6 / 1:</u> Dok. 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi i Tregut të Punës.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët përfshihen sipas Planit strategjik 2015-2020 sipas statutit të UET, si anëtarë të Senatit e Këshillit të Etikës, dhe KSBC dhe marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Bordit të Tregut të Punës. <u>Referenca për Standardin 2.6/ 2:</u> Dok. 3 Plani Strategjik, Dok. 2 Statuti i UET, Dok. 30. 4 KSBC
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Sipas Statutit, UET (pika 3.) institucioni angazhohet maksimalisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë UET, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ALUMNI-t në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UET. <u>Referenca për Standardin 2.6 / 3:</u> Dok. 3 Statuti UET, pika 3

Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi

Programe të posaçme që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së mësim dhënies dhe ofertës për tregun janë gjithnjë në focus të institucionit.

Psh. UET është institucion partner i projektit “VTECH: Accelerating Western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies”, organizuar nga një konsorcium prej 11 partnerësh në kuadër të programit Erasmus+. Aktualisht, një nga pedagogët e programeve BA Arte Skenike dhe DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, si dhe dy studentë të programeve të Arteve Skenike janë angazhuar në trajnimet ONLINE të këtij projekti mbi teknologjinë Realitetit Virtual dhe Dizajnit të Interaksionit në fushën e edukimit, të drejtuara nga ekspertë të huaj nga Universiteti i Ljubjanës në Slloveni.

Një projekt i rëndësishëm ishte dhe Polyphonia 2018-2020 (në partneritet me institucione europiane) ku Koordinator për ngritjen e qendrës kulturore Dropull si dhe për aktivitetet e Karvaneve ishte Kristi Bello (Përgatitës i studimit përkatës).

Polyphonia Project – i lidhur me vlerat dhe traditën polifonike në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit. Projekti është në kuadër të programeve IPA midis Shqipërisë dhe Greqisë. Partner i projektit është edhe bashkia e Dropullit dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës në Vlorë. Roli i universitetin është mjaft i lidhur me hartimin e studimeve të qenësishme për polifoninë. Gjithashtu në këtë projekt do të përfshin edhe studentët e këtij programi studimi në “5 karvanet e polifonisë” që do të realizohen në vijim të realizimit të projektit. Deri tani janë realizuar tre studime nga profesorët e UET: Ylljet Aliçka, Kristi Bello dhe Ermir Nika.


Referenca për Standardin 2.6 / 4:

Ddok 33. Trajnime te metejshme profesionale - Departamenti Arte te Aplikuara.pdf
Dok. 43.2 Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021.pdf

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet	Përbushet
	plotësisht	pjesërisht	kryesisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Sipas rregullores së studimit, Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. E gjithë kjo ndërtohet në harmoni mes punës kërkimore shkencore dhe asaj artistike, detyrave të kursit, shfrytëzimit të literaturës dhe punimit të diplomës.</p> <p>Objektiva strategjike të këtij programi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Formimi akademik, shkencor dhe bashkëkohor i studentëve, mbështetur në prioritetet strategjike përkatëse, që lidhen me rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies, lidhur me lëndët specifike të fushës së arteve Skenike. ▪ Ofrimi i një diplome cilësore dhe elitare në programin Master i Arteve në “Arte Skenike” në Shqipëri. ▪ Përputhja optimale e dijeve akademike në fushën e arteve Skenike me aftësitë e kërkuara në tregun e punës dhe mundësimi i një niveli të lartë punësimi. ▪ Tërheqja e një numri optimal studentësh. <p><u>Referenca për Standardin 2.7 / 1:</u> Dok. 4 Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, përmbush standardet e strukturës akademike dhe detyrimet ligjore. Ai përbëhet nga 3 departamente: Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit, Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve dhe Departamenti i Arteve të Aplikuara. Ai nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Ai organizon periodikisht Forume, konferenca e bashkëbisedime me pedagogë e student. Një nga ato është konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare, dhe Forumet e UET.</p>






DSSH VII/2020
DIPET E STUDIMEVE SHQIPTARE
Adhoni në ditën 10/07/2020 në adresën e afsh@al



AXHENDA

E PREMTE, 4 DHJETOR 2020, ORA 13:00

REFORMAT E MUNGUARA TË TRANZICIONIT

Selami Xhepa



POLITIKAT PUBLIKE TË MIRËQENIES SOCIALE, SHQIPËRIA 1990-2020.

Arlinda Ymera



SHPRESAT DHE ZHËNËJIMET E TRANZICIONIT DEMOKRATIK

Fatos Tarifa



PROCESI I REFORMAVE NË DREJTESI GJATË TRANZICIONIT DHE ARRITJET E TIJ

Shefqet Muçi



SFIDAT E REFORMËS SHËNDETËSORE NË SHQIPËRI

Piero Prifti



INDUSTRIA NË SHQIPËRI NË 2020, PAS 30 VITEVE TRANZICION.

Arben Dushi



REFORMIMI I KURRIKULËS SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR SHQIPTAR-SFIDË POLITIKE, MË SHUMË SE SFIDË PROFESIONALE

Tomi Treska





DIPLOMË PROFESIONALE / BACHELOR / MASËR PROFESIONALE / MASËRË SHKENCËRE / MASËRË DREJTËSIE / PROGRAMET E INTEGRUARA / DOKTORATURË				
Niveli i kualifikimit të studentëve në të gjithë nivelet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe në shtetet fqinje të Ballkanit dhe Evropës së Jugut. Niveli i kualifikimit të studentëve në të gjithë nivelet e arsimit të lartë në shtetet fqinje të Ballkanit dhe Evropës së Jugut.				
PROG. I KUALIF. I DREJTËSIE E TËRËT	PROG. I KUALIF. I DREJTËSIE E TËRËT	PROG. I KUALIF. I DREJTËSIE E TËRËT	PROG. I KUALIF. I DREJTËSIE E TËRËT	PROG. I KUALIF. I DREJTËSIE E TËRËT

Referenca për Standardin 2.7 / 2:
Dok. 56. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)

Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.

Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Kjo arrihet nga detyrat e kursit, puna në terren, projekte kërkimore, konferenca, dhe aktivitete artistike. Në Universitetin Europian të Tiranës janë krijuar edhe funksionojnë disa klube studentore. Qëllimi i këtyre klubeve është që të pasurojë jetën sociale, artistike si edhe kulturore të studentëve si dhe të ofrojë mundësi për zbatimin në praktikë të njohurive edhe shpалosjen e talenteve të tyre. Çdo klub studentor është i organizuar në mënyrë të tillë ku përveç anëtarëve, janë edhe drejtuesit e çdo grupi si edhe mentori i cili është anëtar i stafit akademik. P.Sh. Klubi studentor UET Theater Colony, ka zhvilluar një sër shfaqjesh në këtë universitet dhe mbetet një mundësi për të gjithë ata student të cilët dëshirojnë të ushtrojnë pasionin, talentit dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e artit skenik, nëpërmjet bashkëveprimit aktiv me studentët e tjerë, si dhe mentorimit nga pedagogë të kualifikuar në fushat përkatëse”

	<p>Në bashkëpunim me organizma të tjerë të UET, Departamenti i Arteve të Aplikuara gjithashtu organizon evente apo aktivitete ku marrin pjesë studentët e të gjitha programeve të departamentit, si UET Talent dhe UET Arts Festival. Këto takime, workshop-e apo evente janë zhvilluar së bashku me të gjithë studentët e programeve që ofrohen nga ky department. Këto aktivitete shërbejnë gjithashtu për të forcuar frymën e bashkëpunimit dhe komunikimit në grup dhe veprimtarisë multi-disiplonore në art.</p> <p>Në takim GVJ me studentët dhe pedagogët u informua për projekte, forumet, workshopet, ekspozita etj., që organizoheshin periodikisht në UET dhe shërbenin si për pjesën akademike të mësimin, ashtu edhe për t'u dhënë mundësi studentëve për t'u përfshirë në aktivitete ekstrakurikulare.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.7/ 3:</u> Dok 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese_artistike_Departamenti i Arteve të Aplikuara.pdf Dok.33.1 Kalendar i aktiviteteve.pdf Dok. 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Sikurse përshkruhet edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021-2025, UET synon ta konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes. Kjo është reflektuar edhe në programin e studimit Master i Arteve në “Arte Skenike” nëpërmjet syllabuse të lëndëve, praktikave dhe detyrave të tjera të kursit.</p> <p>Po kështu edhe në startegjinë e kërkimit shkencor është saktësuar në vizionin e UET se:</p> <p><i>“1.1 UET synon shndërrimin në një qendër ekspertize në fushën e studimeve shoqërore, humane, juridike, ekonomike dhe teknologjisë së informacionit. Synim i mëtejshëm është kthimi i UET në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal. Këto synime, UET përpiqet t'i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.”</i></p> <p><u>Referenca</u> Dok. 3.2 Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021-2025</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Sikurse përshkruan në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në rang universiteti UET i ka dedikuar kërkimit shkencor një shumë rreth 75,000 euro në vit. Kjo shumë inkurajon stafin në humultime, publikime, të cilat shpërblehen financiarisht me grantet përkatëse. Kjo pasi pjesë e rëndësishme e synimit të UET është krijimi i një klime të favoshme e stimuluese për kërkimin shkencor.</p>

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Kërkimi shkencor drejtohet nga Njësia kryesore dhe ato bazë, ndërsa projektet inkurajojnë dhe mundësojnë ato. Studimet empirike dhe objektivat e PMK stimulohen dhe mbështeten nga grupet kërkimore të PMK (Projektet e mëdha kërkimore) dhe zërat e përfshirë në të.</p> <p>STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR NË UET (2021-2025) thekson që:</p> <p>UET synon të konsolidojë identitetin e universitetit si qendër e prodhimit të dijes në Shqipëri e të transformohet nga një institucion i arsimit të lartë i fokusuar në mësimdhënie, në një institucion elitar kërkimor, produkti kërkimor i të cilit kërkohet nga tregu dhe përmirëson në vazhdimësi mësimdhënien dhe eksperiencën studentore në UET. Për të arritur këtë, kjo strategji detajon objektivat dhe instrumentet që do të përdorë UET për të strukturuar, përparuar, standardizuar dhe ndërkombëtarizuar kërkimin shkencor.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.8 / 1:</u> dok 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Grupet drejtuese të PMK janë mekanizmi për kontrollin e brendshëm të cilësisë, vendosin për punimet që pranohen në DSSH dhe orientojnë kërkimin shkencor të <i>Junior Researchers</i>. Doktorandët atashohen pranë grupeve kërkimore, duke stimuluar një debat dhe cilësië kërkimi më interdisiplinor.</p> <p>Departamenti i Arteve të Aplikuara synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët.</p> <p><u>Referenca për Standardin 2.8 / 2:</u> Dok 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Aktiviteti kryesor i kërkimit shkencor është konferenca e përvitshme Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare, organizuar me panele sipas fakulteteve dhe PMK. Ato të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>

Konferenca Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)

UET synon ta konsolidojë DSSH si 'conference of record' për zhvillimet në hapësirën shqiptare. 10.2Që DSSH të konsolidohet si konferenca më prestigjioze në Shqipëri dhe të pranohet si e tillë edhe nga komuniteti shkencor ndërkombëtar ajo aplikon standardet e mëposhtme:

1. Prezantimet janë në anglisht.
2. Nuk pranohen prezantimet me poster.
3. Artikujt/abstraktet mbi të cilët bazohen prezantimet dorëzohen 1 javë përpara [SEP]konferencës dhe vendosen në faqen e DSSH që të jenë të lexueshme nga pjesëmarrësit [SEP]e konferencës.
4. DSSH ka një faqe të dedikuar website ku pasqyrohen punimet e prezantuara.
5. Për çdo prezantim ka një diskutues (discussant) nga paneli përkatës i cili do të bëjë një [SEP]analizë analitike të punimit që do të shërbejë si baza e diskutimeve të mëtejme.
6. Tërësia e këtyre standardeve, në kohë, do të bëjë që DSSH të krijojë një profil të pakonkurueshëm shkencor në hapësirën shqiptare i cili do të forcojë më tepër karakterin shkencor të UET dhe do të lehtësojë ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor në UET.

Përveç kësaj UET organizon:

- Projektet e Mëdha Kërkimore (PMK);
- Revistat Polis, Economicus dhe Medicus (*Polis, Economicus* dhe *Medicus* shërbejnë për 1) kërkues shkencor që të publikojnë kërkim shkencor original dhe 2) për universitetin që të konsolidojë identitetin e tij shkencor.)
- Bordi i Botimeve Shkencore ne UET Press (UET Press është një nga mekanizmat më të suksesshëm nëpërmjet të cilit UET ka pasuruar botimet në Shqipëri me përkthime të veprave klasike dhe me botime origjinale shkencore të autorëve shqiptarë. Falë UET Press, sot shkenca shqiptare është më e pasur dhe studentët kanë shumë mundësi për të përthithur dije.)
- Anuarët e Filozofisë, Rrethi Liberal i Dardhës dhe Ditët e Letërsisë
- etj.


Referenca për Standardin 2.8/ 3:

dok 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020.pdf

	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
--	----------------------	---------------------	----------------------


Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Ynëzshmëri e përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar udhëzues për hartimin e syllabuseve, metodës së mësimdhënies, literaturës, sistemit të kontrollit, vlerësimit të dijeve, këshillit akademik dhe tutoriatit. Gjithashtu institucioni ka hartuar udhëzues për kontrollin e cilësisë së procesit mësimor dhe zhvillimin e mësimdhënies, si dhe trajnime për personelin për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe ato të kërkimit shkencor. Këto shoqërohen me botime, publikime projekte shkencore dhe aktivitete zhvilluese.</p> <p>Në kushtet e Pandemisë Covid 19, Universiteti ka vendosur një rregullore të përshtatur me direktivat ligjore që rrodhën nga situata pandemike botërore. Rregullorja e parë anti Covid-19 u miratuar në dt. 22.10.2020 dhe u përditësua me dt. 2.11.2020.</p> <p>Ato përcaktojnë nga parimet e përgjithshme, bazën ligjore dhe objektivat) deri tek organizimin e procesit mësimorë, orarin, kontrollin e dijes dhe vlersimet, frekuantimin, provimet, platformën online TEAMS etj.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.1 /1:</u> Dok. 5 5. Rregullore e UET.) Dok. 38, Analiza e departamentit përgjegjës. Dok 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve. Dok 35 Raporti analitik i perfitimeve nga mareveshjet e bashkepunimit Dok 5.2. Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19 Dok 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Monitorimi periodik i stafit akademik realizohet në disa nga plane, jo vetëm nga strukturat drejtuese, por edhe studentët. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimit të Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe/ose përgjegjësit të grup-lëndës përkatës; 2. Vlerësimit të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatën e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; 3. Vetëvlerësimit; 4. Rezultateve të raporteve të KSBC-së;

	<p>5. Vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (<i>follow-up</i>).</p> <p>6. Zhvillimi i leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.1/ 2:</u> Dok. 5 neni 22 5. Rregullore e UET.)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Kjo realizohet nëpërmjet takimeve periodike me “<i>fokus group</i>” si dhe pyetësorëve semestralë mbi lëndën, pedagogun dhe programin. Gjithashtu studentët shfaqin mendimet e tyre, ankesat apo sugjerimet dhe në mbledhjet e departamentit dhe në Zyrë e kujdesit ndaj studentit, apo dhe vetë drejtuesve të departamentit sipas rregullores.</p> <p>Universiteti European i Tiranës i kushton një vëmendje të veçantë, studentëve të cilët janë aktualisht në sistem dhe atyre të diplomuar, për të përmirësuar aftësitë e tyre profesionale. UET përpiqet që nëpërmjet, aktiviteteve të ndryshme të ndihmojë sa më tepër studentët për zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale.</p> <p>Orientimi i studentëve në lidhje me profesionin, profilin që ato do të zgjedhin më pas, është shumë i rëndësishëm të realizohet që gjatë studimeve, për të shmangur problematikat që pengojnë ushtrimin e profesionit. Për këtë arsye, Departamenti i Arteve të Aplikuara ka organizuar disa takime dhe workshop-e me personalitete në fusha të ndryshme të arteve për të ndihmuar më tej studentët në formimin e tyre. Më shumë pasqyrohet në dok 43.2 Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021.pdf</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.1/ 3:</u> Dok 33. Trajnime te metejshme profesionale - Departamenti Arte te Aplikuara.pdf Dok 43.2 Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit, në një moment të përshtatshëm pas përfundimit të procesit mësimor. Ato përpunohen nga KSBC dhe i komunikohen autoriteteve drejtuese, të institucionit dhe Departamentit, ku dhe merren masat e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit</p>	<p>Pas vlerësimit, të dhënat pasi përpunohen pasqyrojnë problematikat dhe merren masa për zgjidhjen e tyre nëpërmjet trajnimeve apo formave të tjera.</p>




dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësim-nxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, leksion/seminare, detyra kursi, praktikat profesionale, punimi i diplomës dhe çdo forma të miratuar nga institucioni. Kontrolli i dijeve bëhet periodikisht që të merren masa për një përfundim semestral sa më të suksesshëm. Leksionet e hapura zhvillohen nga Departamenti për të njohur Tregun e Punës, si dhe me ekspertë të fushës së Artit.</p> <p>Departamenti i Arteve të Aplikuara synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standardeve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, veprimtarive artistike dhe kulturore, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboreve, etj.</p> <p>Përveç kësaj shumë të rëndësishme janë projektet, aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese artistike zhvilluar të shumta në Departamentin e Arteve të Aplikuara</p>

	Numri i studentëve të aktivizuar	Pedagogu që i ka aktivizuar
Për punime shkencore ose artistike individuale të pedagogëve	Nuk ka	
Për projekte artistike në rang Departamenti		Ermir Nika Kristi Bello Enkeleida Prifti Dritan Borici Anila Zajmi Katanolli Suzana Kuka Varvarica
Për projekte shkencore ose artistike në rang Fakulteti		Ermir Nika Kristi Bello Enkeleida Prifti Dritan Borici Anila Zajmi Katanolli Suzana Kuka Varvarica
Për projekte shkencore ose artistike në bashkëpunim me të tjerë		Ermir Nika Kristi Bello Enkeleida Prifti Dritan Borici Anila Zajmi Katanolli Suzana Kuka Varvarica

Referenca për Standardin 3.2/ 1:
Dok 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi iTregut te Punes.)
Dok 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese _artistike_ Departamenti i Arteve të Aplikuara.
Dok 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MA Arte Skenike.
Dok 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike

Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.

Për studentët krijohen mundësi të barabarta, por dhe metoda të ndryshme mësimdhënie, përveç metodës klasike për tu përshtatur me dinamikën e secilit prej tyre, si individ apo në grup.



Përveç kësaj sipas Rregullores së Studimit
- Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion programet dhe materialet për çdo lëndë që ofrohet. Pedagogu i lëndës vendos në sistemin LMS, syllabusin së bashku me leksionet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar të lëndës. Përmes këtij sistemi studentët njoftohen për detyrat që pedagogu cakton, si edhe informohen për rezultatet e vlerësimit. Gjithashtu ata mund të komunikojnë me pedagogun e lëndës për çdo paqartësi apo pyetje. [SEP] Këshillimi akademik është veprimtari, jashtë auditorit, në shërbim të studentëve, ku pedagogët qëndrojnë në dispozicion të studentëve për t'i këshilluar, për t'i ndihmuar në përfundimin me sukses dhe në kohën e duhur të detyrimeve akademike. Grafiku i organizimit të këtij shërbimi publikohet në fillim të çdo semestri. [SEP] Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të tretë të studimeve.

Referenca për Standardin 3.2/ 2 :
Dok 7 Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme

Trajnimi i pedagogëve strukturrohet nga stafi akademik në përputhje me gradën shkencore të pedagogut. Ky program quhet Dita e Zhvillimit të Stafit dhe synon trajnimin e tyre lidhur me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë. Gjithashtu



<p>e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>zhvillohet dhe trajnimi dy ditor, çdo fillim viti akademik, “<i>Back to work</i>” që informon mbi programet e shkëmbit të stafit me partnerët përëdimor, me eksperiencat e tyre në fushën e mësimdhënies.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3. 2/ 3:</u> dok 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve.)</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli sipas dosjeve të CV dhe syllabuseve disponon grada shkencore, tituj akademik dhe eksperiencë profesionale të mjaftueshme, të cilat janë përshtatur me programin, lëndët dhe temat specifike. Ata përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni UET vlerëson sistematikisht dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Autoritetet vlerësojnë problematikat dhe marrin masa për përmirësimin e situatës.</p> <p>Edhe nga takimet mes stafit pedagogjik dhe GVJ u pasqyrua angazhimi i tyre për t’u përshtatur sa më mirë me individualitetin e çdo lënde dhe nevojën për ta azhornuar atë vazhdimisht, për të arritur kështu një performancë sa më të suksesshme pedagogjike.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Kjo arrihet duke kërkuar angazhimin e vazhdueshëm të studentëve, si dhe duke ndërthur teorinë me praktikën, diskutimet, punën në grup dhe aktivitete artistiko-kulturore.</p> <p>Edhe nga diskutimet mes studentëve dhe GVJ u pasqyrua angazhimi i stafit pedagogjik për t’u përshtatur sa më mirë me individualitetin e çdo student si edhe për të arritur kështu një performancë sa më të suksesshme përfutuese - mësimore.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik inkurajon ndjenjën e autonomisë të studentit, orientuar drejt një literature të rekomanduar, edhe jashtë programit. Stafi akademik nxit bashkëpunimin mes tyre me detyra kursi në grup, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzime specifike, sipas programit dhe shpesh përtej tij. Duke pasur parasysh që lëndën kryesisht janë praktikë dhe krijimtari aristike, lind nevoja që sensi i autonomisë të studentit të kthehet në një subjekt konstant kuptimor dhe zhvillimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Ato përbëhen salla leksionesh, e seminaresh, me sistem kondicionimi, wireless, pc, videoprojektor, dhe mjete didaktike të nevojshme. Zyra TI mirëmban mjetet teknologjike, rrjetin, lab e informatikës etj. ndërsa stafi i mirëmbajtjes merret me pastrimin e ambienteve. Për programin e Arteve ka 3 klasa për detyrat e vizatimi, pikturës dhe dizanjit si dhe hapsirën e Tirana Design Academy.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>UET ka 33 salla leksionesh e seminaresh, prej të cilave 3 janë dedikuar artit. Të tre ato kanë pc, projektorë dhe foni. Ato janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p> <p>Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarë, përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrains; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj.</p> <p>Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.3/ 2:</u> Dok 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.pdf</p>



<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme in formatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>UET përdor sistemin MOODLE (UET LMS) me të cilin studentët mund të ndjekin në kohë reale çdo material të hedhur nga pedagogu i lëndës.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë e institucionit disponohet në bibliotekë, hapësirë që azhurnohet periodikisht me botimet e fundit në ndihmë të pedagogëve dhe studentëve. Gjithashtu ajo është dhe abonuar me shumë libra eletronikë Sage & Ebsco dhe Questia. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës i dedikohet artit pamor në shërbim të programit në fjalë, por e përshtatur me programin është në gjuhë angleze.</p> <p>Sipas informacionit të ofruar u konstatua se: Biblioteka është e vendosur në Godinën C, me një sipërfaqe prej 300 m² dhe 150 vende leximi.</p> <p>Fondi i Bibliotekës për vitin akademik 2020-2021 është: Totali i librave Bruto, Periodik, CD & Harta 6425 tituj. Libra në gjuhën shqipe 4931 tituj. Libra në gjuhë të huaj 1466 tituj. Periodik total përafërsisht 170 tituj. Periodik shqip përafërsisht 105 tituj. Periodik në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht) përafërsisht 67 tituj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fakulteti Ekonomisë Biznesit dhe Zhvillimit 1392 tituj. - Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare 2755 tituj. - Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale 1861 tituj. - Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës 203 tituj. - Fakulteti i Mjekësisë 22 tituj, 147 artikuj në format elektronik PDF dhe 115 Libra në format elektronik PDF. • CD & Harta 85 <p>Sidoqoftë vihej re një katalog të pasur me libra fizik dhe online, në gjuhë shqipe dhe të huaj, por sugjerohet një pasurim me botimet më të fundit për artin vendas, kryesisht të realizuar nga autorë/pjesë e stafit të vetë programit, si dhe vihet re një literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, e shprehur më shumë në lëndët teknike të profesionit. Sugjerohet përkthimi i tyre gradual, në funksion të proceseve të të mësuarit për studentët e programit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.3/ 4:</u> dok 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.pdf</p>

<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e institucionit e orientuar nga kërkesat e pedagogëve dhe studentëve garanton numër të madh botimesh. Kjo hapësirë funksionon me 150 vende leximi, 12 kompjutera dhe wireless. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale ka 1861 tituj. Si e tillë ajo ka një katalog të pasur, por sugjerohet një pasurim me botimet më të fundit për artin vendas, kryesisht të realizuar nga autorë/pjesë e stafit të vetë programit, si dhe vihet re një literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, e shprehur më shumë në lëndët teknike të profesionit. Vihet re nevoja për plotësimin e saj/përkthimin gradual, në funksion të proceseve të të mësuarit për studentët e programit.</p> <p>Referenca për Standardin 3.3 / 5: dok 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka mundëson aksesin online dhe një staf në ndihmë të pedagogëve dhe studentëve. Ajo ofron akses nga shumë biblioteka të tjera online të huaja. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia. Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaj i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve në bazë të interesave të tyre akademike.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sallat e Departamentit të Artit kanë PC dhe projektorë ku studentët mund të realizojnë detyrat e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, si dhe hapësirat e laboratorit të Tirana Design Accademy.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësi të vizitonte shumë prej tyre, si dhe për të konstatuar cilësinë e aparaturave dhe stafit mbështetës.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>UET përdor platformat online UET LMS dhe Microsoft Teams. Sipas udhëzimeve të Ministrisë këto programe kanë qenë funksionale për zhvillimin sa më normal të mësimin, gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p>Në kushtet e Pandemisë Covid 19, Universiteti ka vendosur një rregullore të përshtatur me direktivat ligjore që derivuan nga situata pandemike botërore. Rregullorja e parë anti covid u miratuar në dt. 22.10.2020 dhe u azhornua me dt. 2.11.2020.</p> <p>Ato përcaktojnë nga parimet e Përgjithshme, Bazën ligjore dhe objektivat) deri tek Organizimin e procesit mësimorë, orarin,</p>

	<p>kontrollin e dijes dhe vlerësimet, frekuentimin, provimet, platformën online TEAMS etj.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, u njoh me platformat që përdor institucioni për të komunikuar në distancë me studentët. Për përdorimin sa më komod të këtyre platformave, janë zhvilluar trajnime nga zyra e TI.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.3/ 8:</u> dok 5.2. Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19.pdf</p>			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Këto hapsira përdoren dhe nga stafi pedagogjik dhe studentët për komunikimit të brendshëm si dhe për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	<p>Departamenti orienton paraprakisht studentët bazuar në ekspertizën e stafit pedagogjik mbi orjentimin që ata duhet të përzgjedhin. Personeli akademik pasi orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Për fazat aplikimit deri në dorëzim është përpiluar dokumenti B. II (mbi punimin e diplomës).</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.3 / 10:</u> dok 45. Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit.pdf dok 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Vlerësimi periodik i veprimtarisë shkencore dhe mësimdhënies kryhet nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili sugjeron ndryshimet dhe përmirësime e nevojshme sipas Statutit të UET. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive [1]mësimore e kërkimore-shkencore, të UET-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me [2]dokument të veçantë.</p> <p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore,</p>

shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET-it. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET-it, njësisive të tij, programeve, kurikulave, shërbimeve etj. Ai ka për qëllim kryesor “Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në UET, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative.”

Bashkëveprimi me njësitë e tjera bazë siguron rezultatet e kërkuara në cilësi dhe ndërveprim. Psh. KSBC-ja ndërton komunikim të rregullt me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Kryetari i KSBC-së është njëkohësisht edhe koordinatori institucional i UET për marrëdhëniet me ASCAL-in.

KSCB ka shpërndarë relacionit të KSBC mbi syllabuset siç pasqyrohet në dok 30.7

Përveç kësaj ato kanë në plan veprimi të pasqyruar si më poshtë.

PLAN VEPRIMI PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË NË UET
Viti Akademik 2020-2021

KOMPONENTI	AKTIVITETI	OBJEKTI	
A. Mësimdhënia, mësimdhënia dhe vlerësimi	1. Vlerësimi i silabuseve	Te gjitha lëndët që ofrohen në programet e studimit	Ser
	2. Pyetësoni online i studentëve	Stafi akademik i angazhuar në programet e studimit	Shi Ma
	3. Monitorim/Vlerësim i procesit të hedhjes së notave, plotësimi dhe administrimi i dokumentacionit	Sekretaria mësimore	Për Ser
B. Kërkimi shkencor	1. Vlerësim i realizimit të punëve kërkimore-shkencore në nivel Departamentit	Departamentet	Ko
	2. Vlerësim i përfshirjes së studentëve në punët kërkimore-shkencore në nivel Departamentit	Departamentet	Ko
C. Mbashtetja e studentëve	1. Pyetësoni i studentëve (fokus grupe)	Stafi akademik / programet e studimit / Stafi administrativ / shërbimet e tjera	Se
	2. Monitorim/Vlerësim i nivelit të përfshirjes së studentëve në vendimmarrje	Departamentet / Fakultetet / Rectorati	Pë Ko
	3. Monitorim/Vlerësim i zhvillimit të orëve të tutorialit dhe seancave metodologjike	Departamentet	Pë Ko
	4. Monitorim/Vlerësim i trajtimit të ankesave të studentëve	Departamentet / Fakultetet / Rectorati	Pë Ko

Referenca për Standardin 3.4/ 1:

Dok 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf

Dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.pdf



Dok 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset.pdf

30. Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Aneks_Tabela 24).pdf

30.1 Plani veprimi KSBC.pdf

30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.pdf

	<p>30.3 Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022.pdf 30.4 Urdher Administrativ Mbi perberjen e KSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies është Njësia Kryesore dhe ajo Bazë / Departamenti. Dekanati ka në funksion: Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së Dekanatit e ka Dekani.^[1] Agjendën e mbledhjes e përcakton dhe e miraton Dekani i Fakultetit, i cili merr parasysh edhe mendimet dhe sugjerimet e anëtarëve të tjerë të Dekanatit.^[1] Vendimet në Dekanat merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statutin e UET-it.^[1] Dekanati i zhvillon mbledhjet e tij kur të pranishëm janë jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Dekanati mbledhet jo më pak se 2 (dy) herë në muaj.^[1] Kalendari i mbledhjeve, së bashku me agjendën formale të tematikës së mbledhjeve përcaktohet dhe miratohet në fillim të çdo viti akademik.^[1] Procesverbalet e mbledhjeve dhe vendimet e Dekanatit protokollohen. Njësia Bazë është përgjegjës dhe për syllabuset, ngarkesën mësimore, për rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët dhe për cilësinë në programin e studimit që ofron. Në dok 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit theksohet që: “Departamenti është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, kryen aktivitetet mësimdhënës e shkencor, si dhe shërbime administrative.” Funksionet e Departamentit përfshijnë tri sfera të gjera dhe të ndërthurura të aktivitetit: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe veprimtari administrative. Në drejtim të mësimdhënies. Në drejtim të kërkimit shkencor. Veprimtari administrative: Etj. Referenca për Standardin 3.4/ 2: Në dok 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.pdf.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja inovative të mësimdhënies zhvillohet nga stafi akademik në Departament, më</p>

dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.

specifikisht në syllabuse ku kërkohet dhe pasqyrimi i metodës së mësimdhënies.

KODI: A.III.5.1/PROGRAMI I LËNDËS:¹

(emri i lëndës)

Shënim: Të gjitha shënimet brenda kllapave, me të pjerrëta, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim

Titullari/ pedagogu i lëndës (për programet profesionale): (emri, titulli akademik, grada shkencore, dhe nënshkrimi)

Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)

Viti akademik/ Semestri kur zhvillohet:

Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje)

Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)

Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës:

Kodi i Etikës: A.II. Kodi i Etikës/ Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe të rregullores së UET-IT.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET TË NXËNIT (Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të përvehtësojë në përfundim të lëndës).

KONCEPTET THEMELORE: (janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda)

1.

2.

3.

...

TEMAT E KURSIT² shpjegimi (rreth një paragraf) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe). Si rregull, duhet të evitohet hyrja/historiku i lëndës si temë më vete e kursit. Në rast se do përfshihen edhe lektorë të ftuar, shënoni përmbajtjen e tyre. Përfshirja e tyre duhet të përmbajë një cikël leksionesh prej tre temash, që mund të zhvillohen jo patjetër në vijim të njëra tjetrës.

Vërejmë që aty për temën specifike përcaktohet Titullari, Ngarkesa, Viti akademik, Lloji i lëndës, etj. si dhe tema, metodologjia pedagogjike dhe literatura.

Në syllabus pasqyrohen dhe i metodave të reja inovative të mësimdhënies në harmoni me Rregulloren e Studimit dhe Ligjet ne fuqi.

Referenca për Standardin 3.4/ 3:

dok 19.1. Formati i Syllabusit.

dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.pdf.

Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Personeli akademik vazhdimisht shton përpjekjet për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe kualifikimin shkencor. Kjo arrihet nëpërmjet stimulimit, përfshirjes dhe evidentimit të botimeve personale, si monografi dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Aktivitete individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit		
1.	Numri i aktiviteteve / botimeve nga personeli akademik efektiv i Departamentit	22
2.	Numri i projekteve kërkimore ose artistike të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti	
3.	Numri i projekteve të zbatuara në shkallë Departamenti/Fakulteti	36
4.	Numri i aktiviteteve shkencore ose artistike të organizuara nga Departamenti/Fakulteti dhe IAL, për programin e studimit	36
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore ose artistike	
6.	Numri i Çmimeve Kombëtare të fituara në rang IAL	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

59

	Referenca për Standardin 3.4/ 4: Dok 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MA Arte Skenike.pdf			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Trajnimet me synim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja realizohen nga bashkëpunimi dhe shkëmbimet me institucionet e tjera në Programe si Erasmus Plus Kal, si dhe shkëmbimet me lektorë të ftuar.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës-akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës-akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Kjo arrihet nga azhurnimi i vazhdueshëm me metodat inovative të mësimdhënies.</p> <p>Psh metoda të ndryshme metodologjike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëbisedim, ilustrim, demonstrim, angazhim konkret - Leksioni dhe metoda sokratike - Bisedë dhe leksion i hapur - konkretizimi vizual i trajtimeve teorike - Diskutime në grup dhe ushtrime në grupe të vogla <p>etj</p> <p>Referenca për Standardin 3.4 /6: 19. Syllabus_arti_konceptual_dhe_performanca_MA.pdf 19. Syllabus_audio_dhe_video_media_MA.pdf 19. Syllabus_animacion_3D_MA.pdf 19. Syllabus_metoda_kerkimi_sasiore_MA.pdf</p>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës-akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik dhe personeli ndihmës-akademik azhurnon metodat e mësimdhënies si përgjegjësi personale. Ai i teston ato si gjithnjë duke pasur parasysh sillabusin, dhe duke sygjieruar ndryshimet gjithnjë me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe përvetsimin e lëndës.			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Në kuadër të ndërkombtarizimit UET fton lektorë të huaj apo vendas me qëllim pasurimin e procesit të mësimdhënies, si dhe ekspertë të fushave të ndryshme që ofrojnë eksperiencën e tyre sipas fushës së ekspertizës. Kjo synon një përvetësim më cilësor dhe gjithëpërfshirës të temës. Gjithashtu zhvillohen dhe seminare me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, shkëmbimit të eksperiencave etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Vlerësimi i ekspertëve

Institucioni ka një rregullore të posaçme mbi Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të cilat përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. Ai kalon në këto faza: Provimi i ndërmjetëm, seminare, detyra kursi e praktike, deri në provimin përfundimtar.

Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me germa nga F në A, sipas tabelës së mëposhtme. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe gjerat nga E në A janë kaluese.

Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë:

Provimi i ndërmjetëm **[formati A.IV.2.1];**

Provimi përfundimtar **[formati A.IV.2.2];**

Riprovimi **[formati A.IV.2.3];**

Përmirësimi **[formati A.IV.2.3];**

Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar **[formati A.IV.2.4].**

Si rregull teza e provimit përbëhet nga 3 kategori pyetjesh:

Pyetje që kontrollojnë njohuritë, 20 - 30% e tezës;


Pyetje që testojnë aftësitë analitike, 40 - 50% e tezës;

Pyetje që kërkojnë mendimin dhe qëndrimin individual të studentit (në formën e esesë argumentuese, raste të studimit/kazuse, ose ushtrime), 20 – 30 % e tezës.

Ato bëhen të ditura gjatë javës së orientimit për studentët dhe nga pedagogu përkatës i lëndës, ose nga koordinatori në Zyrën e Studentit. Gjithashtu studentët informohen në Guidën për studentë në platformën UET LMS


Kontrolloj notat dhe oraret në UET LMS?

Për të kontrolluar notat dhe oraret, klikoni mbi lidhjen "Studenti" në menunë kryesore dhe me pas zgjidhni "Notat Nga Sekretaris" ose "Orari".



Referenca për Standardin 3.5/ 1:

	7.1 Dokumenti A.IV. Sistemi i vleresimit te studenteve.pdf 46.3 UET_LMS_Guide per studentet.pdf
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me syllabusin, metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara. Gjithashtu ato njihen me afatet dhe pritshmëritë e lëndës.</p> <p>Programet e lëndëve (syllabuset) hartohen sipas formatit të miratuar, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimit dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit përkatës. Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion programet dhe materialet për çdo lëndë që ofrohet. Pedagogu i lëndës vendos në sistemin LMS, syllabusin së bashku me leksionet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar të lëndës. Përmes këtij sistemi studentët njoftohen për detyrat që pedagogu cakton, si edhe informohen për rezultatet e vlerësimit. Gjithashtu ata mund të komunikojnë me pedagogun e lëndës për çdo paqartësi apo pyetje.</p> <p>Syllabuset përshkruajnë: Temën specifike, Titullari, Ngarkesa, Viti akademik, Lloji i lëndës, Programi i Studimit, Adresa elektronike e pedagogut, dhe Kodi i Etikës.</p> <p>Përveç këtyre në vazhdim pasqyrohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmbledhja dhe qëllimi i lëndës - Konceptet themelore - Temat - Metodologjia pedagogjike - Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar <p><u>Referenca për Standardin 3.5/ 2:</u> 19.1. Format i Syllabusit.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Ai realizohet në formë të vazhdueshme me synim nxitjen e studentit, vlerësimin e tij më objektiv, si dhe vlerësuar vetë lëndën gjatë vitit. Format e vlerësimit janë vendosur në përshtatje me lëndën për një shfrytëzim maksimal të potencialit të studentëve.</p> <p>Ai kalon në këto faza: Provimi i ndërmjetëm, seminare, detyra kursi e praktike, deri në provimin përfundimtar.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.5/ 3:</u> 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.pdf</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Notë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																										
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Ai kalon në këto faza: Provimi i ndërmjetëm, seminare, detyra kursi e praktike, deri në provimin përfundimtar.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) si dhe shprehet me germa nga F në A, sipas tabelës së mëposhtme. Notat nga 5 (pesë) në 10 (dhjetë) dhe germat nga E në A janë kaluese.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Pikët</th> <th>Nota</th> <th>Germa</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>96 – 100</td><td>10</td><td>A</td></tr> <tr><td>91 – 95</td><td>10</td><td>A-</td></tr> <tr><td>86 – 90</td><td>9</td><td>B+</td></tr> <tr><td>81 – 85</td><td>9</td><td>B</td></tr> <tr><td>76 – 80</td><td>8</td><td>B-</td></tr> <tr><td>71 – 75</td><td>8</td><td>C+</td></tr> <tr><td>66 – 70</td><td>7</td><td>C</td></tr> <tr><td>61 – 65</td><td>7</td><td>C-</td></tr> <tr><td>56 – 60</td><td>6</td><td>D+</td></tr> <tr><td>51 – 55</td><td>6</td><td>D</td></tr> <tr><td>46 – 50</td><td>5</td><td>D-</td></tr> <tr><td>41 – 45</td><td>5</td><td>E</td></tr> <tr><td>1 – 40</td><td>4</td><td>F</td></tr> </tbody> </table> <p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme:</p> <p style="margin-left: 40px;">Provimit të ndërmjetëm (30%) Nivelit të diskutimit (10%) Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%) Provimit përfundimtar (40%).</p> <p>Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Provimet janë pa pagesë.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.6 / 1:</u> dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike. dok 7.1 Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studenteve.)</p>	Pikët	Nota	Germa	96 – 100	10	A	91 – 95	10	A-	86 – 90	9	B+	81 – 85	9	B	76 – 80	8	B-	71 – 75	8	C+	66 – 70	7	C	61 – 65	7	C-	56 – 60	6	D+	51 – 55	6	D	46 – 50	5	D-	41 – 45	5	E	1 – 40	4	F
Pikët	Nota	Germa																																									
96 – 100	10	A																																									
91 – 95	10	A-																																									
86 – 90	9	B+																																									
81 – 85	9	B																																									
76 – 80	8	B-																																									
71 – 75	8	C+																																									
66 – 70	7	C																																									
61 – 65	7	C-																																									
56 – 60	6	D+																																									
51 – 55	6	D																																									
46 – 50	5	D-																																									
41 – 45	5	E																																									
1 – 40	4	F																																									



<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UET përdor sistemin elektronik gjithnjë kur ka qenë e mundur dhe e përshtatshme për karakterin e lëndës. Ai duke bashkëpunuar me AADF Albanian-American Development Foundation po promovon një sistem të ri për vlerësimi Clean Scoring.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studenti fiton të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar të një lënde, kur ka shlyer detyrimet që lidhen me pjesëmarrjen në atë lëndë, të parashikuara në rregullore, si dhe detyrimet financiare sipas kontratës së lidhur me Universitetin. Studentët që fitojnë të drejtën e dhënies së provimit regjistrohen në listën emërore të provimit.</p> <p>Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore bën shënimin “Nuk u paraqit” në procesverbalin përfundimtar të lëndës.</p> <p>Për studentin që humbet të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar të një lënde për shkak të tejkalimit të numrit të mungesave, Sekretaria Mësimore bën shënimin “Nuk u kualifikua”.</p> <p>Vlerësimi me komision me dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Në bashkëpunim mes tyre vendoset në do ketë korrigjime apo vlerësime të përbashkëta apo ato do realizohen vetëm nga titullari. Një komision me tre anëtarë ngrihet nga departamenti në rast ankesash nga një student.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.6/ 3:</u> dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Testet finale realizohen në mënyrë anonime me sekretim. Ato monitorohen nga dy pedagogë. Përjashtim bëjnë rastet kur janë lëndë praktike, të tipologjisë I.</p> <p>Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin dhe në procesverbalin përmbledhës të vlerësimit të studentëve.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.6/ 4:</u> dok 7. 5.3 Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike,.. dok. 9 dokumenti për sekretarinë</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe</p>	<p>Vlerësimi final shoqërohet me komente për të plotësuar sqarimin e nevojshëm ndaj studentit. Ajo synon një qartësim sa më plotë të mangësive</p>

<p>lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>dhe keqkuptimeve mbi subjekte të caktuara. Kjo mund të shoqërohet dhe me seanca sqaruese specifike.</p> <p>Sezoni i riprovimeve në periudhën shtator-tetor zhvillohet në 3 runde. Riprovimet e raundit të parë janë pa pagesë, me përjashtim të rasteve kur studenti ka dy ose më shumë vlerësime jokaluase për lëndën. Riprovimet e raundit të dytë dhe të tretë janë me pagesë. Tarifa e riprovimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes studentit dhe UET.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.6 / 5:</u> dok 7. 5.3 Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike,...</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Gjatë provimeve ato ndiqen nga dy pedagogë bashkë me koordinimin që bën sekretimin. Konstatimi i kopjes vlerësohet me notën pakaluese, ndërsa telefonat celularë nuk lejohen.</p> <p>Sipas Rregullores se UET Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi</p> <p>33.1 Plagjiatura nënkupton paraqitjen pa citim të materialeve të shkruara, të marra në përmasa të konsiderueshme nga një autor tjetër si tekste personale, në formë të pandryshuar dhe/ose në formë të përshtatur. Plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare në disiplinën ose veprimtarinë formuese përkatëse, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese.</p> <p>33.2 Kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit për studentin që shkel rregullin, dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër) në lëndën në fjalë.</p> <p>33.3 Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti. Herën e tretë të përsëritjes së kopjimit ose të plagjiaturës studenti përjashtohet nga Universiteti dhe humbet çdo të drejtë financiare që mund t'i takojë në bazë të kontratës së lidhur me UET-in.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.6/ 6:</u> Dok 5. Rregullore e UET.pdf dok 7.1 Dokumenti A.IV. Sistemi i vleresimit te studenteve.)</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në</p>	<p>Provimet standarde duhet ta kenë rezultatin gati brenda 2 javës ndërsa ato të mbartur brenda një jave. Vlerësimi përfundimtar paraprihet nga</p>




<p>kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>vlerësimet e detyrave të kursit apo detyrimet e ngjashme. Sipas rregullores ato jepen në kohë sipas përcaktimeve përkatëse:</p> <p>Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin dhe në procesverbalin përmbledhës të vlerësimit të studentëve.</p> <p>Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.6/ 7:</u> dok 7. 5.3 Rregullore e programit të studimit MA Arte Skenike.)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti njihet me notën në kohë reale nga sistemi online. Pas kësaj atij i lind e drejta të konfrontohet në një seancë sqaruese të paracaktuar, dhe të rishikojë tezën për çdo aspekt që ka nevojë.</p> <p>Sipas Rregullores:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. - Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një Komision ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. <p><u>Referenca për Standardin 3.6/ 8:</u> dok 7. 5.8 Rregullore e programit të studimit MA Arte Skenike.)</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente</p>	<p>Departamenti ngre një komision vlerësimi që merr parasysh çdo kërkesë, ankimim. Ato shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit me ekspertë të fushës dhe pedagogun përkatës dhe më pas nëse studenti nuk është ende i kënaqur, materialet i kalojnë komisionit të posaçëm. Procedura e ndjekur</p>


për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	është transparente për palët e përfshira, dhe më pas dokumentohet dhe arkivohet.		
	Referenca për Standardin 3.6/ 9: dok 7. 5.8 Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7


Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit synon thellimin e njohurive, si dhe të zhvillojë aftësitë profesionale të studentit. Kjo ndërtohet si në plan teorik ashtu dhe në atë praktik artistik.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi I studimit thellon aftësitë e veçanta në fushën e arteve Skenike, më specifikisht në elementë të multimedias, dizanjit, modës dhe skenografisë, ndërthurura me elemente të teknologjisë bashkëkohore. Ato ndërthuren pashmangshmërisht me elementë të shkencave humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Është praktikë e zakonshme në arte Skenike kur mbaron lënda detyrat dhe njohuritë dhe praktikat e zhvilluara gjatë vitit të prezantohen para komisionit. Aty pas analizës vlerësohet dhe se çfarë mund të përmirësohet në vazhdim.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në përfundim të lëndës pedagogu vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. Pikat më të rëndësishme përcaktohen prej tij në varësi të zhvillimi të lëndës dhe I jepet më shumë hapësirë. Në rast nevojë zhvillohen dhe konsulta të veçanta.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Këto orë kanë për qëllim informimin dhe azhurnimin me të rejat më të fundit nga bota e artit

	<p>dhe shkencës. Përveç kësaj rol të rëndësishëm kanë dhe aktivitetet artistike që ata organizojnë.</p> <p>Pjesë e shkëmbimeve, si rezultat i marrëveshjeve janë edhe pedagogët tanë të cilët japin mësim në Universitetet e tjera. Kështu, Pedagogu Kristi Bello, ishte në Universitetin e Sibiut, në Rumani, ku dha mësim për disa ditë, për studentët e Arteve.^[1] Si rezultat i bashkëpunimit me universitete apo OJF, vendase dhe të huaj, anëtarët e Departamentit të Arteve të Aplikuara kanë marrë pjesë në projekte si ekspert, si trajner, vlerësues etj.</p> <p>Më 29 tetor 2019, Prof. Eno Koço, Pedagog në Universitetin e Leedsit në Britaninë e Madhe realizoi një Master klas me praninë e studentëve, pedagogëve dhe drejtues të UET në sallën Aula Magna. Të ftuarit në auditor në ciklin Bachelor dhe Master kanë qenë profesionist të fushave të ndryshme në fushën e arteve. Në mënyrë më specifike individët e ftuar kanë qenë: Pëllumb Kulla, Arben Skënderi, Eneida Tarifa, Mimoza Ahmeti, Edmond Budina, Herida Duro, etj. të cilët kanë dhënë përvojë të pasur artistike për studentët e arteve dhe kanë performuar së bashku me ta, në ambientet e Universitetit Evropian të Tiranës.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.7 / 5:</u> Dok 43.2 Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021. Dok 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Pjesa teorike dhe ajo praktike gërshetohen sidomos nga detyrat e kursit, dhe praktikat profesionale. Të gjitha këto kanë rëndësi për rritjen profesionale të studentit, dhe për këtë detyra e kursit ka 20 % të vlerësimit final, ndërsa praktikat bëhen në hapësira fizike të tregut të punës.</p> <p>Qëllimet e zhvillimit të praktikës janë:^[1]</p> <p>T'i japë mundësi studentit të shohë të zbatuara në praktikë njohuritë teorike që ka marrë në auditor. Për këtë qëllim është e nevojshme që institucioni ose pozicioni ku studentët kryejnë praktikën të jetë sa më afër dhe i lidhur me programin e tyre të studimit.^[1]</p> <p>Të shkathësojë studentin në mjedisin e punës dhe t'i ofrojë atij mundësi për t'u parapërgatitur për tregun e punës, si edhe për të krijuar kontakte që mund t'i ndihmojnë për punësimin e tyre të ardhshëm.</p> <p>Praktika profesionale për programet Master Profesional (me 60 kredite) ka 6 kredite; pra një detyrim prej 150 orë punë për studentin.</p>




	<p>Nga këto 8 orë zhvillohen në auditor (4 seanca nga 2 orë), 120 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 22 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj).</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.7/ 6:</u> 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Diskutimet dhe puna në grup nga studentët zënë një hapësirë të rëndësishme në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve, apo çështjeve të caktuara. Kështu në javën e 13 të secilës lëndë jepen detyra kursi të cilat duhet të zhvillohen në grup.</p> <p>Sipas Rregullores së UET neni 18:</p> <p>Në ciklin e dytë të studimeve të gjitha lëndët organizohen në grupe mësimore me jo më shumë se 2 grupe seminari. Mësimi zhvillohet në formë interaktive, duke integruar shpjegimin e pedagogut me diskutimet e studentëve.</p> <p>Grupet e seminarit organizohen me jo më shumë se 35 studentë për programet në fushat e shkencave sociale, humaniteteve, arteve dhe shkencave natyrore, dhe jo më shumë se 25 studentë për programet në fushat e inxhinierisë, teknologjisë dhe shkencave mjekësore e shëndetit; grupet e laboratorit/praktikave organizohen në varësi të fushës së studimit, përkatësisht me jo më shumë se 25 dhe jo më shumë se 20 studentë.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.7/ 87:</u> Dok 5. Rregullore e UET.pdf</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>UET synon shndërrimin në një <i>qendër ekspertize</i> në fushën e studimeve shoqërore, humane, juridike, ekonomike dhe teknologjisë së informacionit. Synim i mëtejshëm është kthimi i UET në një <i>qendër ekselence</i> që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal. Këto synime, UET përpiket t'i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.</p> <p>Idetë inovative, si dhe studime të avancuara kërkimore e shkencore mbështeten nga stafi i institucionit, ndërsa një dokumentacion i gjerë rregullator është i aksesueshëm nga të gjithë online.</p> <p>Idetë inovative, stimulohen dhe nga zëra financiarë gjeneruar nga pjesëmarrje në projekte dhe botime. UET do të ndërtojë dhe përmirësojë në vazhdimësi një infrastrukturë të kërkimit shkencor, për t'i dhënë frymëmarrjen e duhur punës studimore të stafit akademik si</p>




	<p>dhe bashkëpunimit me institucione analoge nëpërmjet fondeve të akorduara nga institucionet publike, private dhe organizma të tjerë, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.7/ 8:</u> dok. 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.)</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Idetë inovative, si dhe studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështeten nga stafi i institucionit, në rastin e studentëve. Kjo është pjesë e Strategjisë së Kërkimit shkencor.</p> <p>Departamenti i Arteve të Aplikuara një pjesë të konsiderueshme të financimeve dhe burimeve njerëzore që disponon e përdor në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve të zhvillimit me karakter kombëtar, rajonal apo europian, duke u kujdesur që të sigurojë një efikasitet maksimale në këtë drejtim. Një pjesë e rëndësishme e shpërblyerjes të pedagogëve të UET është e lidhur direkt me fondin për kërkimin shkencor që vihet në dispozicion në fillim të çdo viti akademik dhe që materializohet në bazë të rezultateve konkrete të matshme e të diferencuara në këtë drejtim.</p> <p>Roli strategjik i Departamentit të Arteve të Aplikuara është shumë planesh. Dhe e bazon funksionalitetin e tij mbi këtë piketë të rëndësishme:</p> <p>Promovimin e artit në shoqërinë shqiptare, duke u përpjekur ta zhvendosë çështjen e kreativitetit kryesisht tek gjenerata e re e artistëve krijues dhe interpreto sepse kreativiteti artistik mbetet një burim i pazëvendësueshëm ndryshimi, lirie dhe risie. Nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm pa vëmendje ndaj njëres prej kategorive më kreative të shoqërisë shqiptare: atë të gjeneratës së re të artistëve.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.7/ 9:</u> Dok. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 dhe 2021-2025.) Dok 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>UET është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, proceseve akademike dhe zhvillimit të stafit dhe kërkimit përmes mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. Një ndër këto programe është edhe Erasmus+, i cili u lejon lëvizshmërinë studentëve dhe stafit akademik, në Universitete të tjera jashtë vendit, për të shkëmbyer eksperiencat e tyre.</p> <p>Programet e shkëmbimit Erasmus +, mundësojnë rritjen e shkëmbimeve me qëllim mobilitetin e studentëve dhe përmirësimin e mësimdhënies.</p>





	<p>Aktualisht Departamenti i Arteve të Aplikuara është i përfshirë në projektet që vijnë:</p> <p><i>Polyphonia Project</i> është një projekt mjaft i rëndësishëm mbi vlerat dhe traditën polifonike në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit.</p> <p><i>Crosswarp Project</i> është një projekt mjaft i rëndësishëm mbi vlerat dhe traditën endjes, thurrjes dhe tezgjzgjahut në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.7:</u> dok 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve.)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Notë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Detyrimet përmbyllëse paraprijnë provimet finale, ose mbrojtjen e diplomës. Për diplomën është hartuar një dokument. Aty pasqyrohen të detajuara procedura nga aplikimi deri tek miratimi i diplomës, udhëheqja, afatet e dorëzimit dhe mbrojtja.</p> <p>Ai kalon në këto faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi dhe kontrolli i procesit të diplomave/disertacioneve 2. Zgjedhja dhe miratimi i temës për programet me karakter profesional, programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, dhe programeve Master Ekzekutiv: 3. Zgjedhja dhe miratimi i temës së disertacionit 4. Udhëheqja e punimit të diplomës/disertacionit 5. Seancat metodologjike 6. Punimi i diplomës për programet Master i Shkencave (MSH)/Master i Arteve dhe programet e integruara të ciklit të dytë 7. Çështje të Citimeve dhe Referencave 8. Formatimi i punimit të diplomës

	<p>9. Elementët e punimit: 10. Standardi i lidhjes dhe kopertinës së punimit 11. Afati i dorëzimit të punimit të diplomës/disertacionit 12. Koha e zhvillimit të mbrojtjeve të diplomave 13. Ngritja e Komisionit të Vlerësimit 14. Kriteret e vlerësimit. 15. Procedura e mbrojtjes 16. etj., deri tek arkivimi e ceremonia e diplomimit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8 /1:</u> dok 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Sipas dokumentit rregullator të Diplomave, Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, para aplikimit duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Çdo udhëheqës shkencor brenda muajit korrik ofron propozime konkrete [formati B.II.3.2] për tema disertacioni, në përputhje me projektin e kërkimit në të cilin është i përfshirë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tematika të mundshme disertacionesh, të cilat miratohen nga Grupi kërkimor dhe Departamenti përkatës.</p> <p>Tematikat e miratuara iu vihen në dispozicion personave të interesuar për të ndjekur studimet e ciklit të tretë, të cilët ftohen të hartojnë projektin kërkimor mbi këtë bazë [formati B.II.3.2.1]. Në çdo rast, nuk përjashtohet propozimi i temave jashtë tematikave të propozuara nga udhëheqësit shkencorë, brenda tematikës së projekteve kërkimore të miratuara. Tema e disertacionit dhe udhëheqësi shkencor për çdo kandidat të pranuar në programet e doktoratës, miratohen nga Drejtuesi i departamentit dhe grupi kërkimor përkatës i projektit ku doktoranti do të përfshihet.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8 /2:</u> dok 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti konsiderohet kalues i vitit të dytë kur ka shlyer të gjithë detyrimet akademike përveç mbrojtjes së diplomës. Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Sipas Rregullores së Studimit, detyrimet përmbyllëse kryhen nëpërmjet punimit të Diplomës.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8/ 3:</u> dok 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike.)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në</p>	<p>Zgjedhja e temës nga studentët bëhet në fillim të vitit të fundit akademik të programit të studimit.</p>

<p>përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Në fillim të muajit qershor organizohet mbledhja e Departamentit, i cili miraton/rishikon drejtimet kryesore të kërkimit shkencor, titullarët e drejtimeve kryesore të kërkimit, udhëheqësit shkencorë që do të përfshihen në secilin nga drejtimet, si edhe kriteret për pjesëmarrjen në kërkimin shkencor të anëtarëve të personelit akademik dhe studentëve ekselentë të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>Pedagogu Udhëheqës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të temës së diplomës, strukturën dhe metodologjinë e aspektit të punës. Takimet e tyre janë periodike, në funksion të mbarëvajtjes së punës.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8/ 4:</u> dok 10. Dokumenti B. II. 3. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas temës së studimit pedagogu udhëheqës orienton dhe asiston studentit për metodologjinë, përpunimin e të dhënave, punën në terren, planifikime, dhe nxjerrjen e rezultateve. Një pjesë e pyetësorëve mund të shpërndahen në institucion me ndihëm e stafit, por mund të zhvillohen dhe jashtë ambienteve të tij, gjithnjë të koordinuar nga pedagogu udhëheqës.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Seancat metodologjike janë orë në auditor, të cilat konsiderohen formalisht si orë seminaresh, që kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Në programet e doktoratës ato zhvillohen në mënyrë periodike, sipas një kalendari të miratuar nga autoriteti drejtues për kërkimin shkencor.</p> <p>Në seancat metodologjike pedagogu udhëheqës trajton çështje si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përcaktimin shkencor të objektit të studimit; ▪ Diskutimin e dobisë së punimit; ▪ Përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet; ▪ Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre; ▪ Trajtimin e aspekteve metodologjike; ▪ Ndërtimin e strukturës së punimit; ▪ Përcaktimin dhe shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi (me <i>Burime Parësore/Dokumente Burimore</i> do të kuptojmë të dhënat që dalin nga puna e drejtpërdrejtë në terren dhe që nuk janë publikuar më parë me <i>Burime Dytësorë/Literaturë</i> mund të kuptojmë të gjitha ato burime të cilat janë publikuar, shpërndarë dhe përdorur më parë dhe që nuk dalin nga puna e studentit në terren); ▪ Përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj); ▪ Punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave;

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimin e punimit të diplomës; ▪ Debatimin e përfundimeve të studimit, etj. <p>Miratimi nga ana e tij është akti final i punimit të diplomës.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8/ 6:</u> dok 10. B II 5.2 Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Ajo është një mesatare e vlerësimeve të komisionit, shënohet në procesverbal dhe publikohet në fund të seancës.</p> <p>Pasi marrin vlerësimin përfundimtar, çdo diplomant i jep publikisht dorën anëtarëve të Komisionit, udhëheqësit të temës dhe oponentit. Në rastin e kandidatëve të vlerësuar me notën 10, dhënia e dorës shoqërohet me ngritjen më këmbë, në shenjë respekti, të Komisionit të Vlerësimit të Diplomave dhe të gjithë të pranishmëve.</p> <p>Studenti i vlerësuar me notë kaluese, ka të drejtë të tërhiqet në rast se nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar, brenda 24 orëve nga mbrojtja e diplomës. Në procesverbal për të bëhet shënimi “I tërhequr”. Ai ka të drejtë të rihyjë në mbrojtje në sezonet e ardhshme kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8/ 7:</u> dok 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit. (po aty B.II.13.4 Procedura e mbrojtjes)</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo procedurë kryhet brenda 6 muajve, normalisht pasi studenti ka kryer të gjithë detyrimet përmbyllëse. Diploma shoqërohet nga certifikata e notave dhe suplementi në dy gjuhë, anglisht shqip. Para dorëzimit të saj, studenti mund të pajiset me një vërtetim shoqëruar me certifikatën e notave.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8/ 8:</u> dok 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit. (po aty B.II.15. Pajisja me diplomë)</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nëse ka nevojë studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Gjithashtu Sekretaria Mësimore harton dhe e pajis studentin me <i>Suplementin e Diplomës</i>, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Me mbylljen e ciklit të studimeve, i gjithë dokumentacioni regjistrohet dhe arkivohet për një periudhë pa afat. Vetë institucioni disponon të dhëna të sakta për çdo student dhe i përdor ato në varësi të kërkesave të institucioneve të interesuara.</p>

	<p>Sipas Rregullores:</p> <p>Arkivimi dhe Ruajtja e Punimeve të diplomës/disertacioneve kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procedurës së mbrojtjes, si më poshtë vijon:</p> <p>Punimet e diplomës së ciklit të dytë, me vlerësim 7 e lart, në versionin e printuar ruhen në Bibliotekën e Universitetit dhe të Departamentit përkatës. Versioni elektronik i tyre, së bashku me versionin e printuar dhe elektronik të punimeve të tjera, dorëzohen nga Koordinatorja e Departamentit përkatës në Zyrën e Protokollit dhe Arkivit.</p> <p>Punimet e disertacionit, në versionin e printuar ruhen në Bibliotekën e Universitetit dhe të Departamentit përkatës. Versioni elektronik i tyre dorëzohet nga Koordinatorja e Zyrës së koordinimit të Studimeve Doktorale në Zyrën e Protokollit dhe Arkivit.</p> <p><u>Referenca për Standardin 3.8/ 10:</u> dok 10. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe	UET ka hartuar proceduara të përcaktuara lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore. Sipas Rregullores së Burimeve Njerëzore, aty janë të përcaktuara: (i) Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; (ii) Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mësimore; (iii) Trajtimi i rasteve të ekselencës së personelit; si edhe (iv) Kriteret dhe procedurat e marrjes leje në UET.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

75

<p>atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>I gjithë informacioni përmblihet dhe ruhet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, me dosje individuale për të gjithë stafin.</p> <p>Nga vizita në institucion pranë sektorit të burimeve njerëzore, u shfletuan dhe u panë dosjet me zgjedhje rastësore, si për staff Akademik PAE dhe PAK. Dosja përmban elementët e domosdoshëm si: (i) Informacionin mbi arsimin, në të gjitha nivelet; (ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime; (iii) Informacionin shëndetësor; (iv) Dosja përmban edhe vlerësimin që i është bërë pedagogut nga studentët, etj.</p> <p><u>Reference për standardin IV.1 / 1:</u> Dokumenti 11. Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UET ka të ndërtuara edhe procedurat e rekrutimit bazuar edhe në statusin e tij dhe në kuadrin e përgjithshëm rregullues.</p> <p>Njoftimet publikohen në faqen zyrtare të universitetit si edhe në gazetën “Liberale” pjesë e UET Press. Përzgjedhja e stafit kalon në disa faza seleksionimi, duke filluar që me aplikimin me dosjen dhe më pas duke kaluar edhe në fazën e konkursit/intervistimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Për stafin akademik që kërkohet me profile të veçanta, secili departament harton edhe kriteret specifike në varësi të nevoja që ka programi i studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve janë të përcaktuara edhe në rregulloret e UET</p> <p><u>Referenca për Standardin IV.1:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 5. Rregullore e UET.pdf.pdf Dokumenti 11. Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore. Dokumenti 11.1 Shembull thirrje për staf akademik Dokumenti 25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik të programit MA_Arte Skenike (Aneks_Tabela 4) Dokumentat shtesë nga institucioni: Dok. 20. Thirrje për punësim personel akademik</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Krijimi i mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të stafit në mënyrë profesionale lidhet sa me infrastrukturën fizike dhe materiale, aq edhe me ofrimin e mundësive për pjesëmarrje në aktivitete kurikulave dhe ekstrakurikulare.</p> <p>Nga pikëpamja e infrastrukturës fizike, UET ka krijuar mundësinë për funksionim profesional. (Do të përshkruhet më në detaje në Standardin IV.3)</p> <p>Në kuadrin e krijimit të mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave në funksion të mësimdhënies, stafi akademik nxitet të marrë pjesë në aktivitete/workshope/seminare në drejtim të forcimit dhe diversifikimit të metodave të mësimdhënies. Po kështu stafi akademik inkurajohet të përfshihet edhe në projekte të ndryshme sipas specifikave të lëndëve dhe kualifikimeve të tij. Gjithashtu i gjithë stafi përfshihet në trajnime si për metodologjinë e mësimdhënies, ashtu edhe për zbatimin e programeve të reja të Teknologjisë së Informacionit, përfshirjen në projekte, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UET e ka të shprehur që në statusin e tij dhe në deklaratën e vizionit të tij, synimin për të qenë një universitet me staf cilësor, akademik e profesional. Në funksion të kësaj, UET është i angazhuar në zhvillimin profesional të burimeve të tij njerëzore, sidomos akademike. Janë disa aktivitete ku nxiten pedagogët të marrin pjesë. Të tilla mund të përmendim pjesëmarrjen në “Ditët e Studimeve Shqiptare”; pjesëmarrjen në projekte në kuadrin e Erasmus + ku bashkëpunohet edhe me universitet jashtë vendit; “Anuarët e Humaniteteve”, “Takimet Liberale të Dardhës”, “Shkolla Dimërore e Inovacionit”, “Forumi i Shëndetit Publik” dhe “Shkolla Pranverore e Lidershipit”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Sikurse është e saktësuar edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021-2025</p> <p><i>“12.2 Në këtë kuadër, në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit, do të ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë (profesional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndër marrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet do të jenë të ndarë në katër grupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike.”</i></p> <p>Në kuadrin e mësimdhënies online, të specifikuar sidomos në kushtet e pandemisë COVID-19 ka dalë si prioritet edhe trajnimi në përdorimin e formave interaktive online të mësimdhënies dhe njohja e të gjithë pedagogëve me sistemin LMS.</p>






	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, u njoh me platformat që përdor institucioni për të komunikuar në distancë me studentët. Për përdorimin sa më komod të këtyre platformave, janë zhvilluar trajnime nga zyra e TI.</p> <p>Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh nga Zyra e Burimeve Njerëzore me trajnimet e zhvilluara (i) mbi metodologjinë didaktike; dhe (ii) mbi metodologjinë e kërkimit shkencor.</p> <p><u>Referencë për standardin IV. 2 / 2- 3:</u> Dokumenti 2. Statuti I UET Dokumenti 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 Dokumenti 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 5. Rregullore e UET</p>
--	--

<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>UET kujdeset që si stafi akademik ashtu edhe ai mbështetës të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit. Ngarkesa e pedagoqeve është brenda normave të caktuara.</p> <p>Nga shikimi i tabelës 4 ku paraqitet ngarkesa akademike e stafit për programin e studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet, "Mjeshtri regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV dhe Produksion", rezulton se vetëm 10.7% e ngarkesës mësimore realizohet nga staf akademik me kontratë (PAK). Gjithë pjesa tjetër e programit të studimit realizohet nga staff akademik i brendshëm PAE. 89.3% e programit.</p> <p><u>Referenca për Standardin IV.2:</u> Dokumenti 2. Statuti I UET Dokumenti 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 Dokumenti 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 5. Rregullore e UET Dokumenti 11. Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore. Dokumenti 11.1 Shembull thirrje për staf akademik.pdf.pdf Dokumenti 25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik të programit MA_Arte Skenike (Aneks_Tabela 4). Dokumentat shtesë nga institucioni: Dok. 6.1 Udhëzimet_Portali i pedagogut_UET LMS.pdf.pdf Dok. 6.2 Trajnimi pedagoqeve në TEAMS Dok 12. Extract nga Relacioni_Monitorimi i Silabuseve_Sem II_2020-2021</p>
--	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UET është vendosur në tre godina të cilat kanë fakultetet e ndryshme të universitetit. Në godinën B është i vendosur Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Sipas “Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit”, Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m². Në këtë godinë, strehohen laboratorët si më poshtë vijon:</p> <p>Për Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, në një sipërfaqe rreth 500 m² strehohen laboratorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Laboratori i Arteve Skenike dhe Dizajnit – me një sipërfaqe rreth 250m² ▪ Laboratori i Arteve Skenike – me një sipërfaqe rreth 250m² <p>Gjithashtu edhe në godinën A ndodhet Salla Aula Magna me një sipërfaqe rreth 200 m², me një kapacitet akomodues prej 125 persona. Kjo sallë përdoret në funksion të programeve të Arteve Muzikore dhe Arteve Skenike. Ambienti është i pajisur me një post të konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video. Gjithashtu edhe holla i godinës A shërben për të hapur ekspozita të arteve Skenike duke prezantuar punimet e studenteve.</p> <p>Sikurse përshkruhet edhe në dokumentin “Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit”, sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510 m² dhe 1515 vende.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45 m² dhe secila me nga 35 karrige. - Salla 70 vendesh (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100 m² secila. - Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45m² secila. - Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 10 ambiente me nga 18 m². - Zyra për koordinatorë janë gjithsej 6 ambiente me nga 14m². Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45m² secila me kapacitet 35 vende. - Sallë interneti me sipërfaqe 165 m² me 80 kompjuter. - Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300 m², 150 vende leximi. Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150m². - Zyra informacioni për studentët janë 2.

	<p>- Korridore plus holle janë gjithsej 8 me 150 m2 secili. Mjedisi çlodhës për kafe/fastfood, etj., është në një sipërfaqe të vetme 500 m2. Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300 m2. Zyra për sekretarinë mësimore dhe regjistrarin janë 3 me sipërfaqe 140 m2.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Totali i sallave të leksioneve, seminareve dhe sallave të mëdha 70 vendesh është 33. Të gjitha sallat janë të pajisura me lidhjet e Internetit dhe me mundësinë për të pasur pajisje teknike/ PC projektorë dhe pajisjet e zërit në çdo sallë.</p> <p>Në të gjitha ambientet e universitetit ka sinjal internet wireless që mund të përdoret nga studentët si në salla mësimi ashtu edhe në objektet çlodhëse, korridore, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>UET ka 3 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti.</p> <p>Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë windows 10, MS TEAMS; paketa Microsoft Office 365 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace, Word, Navicat for my SQL; NetBeans; JetBrains; Apache Tom Cat; UCINET; CAD, etj. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVI u njoh me ambientet mjaft mirë të pajisura të UET, sallat dhe software që përdoren për realizimin e programeve të studimit. Kështu u panë laboratorët e VTech dhe laboratorët kompjuterikë si edhe softëare-et për realizimin e programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Në programin e studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet, "Mjeshtri regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV dhe Produksion", - praktika profesionale është një lëndë plotësuese në semestrin e dytë të vitit të dytë. Ajo i përgatit studentët për të njohur më mirë terrenin real dhe mundësitë e punësimit që ata</p>

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<p>do të kenë në përfundim të studimeve. Praktika ka 12 kredite, dhe i ndihmon studentët edhe në hartimin e punimit të diplomës.</p> <p>UET ka të ndërtuar programet 250+ dhe më pas 500+ dhe lidhjet me Bordin e Tregut të Punës. Ato ndihmojnë edhe në vendosjen e studenteve në praktika në përshtatje me profilin dhe fushat e tyre të interesit. PO ashtu në këtë drejtim shërben edhe panairi I tregut të punës që organizohet pothuajse çdo vit nga UET. (Nuk është organizuar në 2020- 2021 për arsye të pandemisë COVID-19).</p> <p>“Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale_DAA” jep edhe subjektet ekonomike, me të cilat ka lidhur marrëveshje UET. Janë 14 institucione me të cilat UET ka institucionalizuar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat mësimore dhe me gjerë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. BALFIN Shpk 2. E.H.W. sh.p.k. 3. ITD shpk 4. The Plaza Tirana sh.a. 5. Qendra Kulturore Tiranë 6. Gazeta Liberale 7. UET PRESS 8. Top Channel 9. RTSH 10. Frekuencë Studio 11. On Off Production 12. Agi Haxhimurati LLC 13. Createur Studio sh.p.k. 14. Greiss Petroviq PF (GRACE MODELS) <p><u>Referenca për Standardin IV.3:</u> Dokumenti 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit Dokumenti 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale_DAA. Dokumentat shtesë nga institucioni: Dok. 8.1 Informacion mbi platformat e mësimdhënies në UET Dok. 8.2 Softëare që përdorin studentët e programeve MA</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në Godinën C ndodhet Biblioteka e UET që i shërben të gjithë studentëve. Sipas dokumentit “Mbi funksionimin e Bibliotekës” të gjithë studentët e UET kanë të drejtë të përdorin bibliotekën si brenda institucionit, ashtu edhe të marrin tituj me vete. Sipas kësaj rregulloreje “<i>Materialet që shërbehen jashtë Bibliotekës u jepen anëtarëve të saj për një periudhë kohe jo më shumë se 1 javë.</i>”</p> <p>Po ashtu “<i>Shërbimi bibliotekar ofrohet në gjashtë ditë të javës (nga e hëna në të shtunë). Orari i shërbimit të Bibliotekës është 9:00-20:00 për ditët e hënë - e premte dhe 10:00 – 17:00 për ditën e shtunë.</i>”</p> <p><u>Referencë për standardin IV. 4 / 1:</u> Dokumenti 45. Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit Dokumenti 45.1. Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Dokumenti “Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit” përmban listën e librave dhe materialeve të tjera të cilat janë në funksion edhe të programit të studimit.</p> <p>Biblioteka përmban në vetvete rreth 4625 tituj të cilat janë fizikisht në bibliotekë të mundshme për t’u studiuar dhe marrë nga studentët e të gjitha programeve të studimit.</p> <p>Literatura e bibliotekës përfshin: (i) tekste mësimore bazë, sie dhe literaturë ndihmëse; (ii) libra në gjuhë të huaja; (iii) revista shkencore (në shqip dhe në gjuhë të huaja; (iv) botime të institucioneve të vendit, raporte vjetore, etj; (v) letërsi, botime promociionale dhe informacione të tjera.</p> <p><u>Referencë për standardin IV. 4 / 2:</u> Dokumenti 45. Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit Dokumenti 45.1. Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas tabelave përmbledhëse ne Raportet e RVB, UET ka këto ofrime për bibliotekë online:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sage&EBSCO 2. Questia 3. ASTM Compass 4. Elgar Publishing – Elgar Online Platform
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Ambienti i bibliotekës si edhe gjithë godinat e UET kanë akses të hapur online për student dhe stafin. Në sallën e bibliotekës ka kompjutera për akses online ku mund të studiohet nëpërmjet platformave online.</p> <p>Biblioteka është pjesë e rrjetit të vendeve të Evropës Jug-Lindore për rrjetin e bibliotekave COBISS.net</p>

	<p>Gjatë vizitës së GVJ në bibliotekë, u njoh edhe me tërësinë e librave/ albumeve/ atlaseve që përdoren nga studentët e departamentit të arteve për programet e tyre respektive të studimit. Gjithashtu, gjatë kohës së vizitës, GVJ në bibliotekë u njoh edhe me një tërësi titujsh të sjellë nga bashkëpunimi me një universitetet privat si donacion për UET.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas dokumentit “Mbi funksionimin e Bibliotekës” pasurimi i bibliotekës bëhet:</p> <p><i>“Personeli akademik, në përputhje me nevojat e tij akademike e shkencore, bën present kërkesat tek Drejtuesi i Departamentit përkatës, i cili dërgon kërkesën përmbledhëse tek Përgjegjësi i Bibliotekës. Për blerjen e librave nevojitet miratimi i Administratorit të “EEI” SHPK.</i></p> <p><i>Biblioteka është e detyruar të ndjekë rregullisht botimet e reja dhe pas një procesi përzgjedhës përcakton dhe i propozon Departamentit përkatës hyrjen e titujve të përzgjedhur. Drejtuesi i Departamentit vlerëson rekomandimin dhe miraton titujt e botimeve që duhet të hyjnë në Bibliotekë.</i></p> <p><i>Biblioteka ndërton marrëdhënie partneriteti me biblioteka të tjera brenda dhe jashtë vendit. Përgjegjësi i Bibliotekës ka përgjegjësinë e shqyrtimit dhe të përzgjedhjes së titujve të botimeve që disponojnë bibliotekat e tjera partnere dhe i rekomandon Departamentit përkatës titujt e përzgjedhur. Drejtuesi i Departamentit përkatës i shqyrton dhe merr vendimin përkatës.</i></p> <p><i>Biblioteka, në bashkëpunim me UET–Press-in për librat e përkthyer në shqip, është e detyruar të bëjë verifikimin e cilësisë së përkthimit të tyre përpara procesit të blerjes.</i></p> <p><i>Biblioteka vendos, ruan dhe zhvillon lidhje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me Biblioteka të universiteteve të tjera publike dhe jopublike brenda vendit, si edhe me Biblioteka të universiteteve të huaja.”</i></p> <p>Pasurimi i bibliotekës është bërë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Blerja e titujve në fillim të vitit; ▪ Blerja në Panairin Kombëtar të librit; ▪ Përkthimi dhe botimi nga UET Press I titujve që duhen si tekste mësimore/ monografi nga studiues shqiptarë, etj.; ▪ Blerja online në Amazon për botimet sipas kërkesave të departamenteve për proceset e tyre mësimore.
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të</p>	<p>Sipas dokumentit “Mbi funksionimin e Bibliotekës” të gjithë studentët e UET kanë të drejtë të përdorin bibliotekën.</p>

<p>procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>“Shërbimi bibliotekar ofrohet në gjashtë ditë të javës (nga e hëna në të shtunë). Orari i shërbimit të Bibliotekës është 9:00-20:00 për ditët e hënë - e premte dhe 10:00 – 17:00 për ditën e shtunë.”</p> <p><u>Referenca për Standardin IV.4:</u> Dokumenti 42. Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit Dokumenti 45. Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit Dokumenti 45.1. Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës Dokumenti 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë Dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MA Arte Skenike https://uet.edu.al/ncë/biblioteka/</p>
---	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Prej më tepër se 5 vitesh, UET ka ndërtuar sistemin e menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë informacionin që lidhet me disa nga proceset më të rëndësishme në UET.</p> <p>Sistemi, sipas “Manualit të Përdoruesit të Sistemit UMIS” ka module të veçanta të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Moduli i Kontratave, regjistrimi i studentëve në UMS ▪ Moduli i Koordinatorëve, ▪ Moduli i Orarit ▪ Moduli i Statistikave ▪ Moduli i Menaxhimit të lëndëve dhe programeve <p>Siç shikohet edhe nga modulet në përmbajtje, një nga fillestarët është ai i kontratave dhe regjistrimit të studentëve. Modulet e tjera, janë sërish në shërbim të studentëve dhe të aktiviteteve që ai ka deri në përfundim të programit mësimor.</p> <p>Edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion u demonstrua mjaft efektiv sistemi i brendshëm për menaxhimin dhe marrjen e informacionit si atij akademik ashtu edhe informacionit administrativ.</p> <p><u>Referencë për standardin IV. 5 / 1:</u> Dokumenti 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	




<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi UMIS ka të përfshirë edhe “Moduli i menaxhimit të lëndëve dhe programeve”. Në të janë të përfshirë programet e studimit, lëndët dhe info për provimet. Sipas manualit të përdoruesit të UMIS</p> <p>... “Moduli është i organizuar në 9 Departamente, të cilat janë organizuar sipas 3 Fakulteteve të UET, secili sipas 3 cikleve të studimit (Bachelor, Master dhe Doktoraturë). Cikli Master ka zgjatimin “-Ma” pas emrit të Fakultetit, ndërsa cikli Doktoraturë ka zgjatimin “-PhD”.</p> <p>Brenda çdo Departamenti gjenden:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lista e lëndëve (Courses) 2. Programet e studimit (Programmes) 3. Lëndët që ofrohen nëpër semestra (Classes) 4. Provimet për lëndët (Examinations)” 			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>UET ka në përdorim edhe platformën UET LMS (Learning Management System) Synimet e sistemeve të menaxhimit, si të UET LMS ashtu edhe të UMIS janë për të lehtësuar marrjen e informacionit dhe lehtësimin e përbashkët të komunikimit midis stafit akademik, administrative dhe studentëve në të gjitha hapat e veprimtarisë mësimore dhe realizimit të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi UETLMS ka të përfshirë edhe “Modulin e Statistikave” i cili realizon statistika për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) 2. Institucionin / UET 3. Administratorin e UET 			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Faqja Web e UET është e pasuruar me informacionet e nevojshme për studentët dhe të interesuarit për të eksploruar në këtë faqe. Informacioni në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në faqe jepen detaje për: Studio në UET, Staf i Akademik, Të Rejat, Kërkimi Shkencor, Projekte & Partnerë, Alumni, Rreth UET.</p> <p>Referenca për Standartin IV.5:</p> <p>Dokumenti 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS</p> <p>46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS</p> <p>Dokumentat shtesë nga institucioni:</p> <p>Dok. 6.1 Udhëzimet_Portali i pedagogut_UET LMS</p> <p>Dok. 6.2 Trajnimi pedagogëve në TEAMS</p> <p>Dok. 8.1 Informacion mbi platformat e mësimdhënies në UET</p> <p>Dok. 8.2 Softëare që përdorin studentët e programeve MA</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Administratori dhe Zyra e Financës së UET janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit buxhetor të institucionit.</p> <p>Raportet dhe planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve bëhet për të gjithë institucionin dhe nuk bëhet për programe të veçanta studimi.</p> <p>Gjatë diskutimit në institucion na u theksua se institucioni në periudhën tetor – nëntor bën planifikimin për buxhetin e vitit pasardhës. Më pas ky buxhet detajohet duke u bërë parashikimi edhe mbi baza mujore, për nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Institucioni nuk përgatit buxhet specifik për secilin program studimi, pasi kjo nuk është kost-efektiv realizimi i planeve të tilla të detajuara.</p> <p><u>Referencë për standardin IV. 6 / 1:</u> Dokument 2 Statuti i UET</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Planifikimi i shpenzimeve bëhet për të gjithë institucionin dhe ai përmban të gjithë zërat e nevojshme për mbarëvajtjen institucionale, për ecurinë e programeve të studimit. Shpenzimet administrative janë të përbashkëta për të gjitha programet e studimit. Në planifikim përfshihen të gjitha zërat, si shpenzimet ato për stafin akademik dhe administrativ, teknologjike, operationale, bibliotekat, akseset, software, etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm. Auditimi kryhet nga zyra të licensuara të auditimit. Në vite të ndryshme kanë qenë edhe zyra të ndryshme auditimi, p.sh. në vitin 2016-2017 auditimi është kryer nga “Deloitte Albania”. Për periudhën 2018-2020 auditimi është kryer nga kompani të tjera private.</p> <p>Sipas diskutimit edhe më Përgjegjësen e Zyrës së Financës në UET, audituesi analizon pasqyrat financiare dhe sjell një raport/letër për drejtuesit duke shpjeguar ecurinë financiare të institucionit.</p>

<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Raportet e auditimit japin detaje dhe transparencën financiare për institucionin në tërësi.</p>
--	--

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Nga të ardhurat e pasqyruara në anekset e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm/Tabelave përmbledhëse 18 rezulton shifra të ardhurash që sigurohen nga tre burime kryesore: Tarifatat për dhe gjatë studimit, Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione, etj., si edhe Aktivitetet tregtare (qiradhënie, provime, vërtetime). Nga raporti i pasqyruar në dokumentacionin e përcjellë për vitet 2017-2019 institucioni ka pasur rënie të të ardhurave në të tre zërat kryesorë dhe më shumë kjo vërehet tek të ardhurat e siguruar nga tarifatat e shkollimit nga studentët.</p> <p>Gjatë diskutimit dhe vizitës në institucion, GVJ u informua se kjo vjen kryesisht nga ulja e numrit të studentëve, i cili ka rënë gradualisht duke u shtuar edhe numri i institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë programe të ngjashme studimi.</p> <p>Por, sikurse e konfirmoi edhe Përgjegjësjja e Zyrës së Financës së UET në takim me GVJ, rënia e të ardhurave, nga ulja e numrit të studnetëve është kompensuar me zërat e tjerë të të ardhurave dhe me zvogëlimin e shpenzimeve.</p> <p><u>Referenca për Standartin IV.6:</u> Dokumenti 02. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MA Arte Skenike.pdf.pdf Dokumente shtesë të sjella nga institucioni: Dok. 14. Kosto për student viti 2020 Dok. 17.1 Vertetim Audituesi Dok. 17.2 Per miratimin e tarifave _pagesave te hershme per vitin akademik 2020-2021 ne UET Dok. 17.3 Tarifatat ne fasha te ndryshme per vitin 2021</p>
---	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni e bazon veprimtarinë e tij në “Rregullore e UET” e cilësuar si dokumenti themelor nga derivojnë edhe rregulloret specifike të programeve. Kapitulli III i kësaj rregulloreje është dedikuar pranimit të studenteve në programet e studimit. UET ka hartuar një dokument të veçantë “Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve” në programet e studimit në UET.</p> <p>Ky dokument përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Informimi dhe ndërgjegjësimi; ▪ Kriteret e pranimit; ▪ Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim (dhe ky dokumentacion është i ndarë për studentët në varësi të ciklit të studimit (bachelor, master, dr apo master ekzekutiv); ▪ Procedura e pranimit. <p>Dokumente të veçanta janë to “Mbi tutoriatin dhe Këshillimin Akademik”. Një tjetër dokument i vlefshëm për studentët është edhe dokumenti “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin”.</p> <p>Të gjitha këto dokumentacione janë të bazuar në rregulloren e brendshme të UET dhe Statutin e institucionit.</p> <p>UET i ka këto material edhe në “Guida UET” e cila përditësohet çdo vit akademik dhe jep informacione të përgjithshme për studentët. https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2020/09/broshura-2020-2021.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloret dhe dokumentacionin referues për studentët, pranimin e tyre, këshillimin, karrierën dhe deri në diplomimin e tyre, të gjitha këto politika të UET garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për studentet në programet e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në faqen online të UET ndodhen të publikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Informacionet e përgjithshme për UET https://uet.edu.al/new/rreth-uet/ (statute dhe rregulloret e përgjithshme) ▪ “Guida e UET” https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2020/09/broshura-2020-2021.pdf ▪ Mënyra e aplikimit https://uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/ ▪ Transferimi i studimeve https://uet.edu.al/new/transfero-studimet-ne-uet-submit-form/



	<p>▪ Bursat dhe aplikimi për financim https://bankacredins.com/financim-per-studentet-e-uet/</p> <p>Si edhe kriteret për programet e studimit. Specifikisht për https://uet.edu.al/new/master-i-arteve/</p> <p>Informacioni është publik dhe i lehtë për t'u kuptuar.</p> <p>Një mjet shumë i mirë për studentët pas regjistrimit/pranimit në programet e studimit në UET për komunikim është edhe (Learning Management System).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>UET harton kriteret të veçanta për studentët në varësi të programit të studimeve. Ndërsa për kriteret e përgjithshme ato janë të përcaktuar nga aktet nënligjore të ndërtuara nga Ministria e Arsimit. Studentët e programit të studimit Master i Arteve, kanë edhe disa kriteret specifike, që pranohen bazuar edhe në kriteret specifike të Departamentit. Në procesin e pranimit ato njihen edhe me natyrën praktike të studimit që ata kanë përzgjedhur.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>UET ka ndërtuar një plan marketingu si edhe ka hartuar politikat e prezantimit dhe promovimit të UET në publik.</p> <p>Sipas planit të promovimit, faqja zyrtare e UET-it, miratohet paraprakisht nga Drejtori për Komunikimin dhe Marrëdhëniet me Publikun dhe nga Zv. Rektori për Studentët.</p> <p><i>“Faqja zyrtare jep informacion edhe mbi fakultetet, kërkimin shkencor, botimet e UET-Press-it si dhe shërbime të tjera që ofrohen nga UET-i. Një pjesë të rëndësishme të faqes zyrtare e zë pasqyrimi me foto dhe me tekst i aktiviteteve të ndryshme që ndodhin në UET, si konferenca të ndryshme, seminare, leksione të hapura, takime me personalitete të rëndësishme vendase ose të huaja.</i></p> <p><i>Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi Guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit, si dhe mbi programet, silabuset e lëndëve, së bashku me CV të personelit akademik.</i></p> <p><i>Përmes faqes zyrtare studentët e UET-it mund të kryejnë një sondazh të shkurtër në lidhje me pikat e forta të UET-it.”</i></p> <p>Informacionet përditësohen në mënyrë periodike. Këto informacione janë kontakti i parë me studentët, dhe vijimësia lidhet me informacionin që jepet nga zyrat specifike dhe nga pedagogët në varësi të programeve të studimit.</p> <p>UET është i pranishëm edhe në rrjetet sociale, Facebook dhe Twitter me anën e të cilëve mund të komunikojë dhe promovojë universitetin dhe programet specifike të studimeve.</p> <p>UET organizon:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Takimet informuese me gjimnazistët në shumë qytete të mëdha të vendit; ▪ Workshope informuese me gjimnazistët nga pedagogë të UET; ▪ Material të shkruara, fletëpalosje/ broshura si edhe ne mediat vizive spote TV dhe prezencë të pedagogëve në emisione televizive. ▪ Java e parë e fillimit të viti shkollor është orientuese, me regjistrime, këshillime, etj. <p><u>Referenca për Standardin V.1</u> Rregullore e UET Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Politika e marketing-ut të programit të studimit Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online</p> <p>Dokumente shtesë të sjella nga institucioni: Dok. 5. 3. Evidencë për konkursin e pranimit të studentëve Dok. 13. Procesverbale të mbledhjeve të hapura me studentët</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Platformat UMIS dhe LMS si edhe faqja online e UET japin të gjitha kriteret e nevojshme dhe informacionin e duhur për studentet për procedurat e fillimit të studimeve në programin e studimit. Ato gjithashtu tregojnë edhe detyrimet për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><u>Referencë për standardin V. 2 / 1:</u> Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarise Mesimore</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të	UET, në zbatim të legjislacionit aktual në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse të ministrisë së Arsimit si edhe në përputhje me parimet e


<p>kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta. Dokumenti i miratuar në UET “Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve” qartëson të gjitha hapat dhe proceduar që i shërbejnë njohjes dhe transferimit të studimeve.</p> <p><i>“Njohja dhe vlerësimi kredencial bazohet në parimet, kriteret dhe instrumentet e Konventës së Lisbonës për Njohjen, duke pranuar parimin e diversitetit të programeve.”</i></p> <p>Dokumenti përshkruan:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Transferimi dhe njohja e krediteve; ▪ Parime bazë të njohjes dhe të vlerësimit; ▪ Transferimet brenda UET; ▪ Paraekuivalentimi për aplikantët jashtë UET; ▪ Regjistrimi paraprak; ▪ Komisioni i Njohjes i Departamentit – KNJ; ▪ Vlerësimi i programit të studimit/lëndëve; ▪ Regjistrimi përfundimtar; ▪ Transferimi dhe mobiliteti i studentëve në programet e Ciklit të Tretë. <p>Referencë për standardin V. 2 / 2: Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 9. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e Sekretarisë Mesimore Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimin të studentëve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve japin mënyrat e kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve, për secilin program studimi. Gjithashtu kriteret e vlerësimit të studentëve janë të vendosura edhe në Rregulloren mësimore të programit të studimit.</p> <p>Referencë për standardin V. 2 / 3: Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumentet e syllabus të lëndëve - Dokumenti 19 i detajuar për të gjitha lëndët</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Dokumenti “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” si edhe dokumenti “Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar” janë informacionet bazë që i shërbejnë studentit për të realizuar punimin e diplomës ose për të realizuar provimin përfundimtar. Në rregulloren e programit të studimit jepet edhe kredite, verifikimi I njohurive të fituara nga studentët si edhe diplomimi:</p> <p><i>8.1 Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe me origjinalitet i studentit; mund të ketë karakter teorik ose empirik. Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë.</i></p> <p><i>8.2 Zgjedhja e temës dhe puna për shkrimin e punimit të diplomës nis që në fillim të vitit të parë akademik.</i></p>

	<p>8.3 Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.</p> <p>8.4 Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë.</p> <p>8.5 Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p>8.6 Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p> <p>8.7 Kalendari akademik parashikon 4 (katër) sezone për mbrojtjen e diplomës, të cilat janë: (1) Java e 1-rë e tetorit (2) Java e 2-të e nëntorit (3) Java e 1-rë e marsit (4) Java e 3-të e korrikut.</p> <p>8.8 Studenti që merr notë jokalue në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezultojnë mbetës, studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome.</p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Java e orientimit është një praktikë e mirë e UET në çdo fillim viti shkollor. Gjatë kësaj jave, pedagogë nga departamente të ndryshme japin info për studentët në varësi të programeve të studimit ku ata janë të interesuar. Kjo bëhet si në javën e regjistrimit, ashtu edhe në javën e orientimit.</p> <p>Edhe guida e studimeve https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2020/09/broshura-2020-2021.pdf është një material i përditësuar çdo vit, i cili jep informacione të nevojshme për studentët.</p> <p><u>Referenca për Standardin V.2</u> Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit MA Arte Skenike 7.1 Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve 7.2 Formati i Tezës së Provimit Përfundimtar 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit 10.3 Kalendari akademik 2020-2021.pdf.pdf 19. Syllabus e lëndëve të programit të studimit 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="549 1469 711 1541">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="711 1469 943 1541">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="943 1469 1168 1541">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1168 1469 1388 1541">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="549 1541 711 1617"></td> <td data-bbox="711 1541 943 1617"></td> <td data-bbox="943 1541 1168 1617"></td> <td data-bbox="1168 1541 1388 1617" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Dokumenti “Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike” jep gjithë informacionin e nevojshëm për strukturën organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p>Ky informacion jepet për studentët edhe nga Zyra e kujdesit ndaj studentit dhe këshillimit në stafin akademik, përpara procesit të regjistrimit. Informacioni ndodhet edhe në kontratën e nënshkruar midis studentit dhe UET.</p> <p><u>Referencë për standardin V. 3. 1:</u> Dokumenti Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve japin informacion të plotë për studentin për mënyrën se si janë të specifikuar lëndët dhe modulet mësimore, dhe veprimtaritë formuese të tyre. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën javore, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve etj.</p> <p>Ky informacion jepet edhe në sistemim LMS.</p> <p><u>Reference për standardin V. 3 / 2:</u> 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun 46.3 UET_LMS_Guide për studentet 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Njohja me mundësitë e tregut të punës është një nga çështjet shumë të rëndësishme, të cilës UET i kushton vëmendje. Ngritja e Bordeve të tregut të punës për çdo fakultet dhe komunikimi me to është një lidhje shumë e frytshme për studentët për të njohur potencialet e tyre të punësimit. Info për tregun e punës jepen edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.</p> <p>Edhe koordinatori e departamentit, po ashtu u përcjell informacione mbi kërkesat nga tregu i punës, edhe nëpërmjet postimeve në sistemet LMS.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën mjaft pozitivisht për mundësitë që u ofron UET për punësim, si nëpërmjet panairove të punës, Bordeve të Punës, krijimit të kontakteve nëpërmjet bashkëpunimi me pedagogët e universitetit. Disa prej tyre kishin gjetur punët aktuale nëpërmjet këtyre kontakteve.</p> <p><u>Reference: për standardin V. 3 / 3</u> 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi i Tregut të Punës 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i</p>	






<p>përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Një pikë lidhëse shumë efektive midis studentëve dhe universitetit edhe nga pikëpamja organizative, është koordinatori e fakultetit. Edhe sistemi LMS është mjaft i përdorshëm për studentët për dhënien e informacionit lidhur me kalendarin akademik, procesin mësimor, aktivitetet ekstrakurrikulare, etj.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Që në fillim të procesit të regjistrimit, studentet e UET kanë kredencialet e tyre të email dhe mundësinë e aksesit në LMS për të marrë gjithë infon e nevojshme. Kjo platformë krijon mundësinë edhe të komunikimit me pedagogët në distancë. Kjo u pa shumë e vlefshme sidomos gjatë periudhës së pandemisë vitet 2020-2021.</p> <p>Përmes platformës UET-LMS realizohen disa funksione:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngarkimi i literaturës për çdo lëndë si p.sh. skedarë, dosje, weblinks material audio/video nga interneti, foto, etj. 2. Njoftimet e pedagogut për çdo lëndë dhe për çdo grup. 3. Pikët individuale nga pedagogu për çdo student dhe çdo vlerësim. 4. Kalendar për studentin dhe pedagogun. 5. Dërgimi i detyrave/eseve nga studentët. 6. Mundësi komunikimi të tipit forum/chat mes studentëve dhe pedagogëve. 7. Mundësi komunikimi me mesazhe. 8. Mundësi ndërtimi pyetësorësh, kuicesh, etj. 9. Shfaqja e orarit të personalizuar për pedagogët dhe studentët. 10. Lista e notave të studentit, e sinkronizuar nga sistemi UMIS. 11. Shfaqja e njoftimeve në nivel universiteti për të gjithë studentët dhe pedagogët. 12. Mundësinë e kufizimit të aksesit të materialeve në bazë të datës, klasës mësimore, studentit, etj. 13. Mundësinë e aksesimit të saj nga sisteme të ndryshme operimi si Eëindoës, Linux, MacOS, Android, IOS, etj. 14. Ambient dinamik dhe modern të punës në të. <p><u>Reference për standardin V. 3 / 5:</u> 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS 46.1 Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun 46.3 UET LMS Guide për studentet 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS</p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Dokumentacioni i plotë i studentit gjendet në dosje dhe kjo ruhet në Zyrën e regjistrimit të studentëve dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu edhe në bazë të akteve legjislative të miratuara nga Ministria e Arsimit, dokumentacioni mbi lëndët e ndjekura sipas semestrave, rezultatet e provimeve të marra, kreditet, përmirësimet, etj., ruhen në Sekretarinë Mësimore.</p>

	<p>Gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë Mësimore në UET u shikuan, me përzgjedhje, dosjet e studentëve, u vërejt korrespondenca me numrat e matrikullimit, referencat nga regjistrat themeltare, procesverbalet e provimeve, etj.</p> <p><u>Referenca për Standardin V.3</u> 7 Dokumenti. "Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike" 7.1 Dokumenti A.IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi i Tregut të Punës 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit 19. Syllabus e lëndëve të programit të studimit 46.5 Raport ecuria e mësimit online Diskutimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, 3 qershor 2021 Informacioni i marrë në Sekretarinë Mësimore të UET gjatë vizitës së GVJ në institucion, 3 qershor 2021</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>UET ka statistikat vjetore për studentët e programit të studimit. Statistikat gjenden në Sekretarinë Mësimore. Për programin e studimit, statistikat e përgjithshme gjenden edhe pranë koordinatorit të fakultetit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Sistemi UET-LMS ka të përfshirë edhe "Modulin e Statistikave" i cili realizon statistika për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) 2. Institucionin / UET 3. Administratorin e UET <p>Ky sistem ka statistika që prej vitit të parë kur është krijuar UET.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore, me anë të regjistrave të saj, ka statistikat e studentëve të reregjistruar në programet e studimit sipas viteve, rezultatet e provimeve, lëvizjet, largimet, cilësinë e studentëve në hyrje, etj.</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit, UMIS ka edhe mundësinë që nëpërmjet programit informatik të gjenerojë statistika të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit</p>	

<p>dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Këto të dhëna ruhen dhe janë të aksesueshëm vetëm nga personat e ngarkuar nga zyra e TI për këtë qëllim.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Departamenti ku zhvillohet programi i studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me 5 profilet e tij është departamenti i Arteve të Aplikuara. Në analizën e këtij departamenti zhvilluar në prill 2021, janë diskutuar komponentët që vijojnë:</p> <p>A. Burimet Njerëzore B. Programi akademik C. Ngarkesa për çdo pedagog D. Pjesëmarrja në projekte E. Objektiva 2021-2022</p> <p>Në analizën nuk merret në shqyrtim cilësia e studentëve në hyrje dhe dalje. Gjithashtu raporti nuk diskuton mbi cilësinë e punësimit të studentëve.</p> <p>Në pikën e fundit objektivat për 2021-2022 departamenti synon të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të organizojë dy tryeza diskutimi përkatësisht në tematikat që vijojnë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Studentët dhe tregu i punës, deri në 24 dhjetor 2021 ▪ Konkursi i ideve të projekteve, deri në Mars 2022. 2. Të zgjerojë rrjetin e partnerëve institucionalë dhe bashkëpunëtorëve të departamentit dhe fakultetit me organizata publike dhe ndërkombëtare. 3. Të krijojë mundësinë e praktikave dhe të vizitave studimore në organizata publike dhe ndërkombëtare për studentët e Menaxhimit, të nivelit Bachelor dhe Master. 4. Të realizojë 5 deri 7 leksione dhe takime me të ftuar, në përputhje me planin e aktiviteteve të klubeve studentore. <p>Në programin e studimit Master i Arteve Skenike kishte një numër të vogël studentësh dhe departamenti kishte informacion të plotë për ta dhe arritjet e tyre. Kjo edhe në sajë të natyrës më komunikuese të këtyre programeve të studimit, studentët ishin shumë të pranishëm në departament.</p> <p><u>Referenca për Standardin V.4</u> Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit _MA Arte Skenike Dokumenti 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS Dokumenti 38. Analiza e departamentit përgjegjës Diskutimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, 3 qershor 2021 Informacioni i marrë në Sekretarinë Mësimore të UET gjatë vizitës së GVJ në institucion, 3 qershor 2021 Informacione shtesë të sjella nga institucioni: Dok. 4. Cilësia në hyrje dhe dalje _MA Arte Skenike. Dok. 6.1 Udhëzimet _Portali i pedagogut _UET LMS Dok. 8.1 Informacion mbi platformat e mësimdhënies në UET</p>


	Dok. 8.2 Softëare që përdorin studentët e programeve MA Dok. 13. Procesverbale të mbledhjeve të hapura me studentët		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Sipas statutit të tij UET ka në përbërje të disa prej organeve të tij edhe pjesëmarrës nga Këshilli Studentor. Në kreun VII ku flitet për studentët, Neni 51 qartëson edhe Këshillin e Studentëve dhe pjesëmarrjen në qeverisjen e UET. Aty saktësohet se Këshilli i Studentëve është organ i cili zgjidhet çdo dy vjet me votat e studentëve dhe mbështeten nga legjislacioni në fuqi. Këshillat e Studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes në UET si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.</p> <p>UET mbështet këshillat e studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre.</p> <p>Studentët janë të përfaqësuar në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Këshillimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (një anëtar që zgjidhet nga Këshilli Studentor); 2. Këshillin e Etikës (një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli Studentor); 3. Senatin Akademik (Kryetari i Këshillit Studentor dhe 2 studentë anëtarë që zgjidhen me mandat 2 vjeçar). <p><u>Referencë për standardin V. 5/ 1:</u> Dokument 2. Statuti i UET Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse</p>	<p>Instrumentet për përfshirjen e studentëve në organizmat vendimmarrëse të UET ishin të ndryshme. Mendimi i të gjithë studentëve merrej në UET në mënyrë anonime nëpërmjet pyetësorëve online. Rezultatet e pyetësorëve për pedagogët u jepen atyre dhe shërbejnë si një pikë orientuese, dhe vendosen edhe në dosjen e pedagogeve. Anketimet e studenteve bëhen dy herë në vit, çdo semestër.</p>

<p>dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjithashtu studentët janë pjesëmarrës në mbledhjet e departamentit si edhe në fokus grupe për marrjen e informacionit nga studentët.</p> <p>Një nga studentët e Master i Arteve Skenike ka qenë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me grupin e studenteve në program, ata u shprehën pozitivisht për mundësitë që u ofron UET në diskutime dhe kontakte shumë të afërta me pedagogët dhe departamentin.</p> <p><u>Referencë për standardin V. 5 / 2:</u> Dokument 2. Statuti i UET Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Programet mësimore si edhe tërësia e lëndëve dhe syllabuseve përditësohen dhe përshtaten me nevojat e zhvillimit të programeve mësimore, duke u bazuar në legjislacionin aktual. Në ndërtimin dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore, programi është shpërndarë në ngarkesë të njëtrajtshme midis semestrave. Në programin e studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet "Mjeshtri regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV dhe Produksion", kreditet janë ndarë në mënyrë të barabartë nga 60 kredite në vit (30 çdo semestër).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni organizon fokus grupe, pyetësorëve online dhe mbledhje të hapura në departament për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në mbledhjet e hapura në departament që organizohen çdo fillim semestri.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Rregulloret e brendshme përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më specifikisht kjo është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit.</p> <p><u>Referenca për Standardin V.5</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 7. Rregulloret e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve Dokumenti 30.4 Urdher Administrativ Mbi perberjen e KSBC Diskutimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, 3 qershor 2021 Dokumente shtesë sjellë nga institucioni: Dok. 1.1 Formatit për Raportin e fokus grupeve Dok. 8.2 Softëare që përdorin studentët e programeve MA Dok. 13. Procesverbale të mbledhjeve të hapura me studentët</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>UET ka krijuar një traditë në organizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve në këto veprimtari.</p> <p>Sipas Dokumenti “Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese artistike të Departamentit të Arteve të Aplikuara”, në prag të vitit të ri akademik 2019 - 2020, UET organizoi UET ART FESTIVAL.</p> <p><i>“Studentët e arteve muzikore, skenike dhe pamore sollën punimet dhe interpretimet e tyre në një mbrëmje në kampusin e UET-së, universitet për të krenuar këtë traditë të re, siç edhe është krijuar tanimë UET Arts Festival, realizuar me anë të tri klubeve studentore siç janë UET BAND, UET TEATËR, KOLONIA E ARTIT. Sipas rektores së Universitetit Europian të Tiranës, Nevila Nika, UET është universiteti i parë privat, i cili ka themeluar një Departament të Arteve të Aplikuara.</i></p> <p><i>Kolonia UET Theatre është një nismë, e ndërmarrë nga Instituti Europian Pashko në bashkëpunim me Departamentin e Arteve të Aplikuara në UET që synon të krijojë një komunitet të artistëve dhe të sjellë vëmendjen tek arti. Ky organizim është tashmë një traditë, duke e kthyer atë në një hapësirë dhe ballafaqim të vlerave dhe principeve të artistëve të skenës për audiencën universitare dhe publikun në tërësi. Artistët të cilët kanë qenë pjesë e Kolonisë UET Theatre, vijnë nga një traditë e mjeshtrisë skenike dhe kinematografike duke për profilin e krijuar si edhe për modernitetin në sferën e arteve skenike. Edhe këtë vit ndonëse me një risi në formën e organizimit, promovimi i artit mbetet një nga qëllimet kryesore. Është mjaft e bukur ndjesia që përftohet në këto aktivitete. Gara e brendshme që karakterizon të gjithë ata maturantë që e kanë pasion artin është një garë jashtëzakonisht e bukur, pasi nuk është e vrazhdë si një konkurs por është një garë e butë që reflekton dëshirën e madhe në skenë dhe ekran.”</i></p> <p><u>Referencë për standardin V. 6 / 1:</u> Dokumenti 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese _artistike_Departamenti i Arteve të Aplikuara</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të</p>	<p>UET e ka në fokus lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Kështu, sipas dokumentit</p>

<p>lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>me listën e bashkëpunimeve, në rang universiteti janë lidhur marrëveshje me 96 institucione, me synim realizimin e projekteve të përbashkëta.</p> <p><u>Referencë për standardin V. 6 / 2:</u> Dokumenti 34.7 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET Dokumenti 35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Dokumenti 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese _artistike_ Departamenti i Arteve të Aplikuara</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në punime bashkë me pedagogët si edhe në përbërje të grupe të punës në realizimin e projekteve. Gjatë vizitës së GVJ në institucion dhe diskutimit me studentët, u mor informacion për planet e departamentit për përfshirjen e studentëve në aktivitetet që do të organizohen në kuadrin e projektit “Polifonia”.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Gjithashtu, disa nga spotet publicitare dhe spotet mediatike të eventeve të organizuara në UET ishin desenjuar dhe punuar nga vetë studentët. Gjatë gjysmës së dytë të vitit akademik 2019-2020 si edhe në vitin akademik 2020-2021 studentët e Master i Arteve Skenike, kanë ruajtur kontaktet dhe komunikimin me pedagogët duke punuar pranë studiove të profesorëve për të realizuar projektet dhe detyrat e kursit. Kjo i ka ndihmuar ata edhe në realizimin e programit mësimor, edhe për projektet e tyre më të gjera të lidhura me tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>UET publikon në revistën shkencore POLIS, e cila ka një bord ndërkombëtar, publikohet në anglisht. Gjatë periudhës aktuale, janë në proces disa punime të tjera për tu realizuar dhe botuar në numrin e ardhshëm të POLIS nga Përgjegjësi i Departamentit të Arteve të Aplikuara.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Punimi i diplomës që realizohen në vitin e dytë të studimeve Master kërkon një bashkëpunim shumë të ngushtë midis pedagogut dhe studentit. Sipas dokumenti “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” aty specifikohen elementët e ndryshëm për të ndjekur procedurën e hartimit të punimit dhe vlerësimit të tij përfundimtar.</p> <p><i>Zgjedhja dhe miratimi i temës për programet me karakter profesional, programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, dhe programeve Master Ekzekutiv:</i></p> <p><i>Në fillim të muajit tetor, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve.</i></p> <p><i>Çdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime</i></p>

konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentët, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash

Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga Departamenti përkatës me formularin e aplikimit për temën e diplomës

Miratimi i temave të studentëve dhe i pedagogëve udhëheqës bëhet jo më vonë se data 15 dhjetor, në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi

Për studentët e ciklit të dytë të studimeve

Tema dhe problematika: Punimi i diplomës duhet të jetë punë e pavarur dhe krijuese e studentit. Ky punim duhet të ketë një bazë të fortë teorike dhe të ketë patjetër një kapitull konceptual dhe teorik. Qëllimi i tij është të shfaqë aftësitë e studentëve për të mbledhur dhe për të vlerësuar informacionin, për të analizuar në mënyrë teorike faktet e mbledhura, si dhe për t'i paraqitur përfundimet e arritura në një format akademik. Kjo nënkupton edhe studime, të cilat synojnë "të përmirësojnë /plotësojnë teorinë" ose studime që bëjnë një reflektim mbi "gjendjen e debatit teorik".

Problematika e këtyre punimeve mund të jetë si empirike ashtu dhe teorike. Kjo nënkupton që studenti mund të niset si nga një problem teorik/konceptual dhe të përpiqet të japë kryesisht një kontribut teorik, ose mund të niset nga një problematikë në terren dhe të mundohet të vërtetojë një hipotezë teorike ose një model teorik për të shpjeguar këtë rast empirik;

b. Metodologjia: Punimi i diplomës duhet të ketë 19-20 mijë fjalë. Një punim me numër fjalësh jashtë këtij segmenti nuk duhet të pranohet nga udhëheqësi i temës [numri i fjalëve llogaritet duke përfshirë vetëm tekstin e punimit, pra kapitujt nga Hyrja te Konkluzioni]. Punimi i diplomës është një ese kërkimore e zgjeruar, ku studenti pritet të japë kontributin e tij teorik në fushën teorike përkatëse;

c. Burimet dhe puna në terren: Minimumi i burimeve dytësore për temat me karakter teorik është 30. Për temat me karakter empirik minimumi i burimeve dytësore është 20 dhe duhet të plotësohet me jo më pak se 20 burime parësore. Nëse ky minimum nuk të arrihet, atëherë studenti humbet automatikisht 20 pikët e vlerësimit të bibliografisë. Nëse studenti bën punë në terren, kjo shtrihet gjatë periudhës së shkrimit të tezës. Para daljes në terren, studenti duhet të paraqesë në seancën metodologjike më të afërt një plan të punës, i cili duhet të konsultohet me udhëheqësin e temës;

d. Aftësi të transferueshme të studentit:


i. Aftësi për thellimin e dijeve empirike;

ii. Specializim i mëtejshëm në disiplinën dhe në profilin përkatës;

	<p>iii. Avancimi i aplikimit të teorive dhe i koncepteve bazë në studime rasti (case studies) ose studime krahasuese; iv. Përfshirja në debate teorike/konceptuale; v. Aftësi për të kritikuar studime të fushës si empirike, ashtu dhe teorike; vi. Aftësi për të vazhduar studimet më tej në nivel doktrate. e. Në rastin e programeve në fusha të veçanta si arti, arkitektura, etj, punimi i diplomës është në formën e performancës artistike, dorëzimit të një projekti konkret, etj.</p> <p><u>Referenca për Standartin V.6</u> Dokumenti 10. B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit Dokumenti 33.1 Kalandari i aktiviteteve Dokumenti 34.7 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET Dokumenti 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Dokumenti 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese _artistike_ Departamenti i Arteve të Aplikuara Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit _MA Arte Skenike Dokumenti 19 Syllabuset e lëndëve Diskutimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, 3 qershor 2021 Dokumente shtesë të sjella nga institucioni: Dok. 7. Silabus - Seancat metodologjike 2020-2021 Dok. 15. Përshkrim i dy projekteve CROSSËARP - Polyphonia Dok. 16.1 Ekstrakt nga ëeb _Portofoli i projekteve UET Dok. 16.2 Aktivitetet në kuadër të projektit Polyphonia Dok. 16.3 Aktivitetet në kuadër të projektit CROSSËARP Dok. 21. Informacion i aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve specifike Dok. 24. Evidencë për temat e diplomës</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UET ka të nënshkuara 95 marrëveshje me institucione të arsimit të lartë në disa vende të ndryshme të botës. Marrëveshjet e bashkëpunimit synojnë shkëmbimin e eksperiencave akademike, rritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore, si edhe mobilitetit e studentëve dhe të pedagogëve.</p> <p><u>Referencë për standardin V. 7 / 1:</u> Dokumenti 34.7 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET Dokumenti 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</p>

<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve "Arte Skenike" me profilet, "Mjeshtri regjie", "Mjeshtri aktrimi", "Koreografi", "Skenografi", "TV dhe Produksion", ka pjesë të kurikulës edhe "Metodat e kërkimit sasior", "Praktikum i shkrimit krijues" si edhe lëndë të tjera që e ndihmojnë për të ecur në rrugën e kërkimit shkencor edhe më tej në studime.</p> <p>Referencë për standardin V. 7 / 2: Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>UET ofron bashkëpunim midis kërkuesve të rinj dhe atyre të afirmuar edhe në projekte kërkimor me parë. Në projektet e zhvilluara ofrohen edhe studentët e doktoraturës në programet e tjera të studimit për të bashkëpunuar në këto kërkime.</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Studiuesit dhe kërkuesit shkencor të huaj, janë përfshirë në projektet e UET sidomos në fushat e studimeve sociologjike dhe humanitare, por edhe ekonomike. Pjesëmarrja e tyre është në rolin e folësve kryesore në konferenca apo edhe e referuesve për tematika të ndryshme. Aktivitetet ku ata kanë marrë më tepër pjesë janë në "Ditët e studimeve shqiptare". Anëtarë të komitetit shkencor janë edhe profesorët e huaj si: Prof. Franz Kok – Austria; Prof. Paul Nixon –Netherlands; Prof. Stefano Bianchini- Italy; Prof. Silke Landgrebe – Germany; Prof. Mirjeta Beqiri – USA; Prof. Viktoria Enzenhofer- Germany; Prof. Kornélia Lazányi –Hungary.</p> <p>Në aktivitetin e datës 4 dhjetor 2020 si folës kryesore ishin edhe profesorë të huaj :</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Anna M. Krolikoëska "European values" in different interpretative contexts ▪ Prof. Asoc. Dr. Konstantinos Giakoumis: "EU-Integration Democratization and Minority Cultural Heritage Protection; Post-Modernist Museology Perspectives from Albania" ▪ Alexey Fominykh, Eldar Kurbanov, Oleg Vorobiev "The REBUS project at Volga Tech: On the way towards student-centered learning" ▪ Jelena Šaković Jovanović, Filip Pižurica, Zdravko Krivokapic, Aleksandar Vujovic "Improvement of Entrepreneurial Competences within the context of Mechanical Engineers Education in Montenegro" ▪ Bojan Jovanovski, Rupert Beinhauer, Elizabeta Valentic, Doris Kiendl "The role of EU funded projects in the development of efficient entrepreneurial education approaches – The case of FH Joanneum"




	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Andrzej Lis, Prof. Asoc. Dr. Kreshnik Bello, Joanna Górka “Albania as an object and a context of research in Economic Sciences: Mapping knowledge development” ▪ Dr. Gyarmati Gábor “Environmental protection compared to Albania and Hungary” ▪ László Borbás “Comparing the position and competitiveness of SMEs in Albania, Kosovo and Hungary”
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Dokumenti “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve” jep informacione për mobilitetin e studenteve.</p> <p><i>“UET është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, proceseve akademike dhe zhvillimit të stafit dhe kërkimit përmes mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. Një ndër këto programe është edhe Erasmus+, I cili u lejon lëvizshmërinë studentëve dhe stafit akademik, në Universitete të tjera jashtë vendit, për të shkëmbyer eksperiencat e tyre.”</i></p> <p><i>Aktualisht Departamenti i Arteve të Aplikuara është i përfshirë në projektet që vijnë:</i></p> <p><i>Polyphonia Project është një projekt mjaft i rëndësishëm mbi vlerat dhe traditën polifonike në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit.</i></p> <p><i>Crosswarp Project është një projekt mjaft i rëndësishëm mbi vlerat dhe traditën endjes, thurrjes dhe tezgjzgjahut në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë një pjesë e pedagogëve të departamentit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Dokumenti “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve” jep informacione për bashkëpunimet e departamentit me institucionet e huaja dhe pedagogët e huaj. Kështu si rezultat i bashkëpunimit me universitete apo OJF, vendase dhe të huaj, anëtarët e Departamentit të Arteve të Aplikuara kanë marrë pjesë në projekte si ekspert, si trajner, vlerësues etj.</p> <p>Më 29 tetor 2019, Prof. Eno Koço, Pedagog në Universitetin e Leedsit në Britaninë e Madhe realizoi një Master klas me praninë e studentëve, pedagogëve dhe drejtues të UET në sallën Aula Magna.</p> <p><u>Referenca për Standartin V.7</u> Dokumenti 3. Plani strategjik 2015-2020 Dokumenti 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 Dokumenti 34.7 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET Dokumenti 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Dokumenti 43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit dhe studentëve</p>





	Dokumenti 43. Aktivitetet dhe veprimtaritë krijuese _artistike_ Departamenti i Arteve të Aplikuara Dokumenti 56. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH) Dokumente shtesë të sjella nga institucioni: Dok. 15. Përshkrim i dy projekteve CROSSWARP - Polyphonia Dok. 16.1 Ekstract nga web_Portofoli i projekteve UET Dok. 16.2 Aktivitetet në kuadër të projektit Polyphonia Dok. 16.3 Aktivitetet në kuadër të projektit CROSSWARP Dok. 21. Informacion i aktiviteve në kuadër të marrëveshjeve specifike		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UET ka krijuar Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Sipas dokumentit mbi funksionim e kësaj zyre "...Zyra e Kujdesit ndaj Studentit (ZKS) shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e kampusit, mësojnë studentët në lidhje me politikatat e Universitetit, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore, menaxhojnë hapësirën ku qëndrojnë studentët e qeverisë."
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Gjithashtu referuar dokumentit "Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik" në UET "... Çdo anëtar i personelit të brendshëm akademik ka në ngarkim një grup studentësh dhe qëndron 1 (një) orë në javë në një zyrë/sallë të caktuar, në funksion të këtij shërbimi, gjatë një orari pa ngarkesë mësimore ose administrative. Është e këshillueshme që studenti të ruajë kontaktet me të njëjtin pedagog përgjatë gjithë ciklit të studimeve."
	Referencë për standardin V. 8 / 1: Dokumenti 12. E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit Dokumenti 27.2 A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Zyra e Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit.



<p>informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e karrierës organizohet me persona, të cilët kanë orare të shpallura të pritjes së studentëve. Në të njëjtën kohë kontaktet e personave që këshillojnë janë publikë. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht (email – list).</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës ndër të tjera ofron edhe</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Këshillim të vazhdueshëm për studentët, duke i mbështetur në hartimin e CV, Letrës së motivimit & Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave; letrës së falënderimit, letrës së refuzimit të pozicionit, (trajtime online dhe off-line); ▪ Këshillim të studentëve për faza të intervistës së punës; ▪ Përgatit kalendarin e eventeve të lidhura me industrinë – Open Day për çdo fakultet dhe panaiet e punës; ▪ Zhvillon sondazhin e planit të karrierës së studentëve. – raporti të ndihmon të kuptosh punësimin - burimin, intershipet – burimin dhe planet e karrierës së studentëve, <p>Referenca për Standardin V.8 Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 12. E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit Dokumenti 27.2 A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik Dokumenti 29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve (Aneks_Tabela 23) Dokumenti 30.4 Urdher Administrativ Mbi perberjen e KSBC</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X






VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UET ka ndërtuar një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë bazuar në aktet rregullatore të aprovuara si “Statuti i UET”, “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, “Plani veprimit KSBC”, “Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë”, “Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022”, “Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC”, “Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC”.</p> <p>E gjithë kjo bazë rregullatore mbështetet në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në ILA, në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>UET i kushton vëmendje zbatimit të bazës ligjore rregullatore për cilësinë në universitet.</p> <p><u>Referencë për standardin VI. 1 / 1:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Dokumenti 30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në zbatim të legjislacionit dhe bazës rregullatore të ndërtuar nga vetë UET, Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it; ▪ Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit; ▪ Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është rinovuar përbërja e tij me urdhër nr. 14 të 19 nëntor 2020 nga Rektori i UET. Komision përbëhet nga 11 anëtarë dhe ka përfaqësues nga të gjitha fakultetet/departamentet e UET. Në përbërje të tij është edhe një studente si edhe ekspert të jashtëm.</p>



	<p>Referencë për standardin VI.1 / 2:</p> <p>Dokumenti 2. Statuti i UET</p> <p>Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC</p> <p>Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</p> <p>Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC</p> <p>Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet në saj të bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL.</p> <p>UET është akredituar institucionalisht për një afat 5 vjeçar sipas vendimit të Bordit të Akreditimit të ASCAL nr. 12 datë 07.04.2012.</p> <p>“Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Për Akreditimin e UET.”</p> <p>Përveç akreditimit institucional, UET ka akredituar në vijimësi edhe programet e studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>UET ka të hartuar Strategjinë për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, 2017-2022. Materiali është në anglisht, ndërtuar sipas formatit të një projekti që ka zbatuar UET në lidhje me sigurimin e cilësisë. Megjithëse është material lirisht i përdorshëm edhe në gjuhën angleze, UET nevojitet ta përkthejë/përshtatë atë në shqip në mënyrë që të jetë një dokument konsultues për të gjitha strukturat e UET.</p> <p>Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjikë; ▪ Organizimin dhe menaxhimin e UET; ▪ Organizimin dhe veprimin e Komisionit të sigurimit të cilësisë. <p>Gjithashtu dokumenti përmban edhe planin e veprimit për 2017-2018 të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Materiali përmban edhe kërkesat dhe formatin e CV që duhet të plotësojnë anëtarët e Komitetit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të kryetarit të saj.</p> <p><u>Referenca për Standardin VI.1</u></p> <p>Dokumenti 2. Statuti i UET</p> <p>Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike</p> <p>Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC</p> <p>Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</p> <p>Dokumenti 30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022</p> <p>Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC</p> <p>Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC</p> <p>Dokumenti 54.4 Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Për Akreditimin e UET</p> <p>Dokumenti 54.5 Certificate Akreditimi UET, 07.04.2017</p> <p>Dokumente shtesë të përcjella nga institucioni:</p> <p>Dok. 9.2 Plani i Veprimit KSBC 2019-2020</p> <p>Dok. 10. Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë_2017-2022</p>

	Dok. 11. Komunikim për ndryshime ne kurikulën e programit MA Arte Skenike			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>UET ka ndërtuar Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSCB. Ky komision harton planin e punës për secilin vit akademik për të gjitha programet e studimit.</p> <p>Në përbërje të grupit të KSCB është edhe një asistent pedagoge nga Fakulteti i Shkencave Humane Edukimit dhe Arteve.</p> <p>Plani i punës për vitet 2018-19 dhe 2019-2020 u përcoll nga dokumentet plotësuese të kërkuara nga institucioni gjatë vizitës së GVJ në UET.</p> <p>Për të garantuar cilësinë, një rol të rëndësishëm luajnë edhe departamentet ku janë mbështetur dhe zhvillohen programet e studimit.</p> <p><u>Referencë për standardin VI. 2/ 1:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC</p>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	<p>Sipas dokumentit “Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC” institucioni studion dhe analizon syllabuset e lëndëve si edhe rezultate dhe testet e provimeve. Për provimet dhe vlerësimin e tyre, sondimi bëhet me kampion. Nëse janë deri në 50 provime shqyrtohen 20 prej tyre, nëse janë 51-100 provime, shqyrtohen 30 prej tyre dhe mbi 100 provime, shqyrtohen 50 prej tyre.</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	<p>KSCB ka hartuar metodologjinë për kontrollin e provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare.</p>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve	<p>Po ashtu, KSCB ka hartuar edhe metodologjinë për vlerësimin e syllabuseve për programet e studimit.</p>


<p>përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Informacionet/vlerësimet e përmbledhura përcillen si në nivel Rektorati edhe në nivel Departamenti ku zhvillohet programi i studimit. Komisioni KSCB jep edhe rekomandime në rast kur gjen problematika. Metodologjia e vlerësimit për programet e studimit është në rang universiteti, pra e njëtrajtësuar për të gjithë institucionin. Nga cikli i parë në ciklin e dytë, apo nga një program në tjetrin, ndryshojnë objektivat e programeve apo shkallët krahasuese, por metodologjia dhe instrumentet e përdorura janë të njëjta.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga diskutimi me KSBC dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës për Studentin, gjatë vizitës së GVJ në institucion u sollën edhe shembuj se si kanë ndikuar fokus grupet me studentët për të ndryshuar dhe përmirësuar elementë të procesit mësimor. Rasti i treguar lidhej me organizmin administrativ përpara sezonit të provimit dhe përfshirjes së <i>javës break</i> midis dy semestrave, pas provimit, apo me zhvendosje të lëndeve nga një semstër në tjetrin duke ruajtur lëndët e të njëjtës tipologji.</p> <p>Dokumentet e përcjellë përfshijnë edhe komunikimin me email midis zyrave për transmetimin e informacionit të mbledhur nga komisioni i sigurimit të cilësisë KSBC drejt rektoratit.</p> <p><u>Referenca për Standartin VI.2</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Dokumenti 30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 Dokumenti 30.4 Urdher Administrativ Mbi përbërjen e KSBC Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC Dokumenti 30.7 Shperndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset Dokumenti 37. Format i relacionit per monitorimin e silabuseve Dokumenti 54.4 Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Per Akreditimin e UET Dokumenti 54.5 Certificate Akreditimi UET, 07.04.2017</p> <p>Dokumente shtesë të përcjella nga institucioni: Dok. 9.2 Plani i Veprimit KSBC 2019-2020 Dok. 10. Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022 Dok. 11. Komunikim per ndryshime ne kurrikulen e programit MA Arte Skenike Dok. 12. Extract nga Relacioni_Monitorimi i Silabuseve_Sem II_2020-2021 Dok. 22. Monitorimi në audior nga Përgj. Depart.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Vlerësimi</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi VI.3
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Sikurse specifikohet edhe në RVB, vlerësimi i bërë nga KSBC bëhet në nivel institucioni dhe nuk detajohet vetëm për një program specifik studimi. Për pedagogët e rinj, apo edhe në rast se ka problematika me studentët që janë evidentuar, përgjegjësi i departamentit ku zhvillohet programi i studimit, mund të hyjë edhe të asistojë/vëzhgojë një orë mësimi së bashku me një koleg të fushës përkatëse të studimit. Në përfundim të vëzhgimit, pedagogut i jepet një format vlerësues ku evidentohen anët pozitive si edhe çështjet të cilat kanë nevojë të adresohen në vijimësi nga pedagogu.</p> <p>Ndërsa produkti final i KSCB është më i gjerë dhe përmban info për të gjithë departamentet dhe programet e studimit. Ndërkohë, ky informacion i kalon edhe departamenteve, të cilët nga ana e tyre mund ta thelloje analizën duke grupuar informacionet sipas programeve të studimit.</p> <p>Vlerësimet janë në nivel institucional dhe si të tilla janë pjesë e procesit të vetëvlerësimit në kuadër institucional.</p> <p><u>Referencë për standardin VI.3 / 1:</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC Dokumenti 30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ Mbi përbërjen e KSBC Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC Dokumenti 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi syllabuset</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Disa nga elementët që vlerësohen, bazuar edhe në “Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC” janë syllabuset, literatura e lëndëve, provimet.</p> <p>KSCB përdor sondazhet për testimin e provimeve. Kështu kampioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nëse janë deri në 50 provime shqyrtohen 20 prej tyre; ▪ Nëse janë 51-100 provime, shqyrtohen 30 prej tyre; ▪ Nëse janë mbi 100 provime, shqyrtohen 50 prej tyre. <p>Ndërsa syllabuset e lëndëve shqyrtohen të gjitha në fillim të vitit akademik/semestrit.</p> <p>Marrja e mendimit të studentëve realizohet nëpërmjet pyetësorëve online, çdo semestër, fokus grupet, apo mbledhjet e hapura të departamenteve.</p>

	<p>Referencë: për standardin VI. 3 / 2: Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC Dokumenti 30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi syllabuset</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Si garantues i cilësisë është edhe përgjegjesi i departamentit për secilin nga pedagogët e lëndëve. Në “formular për vlerësimin e pedagogut nga eprori-kolegu” jepen disa kritere që vlerësohen sipas renditjes nga shumë mirë, mirë, pjesërisht dhe dobët. Kështu vlerësohet organizimi dhe qartësia, si edhe komunikimi me studentët:</p> <p>Element përbërës për organizimin dhe qartësinë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Përcakton qëllimin e orës së mësimit ii. Është i organizuar dhe i qartë iii. E paraqet materialin në përshtatje me nivelin e klasës iv. Shpjegon ide të rëndësishme thjesht dhe qartë v. Jep shembuj konkretë vi. Përmbledh çështjet kryesore të leksionit / seminarit <p>Ndërsa për komunikimin me studentët janë këta elemente:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Komunikon qartë dhe dëgjohe mirë ii. Demonstron entuziazëm për subjektin që shpjegon iii. Përdor siç duhet mjete ndihmëse audio-vizuale iv. Inkurajon pjesëmarrjen e studentëve v. Shpjegon materialin në më shumë se një mënyrë vi. U përgjigjet siç duhet pyetjeve dhe komenteve të studentëve vii. Reagon ndaj (pa)vëmendjes së studentëve viii. Përdor humor në masën dhe mënyrën e duhur ix. Demonstron njohje të mirë të subjektit x. I referohet studimeve të rëndësishme xi. Njohuritë që zotëron i përdor me efikasitet në orën e mësimit xii. Inkurajon mendimin/analizën kritike <p>Si instrumente për matjen e cilësisë në UET:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Testet e standardizuara; • Dëgjime në auditor; • Vlerësime me pikë; • Vlerësimi I detyrave të kryera nga studentët; • Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave. <p>Gjatë vitit akademik 2020-2021, për arsye të mësimit në distance, shumë nga monitorimet janë zhvilluar online me asistencën e departament të TI dhe platformave të UET-LMS. Ndërkohë që përgjegjësit e departamentit kanë monitoruar cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Institucioni ka ndërtuar edhe rregulloret tranzitore për vijimin e procesit mësimor online, duke detajuar informacionin e duhur që kërkohet për të ruajtur standardet e cilësisë. (“Vendim_Mbi zhvillimin e procesit</p>

	<p>akademik ne situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e formave te diplomave”; “Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19” “Dokumentimi 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021.”)</p> <p><u>Referencë për standardin VI. 3/ 3::</u> Dokumenti 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>UET vlerëson veprimtarinë akademikë nga pikëpamja cilësore edhe përmes sondazheve me studentët për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Marrja e vlerësimeve nga studentët realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazheve me studentët e programit të studimit; • Sondazheve të vlerësimit të didaktikës dhe kurikulës; • Pyetje konceptuale; • Intervista <p>Rezultatet përdoren nga drejtuesit e departamenteve/ fakulteteve/ si edhe institucionit për të reflektuar në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu.</p> <p><u>Referenca për Standardin VI.3</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 5.1. Vendim_Mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe Mbi lëshimin e formave te diplomave Dokumenti 5.2. Rregullore tranzitore_Mbi vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021 në kushtet e pademisë COVID-19 Dokumenti 5.3 Rregullore tranzitore_Per zhvillimin e procesit akademik gjate Vitit Akademik 2020-2021. Dokumenti 7. Rregullore e programit të studimit_MA Arte Skenike Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Dokumenti 30.3 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 Dokumenti 30.4 Urdher Administrativ Mbi përbërjen e KSBC Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC Dokumenti 30.7 Shpërndarja e relacionit te KSBC mbi silabuset Dokumenti 30.8 G-III-4-1 Formulari i vlerësimit te pedagogut nga eprori-kolegu Dokumenti 37. Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve Dokumenti 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët Dokumenti 54.4 Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Per Akreditimin e UET Dokumenti 54.5 Certificate Akreditimi UET, 07.04.2017</p> <p>Dokumente shitesë të përcjella nga institucioni: Dok. 1.1 Formati për Raportin e fokus grupeve Dok. 1.2 Fondi i Pyetjeve per Fokus Grupet Dok. 9.2 Plani i Veprimit KSBC 2019-2020 Dok. 10. Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022 Dok. 11. Komunikim per ndryshime ne kurrikulen e programit MA Arte Skenike</p>


	Dok. 12. Extract nga Relacioni_Monitorimi i Silabuseve_Sem II_2020-2021 Dok. 22. Monitorimi në audior nga Përgj. Depart.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UET ka ngritur Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Në përbërje të këtij komisioni janë anëtarë përfaqësues nga të gjitha fakultetet e UET, përfaqësues i Këshillit Studentor, si edhe një ekspert i jashtëm. Pjesëmarrja e ekspertit të jashtëm, ashtu sikurse edhe ngritja e Bordeve të Punës pranë departamenteve krijojnë mundësinë e marrjes së mendimeve për programet/kurikulat nga një rreth më i gjerë pjesëmarrësish dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës.</p> <p>KSBC është një ndër mekanizmat kryesor që UET ka për monitorimin e cilësisë në UET. Sipas dokumenti “Mbi sigurimin e cilësisë në UET”, KSBC krijojnë dhe mban në vijimësi marrëdhënie me institucione pjesëmarrëse në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë, të cilat pas vendimit të Rektoratit, mund të ftohen të zhvillojnë kontrollin e jashtëm të UET-it.</p> <p>Për të rritur cilësinë në arsimin e lartë, UET ka qenë pjesëmarrëse në dy projekte Tempus “ENCHASE” dhe projektin e Erasmus + QAIN AL. Këto dy projekte kanë përfunduar, por njohuritë dhe informacioni i fituar i shërbejnë për KSBC dhe kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë dhe llojshmërinë e mekanizmave të brendshëm për të rritur cilësinë në UET.</p> <p><u>Referenca për Standardin VI.4 / 1</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.9 Fisha e projektit Enchase Dokumenti 30.10 Fisha e projektit QAINAL</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e</p>	<p>Në dokumentin “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë” jepen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KSBC-së. Ndërkohë në garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor një rol shumë të</p>

<p>brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>rëndësishëm luajnë edhe njësi të tjera të UET sipas programeve të studimit si departamenti dhe koordinatori i programit.</p> <p><u>Referenca për Standardin VI.4 / 2</u> Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentin “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë” janë të përcaktuara detyrat e KSBC, ndërsa në dokumentin “Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC” jepet përbërja e këtij komisioni me pjesëmarrjen nga të gjithë anëtarët nga departamentet dhe fakultetet, nga Këshilli Studentor, si edhe me një pjesëmarrës ekspert të jashtëm.</p> <p>Sipas dokumentacionit “<i>KSBC përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p><i>Sipas dokumentacionit “KSBC përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</i></p> <p><i>Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme:</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Kompetencat profesionale;</i> ▪ <i>Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.);</i> ▪ <i>Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative;</i> ▪ <i>Eksperiencia e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt;</i> ▪ <i>Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.</i> <p><i>Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Secili anëtar i KSBC përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar”</i></p> <p>Pjesëmarrja e eksperteve të jashtëm është e garantuar edhe formalisht në përbërjen e KSBC-së.</p> <p>UET ka qenë pjesë e dy projekteve të rëndësishme që janë të lidhur me rritjen e cilësisë në universitet. Kështu në periudhën 2016-2019 UET ka qenë pjesëmarrës në projektin QAINAL “Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në institucionet private të Arsimit të Lartë në Shqipëri”. Projekti ka pasur financim nga Bashkimi Evropian në kuadër të Erasmus+ Veprimi Kyç 2.</p> <p>Gjithashtu UET është pjesëmarrës në projektin UET – ENCHASE TEMPUS, realizuar 2013-2016, gjithashtu me synim përforcimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.</p> <p><u>Referenca për Standardin VI.4</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>

	<p>Dokumenti 30.1 Plani veprimi KSBC Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Dokumenti 30.4 Urdher administrativ mbi përbërjen e KSBC Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC Dokumenti 30.9 Fisha e projektit Enchase Dokumenti 30.10 Fisha e projektit QAINAL Dokumenti 37. Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve</p> <p>Dokumente shtesë të përcjella nga institucioni: Dok. 1.1 Formati për Raportin e fokus grupeve Dok. 1.2 Fondi i Pyetjeve per Fokus Grupet Dok. 9.2 Plani i Veprimit KSBC 2019-2020 Dok. 10. Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022 Dok. 11. Komunikim per ndryshime ne kurrikulen e programit MA Arte Skenike Dok. 12. Extract nga Relacioni_Monitorimi i Silabuseve_Sem II_2020-2021 Dok. 22. Monitorimi në audior nga Përgj. Depart.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

Vlerësimi i ekspertëve

UET dhe KSBC hartojnë planin për aktivitetin e Komisionit përgjatë gjithë vitit.

Baza rregullatore që ka hartuar UET për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshin ndër të tjera edhe këto dokumente:

- Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.
- Plani veprimi KSBC
- Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë
- Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC

Një pjesa e dokumentacioni është publike siç janë statuti i Institucionit, ndërsa pjesa tjetër nuk janë publike.

Referencë për standardin VI. 5/ 1:


Dokumenti 2. Statuti i UET

Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.


Dokumenti 30.4 Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC

Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC

Dokumenti 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët




<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni i konsideron sensitive të dhënat e monitorimit nga KSBC dhe nuk i publikon. Informacioni nga monitorimi shkon tek drejtuesit e UET, Rektori, Administratori apo dekanëve të fakultetit. Ndërsa në departament diskutohen vetëm pjesët respektive. Gjatë vëzhgimit të GVJ, në dosjet e personelit akademik, u gjet edhe vlerësimi më i fundit i stafit i përfshirë në dosje.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet nga anketimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi për ndryshimin e pikave që mund të jenë të dobëta. Të dhënat nga pyetësorët vetë-vlerësues shfrytëzohen edhe të bërë krahasime në periudha kohore dhe për të bërë vlerësim të performacës. Departamenti i përdor rezultatet e anketimeve edhe individualisht për çdo pedagog për të dhënë info, edhe në departament duke i analizuar ato me studentët në mbledhjet e hapura në semestër.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Një rol shumë të rëndësishëm për sigurimin e cilësisë në programin e studimit kanë edhe koordinorët e programeve. Në dokumentin Aneks: Për përcaktimin e detyrave të koordinorit të programit të studimit, Koordinatori duhet të <i>“... hartojë një raport periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.”</i> Sigurimi i cilësisë bazohet në disa rathë të kontrollit dhe disa nivele të zhvillimit të tij të tilla si (i) kontrolli nga drejtuesit e departamentit; (ii) përgjegjësi i grup lëndëve; (iii) koordinorin e programit; (iv) KSBC; (v) Zyra e kurikulave.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>UET në kuadër të dy projekteve të tij 2013-2016 ENCHASE TEMPUS si edhe projektit tjetër QAinAL 2016-2019 ka organizuar trajnime të stafit lidhur me sigurimin më të mirë të cilësisë duke u përpjekur të arrijmë standardet ndërkombëtare. Informacion për studentët realizohet nëpërmjet rregulloreve dhe aktivitetit të Këshillit Studentor, si edhe nga pjesëmarrja e tyre në mbledhjet e hapura të departamentit. <u>Referenca për Standartin VI.4</u> Dokumenti 2. Statuti i UET Dokumenti 8. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. Dokumenti 30.1 Plani veprimit KSBC Dokumenti 30.2 Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë Dokumenti 30.4 Urdher Administrativ mbi përbërjen e KSBC</p>




	Dokumenti 30.5 Metodologjia e punës së aktiviteteve të KSBC Dokumenti 30.9 Fisha e projektit Enchase Dokumenti 30.10 Fisha e projektit QAINAL Dokumenti 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët Dokumenti 54.4 Vendim Nr.46 date 05.07.2019 Per Akreditimin e UET			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i “Arteve Skenike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Evropian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Staf i akademik për zbatimin e programit vjen nga përvoja pune të spikatura, me nivel të lartë profesional dhe mjaft të përshtatshme me programin dhe lëndët specifike që ata japin mësim.
2. Institucioni ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me aktorë të jashtëm në mbështetje të përfitimit të studentëve për praktika profesionale. Kjo u krijon mundësinë studentëve të njohin tregun real të punës dhe njëkohësisht të krijojnë eksperiencë për më tej. Departamenti mbështetet në përvojën e mirë të krijuar nga UET me Bordet e Punës. Kjo krijon një bazë të mirë për studentët edhe në planifikimin e karrierës së tyre.
3. Profili i theksuar publik i institucionit dhe përfshirja e tij në aktivitete ekstrakurrikulare që i japin studentëve mundësi për të ekspozuar edhe aktivitetin e tyre në fushën e Arteve Skenike.
4. Grupe të vogla studentësh, (jo masive) krijojnë mundësinë për punë më specifike dhe të detajuar me studentët, e shprehur edhe në fleksibilitetin e pedagogëve për të punuar me ta sipas nevojave konkrete/praktike.
5. Pjesëmarrja në dy projekte të rëndësishme ndërkombëtare, që lihen me aspekte të veçanta të Arteve Skenike, (Polifonia dhe Crosswarp) nëpërmjet përfshirjes me ekspertizë të pedagogëve. Ekzistenca e Qendrës UET e cila funksionon si qendër për realizimin dhe kërkimin e projekteve të bashkëpunimit ndëruniversitar në kuadrin e programeve të Bashkimit Evropian.
6. Baze teknike, teknologjike dhe studio/ laboratorë të avancuar, laboratorët japin mundësi për të punuar me kushtet më të mira të teknikës dhe teknologjisë si edhe studentët në universitetet homologe.
7. Sistemi i brendshëm i komunikimit elektronik që lehtëson procesin e mësimdhënies dhe krijon interaktivitetin midis studentëve dhe stafit.

Pika të dobëta

1. Rritja e me shumë orëve praktike për lëndët dhe riformatimi i lëndëve teorike ose ndryshimi i tyre. Edhe sipas një sugjerimi të studentëve lënda “metodat e kërkimit sasior” do të ishte jo shumë e nevojshme dhe mund të përshtatej me tej ose kreditet e saj të kalonin në favor të lëndëve praktike.
2. Rritja e mundësisë për të pasqyruar tek publiku punët praktike të studentëve. Kjo ka qenë specifike në këto dy vite si pasojë e Pandemisë Covid – 19 që pamundëson praktikatat e mirëfillta si pasojë e kufizimit të veprimtarisë artistike. (Përkoji me vitet kalendarike 2019-2020 dhe 202-2021). Kjo ka ndikuar edhe që studentët të mos kenë mundësi t’i shpërfaqin punimet e tyre në një publik të gjerë.
3. Për lëndë të veçanta, siç janë atelietë e modës duhet mundësuar software specifike.

4. Rritja dhe promovimi për përfshirjen e studentëve të programit Master i Arteve Skenike me shkëmbimin me universitetet jashtë vendit.
5. Literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, e shprehur më shumë në lëndët teknike të profesionit. Nevoja për plotësimin e saj/përkthimin gradual, në funksion të proceseve të të mësuarit për studentët e programit.
6. Një skemë e qartë financimi për kërkimin shkencor në lidhje me programin e Master i Arteve ku të përfshihen edhe studentët e këtyre programeve dhe profileve.

Rekomandime

1. Departamenti i Arteve të Aplikuara duhet të punojë për të rishikuar mundësinë e rritjes së pjesës praktike, brenda lëndëve dhe nëse është mundësia edhe zëvendësimin e ndonjëres prej lëndëve teorike me një tjetër më praktike.
2. Institucioni duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për përkthime të literaturës së huaj për programin, në gjuhën shqipe dhe vënien e tyre në dispozicion të studentëve (Pavarësisht se ka një literaturë të gjerë në gjuhën angleze). Plotësimi me literaturë shqipe është një proces i vazhdueshëm dhe i tillë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë.
3. Institucioni duhet të synojë për shtim të burimeve financiare dhe njerëzore në funksion të pasurimit të kërkimit shkencor për stafin e programit;
4. UET sugjerohet ta shtrijë promovimin e programit edhe te studentë shqipfolës nga trevat shqiptare, për t'u bërë pjesë e programit;
5. Institucioni duhet të forcojë më tej mobilitetet e studentëve me universitetet jashtë vendit, në kuadër të projekteve. Kjo është sidomos e nevojshme për studentët e Master i Arteve. Departamenti dhe UET, do të duhet të kapërcejnë gradualisht ndikimin nga pandemia COVID-19 e këtyre dy viteve. Departamenti dhe UET sugjerohet të forcojnë komponentin e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, për kërkimin shkencor si edhe projektet e BE.
6. Sygjerohet rishikimi i syllabusit: Syllabus_produksion_i_integruar_kinema_teater_TV_MA, pasi paraqet gabime drejtshkrimore dhe strukturore të dukshme.

Conclusions of the study program evaluation in the second cycle Master in "Scenic Arts" of the Higher Education Institute "European University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The program's academic staff has outstanding working experience, with a highly professional capacities, quite suitable with the program's specifics and subjects they teach.
2. The institution (UET) has established stable and sustainable relations with external actors for the benefit of students and their professional internships. This has created the opportunity for students to get to know the job market and as well as to create working experience for further career development. The Department relies on the good experience established by UET with the Labor Boards. This has offered a good opportunity for students in their career planning.
3. Prominent public profile of the institution and its involvement in extracurricular activities that give students the opportunity to exhibit their activity in the field of Performing Arts
4. Small groups of students (classes with no great number of students) creates the opportunity for more specific and personalized work with students and this is also expressed in the flexibility of professors to work with students according to their concrete/practical needs.
5. Participation in two important international projects, related to special aspects of Visual Arts through the involvement of UET/ Department professors (Polyphony and Crosswarp). This is also related with the existence of the "UET Center" as a center for applying and implementation of university cooperation projects, in the framework of European Union programs.
6. Technical/technological equipment and advanced studios/laboratories, provide students opportunity to work with the best of technology hardware and software. (Similar to students in counterpart western universities.
7. Internal electronic communication system facilitates the teaching process and creates interactivity between students and staff.

Weak points

1. The need for increasing the number of practical hours for courses and reformatting theoretical courses or changing them. According to a suggestion of the students the subject "Quantitative



research methods" would not be very necessary for the program. Its hours and credits could be further adapted or shifted in favor of other practical courses.

2. The opportunities to reflect and present to the public the practical work of students. There is a growing demand to present them to public, especially in this last two years as a result of the Covid -19 Pandemic. The students practices in 2020-2021 has been not realized properly due to the restriction of artistic activity in the country. (Coincided with the calendar years 2019-2020 and 202-2021). This has also resulted in students not being able to present their work to a wide audience.
3. Specific software should be enabled for specific subjects, such as fashion workshops.
4. Student Involvement of the Master of Performing Arts in the Mobility programs with universities abroad. There is a growing need for increase and promotion of those students Mobility in this program.
5. Limited literature in Albanian language, expressed more in the technical subjects of the profession. There is a need for its completion / gradual translation, to better serve students learning processes.
6. A clear funding scheme for research related to the Master of Arts program to include students of these programs and its profiles.

Recommendation

1. The Department of Applied Arts should work to review the possibility of increasing the practical hours/classes, within the subjects and if possible the replacement of any of the theoretical subjects with another more practical one.
2. The institution should make greater efforts to translate foreign literature for the program, into Albanian language and make them available to students (Despite the fact that there is an extensive literature in English). Filling this gap with the Albanian literature is an ongoing process for all institutions of higher education. Foreign literature is widely noticed. Despite the fact that is well understood by students, must be translated over the years by the pedagogical staff in the local language, to better serve students' comprehensive knowledge of the subject.
3. The institution should aim to increase financial and human resources in order to enrich scientific research for the study program.
4. It is suggested to UET to extend the promotion of the program to Albanian-speaking students from Albanian living countries in the border, so they become part of this study program.
5. The institution (UET and Department) should further strengthen mobility of students and professors with universities abroad, specially within EU projects. This is especially necessary for Master of Arts students. The Department / UET will have to gradually overcome the impact of the COVID-

19 pandemic of these two years. The Department and UET are suggested to strengthen the component of participation in international projects, for scientific research as well as EU projects.

6. Syllabus revision suggested: Syllabus_production_integrated_kinema_teater_TV_MA, as it presents obvious spelling and structural errors.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Notë përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X